

Hyrje në Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit në Kore

Një mjet për të analizuar dhe reduktuar rrezikun e korrupsionit në projektligje, ligje dhe rregullore



Mirënjohje

Përbajtja kryesore teknike e këtij libri është marrë nga <Doracaku për Vlerësimin e Ndikimit të Korrupsionit> të Komisionit për Anti-Korrupsion dhe Të Drejtat Civile të Republikës së Koresë dhe nga dokumente të tjera të cituara në seksionin e referencave.

Ekipi hartues



- Z. Chankyu Kim, Konsulent, Qendra e Politikave e UNDP-së në Seul (USPC)
- znj. Ahjung Lee, Specialiste e Politikave (USPC)

Ekipi këshillues



- z. Injong Kim, Drejtor, Divizioni për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit, Komisioni i Anti-Korrupsionit dhe të Drejtave Civile (ACRC)
- z. Euy-Whan Kim, Këshilltar i Politikave, Byroja për Mbështetje të Politikave dhe Programeve, UNDP
- z. Hyeon-woo Seo, Zëvendës Drejtor, Divizioni për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit (ACRC)
- znj. So-yeong Yoon, Zëvendës Drejtore, Divizioni i marrëdhënieve Ndërkombëtare (ACRC)

Ekipi redaktues



- Znj. Hye-Jin Park, Specialiste e Komunikimit dhe Partneriteteve (USPC)
- znj. Gichung Lee, Analiste e Politikave (USPC)
- znj. Sonheong Jang, Analiste e Politikave (USPC)
- znj. Daeun Jung, Praktikante (USPC)
- z. Doo Hyun Nam, Praktikant (USPC)
- znj. Kirsty Goodman, Praktikante (USPC).

Partneri donator

Ky hulumtim u mundësua nga mbështetja bujare e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Koresë për Qendrën e Politikave të UNDP-së në Seul.

Mohim i përgjegjësisë

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë UNDP-në, ose Shtetet e tyre Anëtare. UNDP-ja krijon partneritete me njerëz në të gjitha nivelet e shoqërisë për të ndihmuar në ndërtimin e kombeve që mund t'i përballojnë krizat, si dhe për të nxitur dhe mbështetur llojin e rritjes që përmirëson cilësinë e jetës për të gjithë. Në terren, në 170 shtete dhe territore, ne ofrojmë perspektivë globale dhe dituri lokale për të ndihmuar në fuqizimin e jetëve dhe ndërtimin e kombeve të paepshme.

Menaxher projekti

Znj. Ahjung LEE, Qendra e Politikave e UNDP-së në Seul. Email: ahjung.lee@undp.org

Kontaktet

Të drejtat e autorit © UNDP 2018

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Prodhuar në Republikën e Koresë

Përkthimi i këtij versioni në gjuhën shqip është mbështetur nga UNDP, Kosovë.

Parathënie

Në mbarë botën, qeverisja e dobët dhe sistemet e rrënjosura të korrupsionit mbeten një sfidë e madhe për zhvillimin njerëzor. Korrupsioni jo vetëm që rezulton me humbje të resurseve zhvillimore, por gjithashtu gërryen strukturën e shoqërisë dhe rrënon besimin e qytetarëve në sistemin politik. Nuk mund t’i arrijmë Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SZHQ)- të dakorduara nga bashkësia ndërkombëtare- pa gjetur zgjidhje efektive për të luftuar korrupsionin.

Në këtë kontekst, ky libër paraqet instrumentin e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit (VRRK) të Komisionit Korean për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (ACRC) si shembull i një instrumenti efektiv për parandalimin e korrupsionit. Në Kore, që nga viti 2006, VRRK-ja ka ndihmuar në identifikimin dhe zvogëlimin e rreziqeve të korrupsionit në ligje dhe rregullore, duke ofruar një kornizë analitike sistematike dhe të qartë që zbatohet gjatë procesit të legjislacionit. Vendet që dëshirojnë të parandalojnë korrupsionin në procesin e formulimit ligjor mund të përfitojnë nga krahasimi me metodologjinë e VRRK-së, ndërkohë që kërkohen modifikime për kontekstualizimin e aplikimeve specifike sipas kontekstit kombëtar. Ky libër i burimeve siguron detajet teknike të metodologjisë së VRRK-së, së bashku me rekomandimet dhe sugjerimet për aplikimin e tyre.

Që nga viti 2015, ACRC-ja dhe Qendra e Politikave e UNDP-së në Seul (USPC) bashkëpunojnë për të ndarë politikat kundër korrupsionit dhe mësimet e nxjerra të Koresë përmes programit kundër korrupsionit të USPC-së “Partneriteti i Zgjidhjeve Zhvillimore” (DSP). Faza e parë e bashkëpunimit tonë në kuadrin e DSP-së bëri ndarjen me Vietnam të mjetit të Vlerësimit të Iniciativës Kundër Korrupsionit (VIKK) të ACRC-së. Kjo çoi në zhvillimin, si dhe zbatimin e suksesshëm pilot, të versionit të VIKK-ut në Vietnam në të 63 provincat e vendit. Në janar 2018, ACRC-ja dhe USPC-ja nisën fazën e dytë të bashkëpunimit tonë dhe përzgjedhën mjetin e VRRK-së si subjekt i programit tonë të shkëmbimit të njohurive. Duke kombinuar njohuritë praktike të ACRC-së me rrjetin global të UNDP-së dhe punën kundër korrupsionit në nivel vendi, shpresojmë që bashkëpunimi ynë të ofrojë ide kreative dhe frymëzim për vendet partnere në luftën e tyre kundër korrupsionit.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë anëtarët e ekipeve tona përkatëse, të cilët kontribuan në shkrimin e këtij libri të burimeve.



Un Jong Pak

Kryesues i Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile



Balázs Horváth

Drejtor i Qendrës së Politikave të UNDP-së në Seul

PËRMBAJTJA

	Lista e shkurtesave dhe akronimeve	4
I.	Hyrje në Kornizën Institucionale Kundër Korrupsionit në Kore - 5page	Panorama e ligjeve dhe institucioneve kundër korrupsionit në Kore 6 Përshkrim i Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (ACRC) 7 Mjedisi mundësues në Kore për futjen e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit (VRRK) 10
II.	Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit në shikim të parë - 11page	Përshkrim i shkurtër 12 Përfitimet e qasjes së VRRK-së 14
III.	Metodologjia dhe administrimi i VRRK-së Kore - 17page	Baza ligjore për VRRK-në 18 Fushëveprimi i VRRK-së 20 Kriteret e VRRK-së dhe lista kontrolluese e vlerësimit 23 Pyetjet më të shpeshta 43
IV.	VRRK i kryer për akte ligjore dhe statute të varura, dhe rregulla administrative - 49page	Vlerësimi i projekt akteve ligjore dhe statuteve të varura 50 Vlerësimi i akteve ligjore dhe statuteve të varura aktuale 53 Vlerësimi i projekt rregullave administrative 55 Vlerësimi i rregullave aktuale administrative 56
V.	VRRK i kryer për rregullore komunale - 57page	Vlerësimi i projekt rregulloreve komunale 58 Vlerësimi i rregulloreve aktuale komunale 60 Vlerësimi nga ACRC-ja i rregulloreve komunale 61
VI.	VRRK i kryer për rregullat dhe aktet nënligjore të organizatave të shërbimeve publike - 63page	Vlerësimi i rregullave dhe akteve nënligjore 64
VII.	Strategic Approaches for Introducing CRA: Twelve Main Issues and Suggestions	67
Shtojca ¹		Shtojca 1. Shabllonet dhe udhëzimet e vlerësimit të VRRK-së për ligje dhe statute të varura 74 Shtojca 2. Materialet për vlerësimin bazë të VRRK-së për rregullore komunale 91 Shtojca 3. Materialet për vlerësimin e detajuar të VRRK-së për rregullore komunale 92 Shtojca 4. Shablloni për njoftimin e rezultateve për rregulloret komunale 93 Shtojca 5. Materialet për vlerësimin bazë të VRRK-së për rregullat dhe aktet nënligjore 94 Shtojca 6. Materialet për vlerësimin e detajuar të VRRK-së për rregullat dhe aktet nënligjore 95 Shtojca 7. Shablloni për njoftimin e rezultateve për rregullat dhe aktet nënligjore 96 Shtojca 8. Kërkesë për këshillim për VRRK 97 Shtojca 9. Udhëzimet Operative për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit 98

¹ Shabllonët në Shtojcat 1-7 janë marrë nga "Udhëzimet Operative për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit" të përshkruan në shtojcën 8.

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ACRC	◉	Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile
KICAC	◉	Komisioni i Pavarur Korean Kundër Korrupsionit
PPO	◉	Zyra e Prokurorit Publik
BAI	◉	Bordi i Auditimit dhe Inspektimit
POA	◉	Ligji i Zyrës së Prokurorisë
KOFIU	◉	Njësia Koreane e Inteligjencës Financiare
CPA	◉	Ligji i Procedurës Penale
CAAC	◉	Komisioni Qendror Administrativ i Apelit
CPI	◉	Treguesi i Perceptimit të Korrupsionit
CRA	◉	Vlerësimi i Rrezikut të Korrupsionit
AIA	◉	Vlerësimi i Iniciativës Kundër Korrupsionit
MP	◉	Anëtarë të parlamentit
MOLEG	◉	Ministria e Legjislacionit Qeveritar



I.

HYRJE NË KORNIZËN
INSTITUCIONALE KUNDËR
KORRUPSIONIT NË KORE

I Hyrje në Kornizën Institucionale Kundër Korrupsionit në Kore

1. Panorama e ligjeve dhe institucioneve kundër korrupsionit në Kore

Gjatë periudhës së shpejtë të industrializimit mes viteve 1960 dhe 1980, Republika e Koresë i përqendroi përpjekjet e saj kryesisht në zhvillimin ekonomik, pa i kushtuar shumë vëmendje korrupsionit. Sidoqoftë, lufta kundër korrupsionit u kthye në prioritet kryesor kombëtar pas krizës financiare aziatike të viteve 1997-1998, e cila e rrënoi ekonominë koreane. Qytetarët kuptuan se korrupsioni i përhapur dhe i rrënjësor në sferat ekonomike, shoqërore dhe politike kishte kontribuar në krijimin e krizës, dhe i kërkuan qeverisë të merrte masa politike dhe institucionale për të trajtuar sfidat e korrupsionit.

Si rezultat, në vitin 2001 u miratua Ligji Kundër Korrupsionit i Koresë, dhe në janar 2002 u themelua organi i parë kombëtar kundër korrupsionit, Komisioni i Pavarur Korean Kundër Korrupsionit (KICAC). Gjithashtu, në shtator 2001 Koreja miratoi ligjin kundër pastrimit të parave (Ligji për Raportimin dhe Përdorimin e Informacioneve të Transaksioneve Financiare të Specifikuara), dhe në nëntor 2001 dhe krijoi Njësinë Koreane të Inteligjencës Financiare (KOFIU), sipas këtij ligj.

KICAC-u ka zbatuar një numër masash parandaluese kundër korrupsionit, duke përfshirë zhvillimin dhe koordinimin e politikave kombëtare kundër korrupsionit, përmirësimin e kornizave ligjore dhe institucionale, matjen e korrupsionit dhe organizimin e programeve të trajnimit kundër korrupsionit. Po ashtu, ka monitoruar zbatimin e Kodit të Sjelljes për Zyrtarët Publikë, i cili u miratua si dekret presidencial në maj 2003. Gjithashtu, ka ndërmarrë masa reaktive, si pranimit dhe trajtimi i raporteve të korrupsionit dhe mbrojtja dhe shpërblimi i sinjalizuesve.

Në bazë të Ligjit Kundër Korrupsionit, KICAC-u u ngarkua kryesisht me funksionet e parandalimit të korrupsionit në Kore, ndërkohë që kompetencat hetimore i mbetën Zyrës së Prokurorit Publik (PPO), Bordit të Auditimit dhe Inspektimit (BAI) dhe policisë.

Autoriteti i PPO-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet, duke përfshirë edhe rastet e korrupsionit, vjen nga neni 4 i Ligjit të Zyrës së Prokurorëve (POA), që hyri në fuqi në vitin 1949.. Neni 4 (2) i të njëjtit ligj gjithashtu i jep PPO-së pavarësinë dhe paanshmërinë nga aktorë të tjerë politikë. Teksa PPO-ja mban përgjegjësinë përfundimtare në funksionet ndëshkuese, përpjekjet e PPO-së kundër korrupsionit mbështeten nga BAI dhe policia.

BAI është institucioni i lartë i kontrollit dhe inspektimit në kuadër të zyrës së Presidentit, dhe kjo organizatë shqyrton flukset monetare të të gjitha subjekteve publike dhe inspekton funksionet e agjencive administrative dhe të zyrtarëve publikë. BAI mund të kërkojë nga agjencia përkatëse administrative që të ndërmarrë masa disiplinore ndaj zyrtarëve publikë që kanë kryer parregullsi, si dhe duhet të ngrejë akuza kundër çdo krimi të dyshuar para autoriteteve hetimore.

Policia mund t'i hetojë rastet e korrupsionit, por hetimi duhet të kryhet sipas udhëzimeve të prokurorit publik, sipas nenit 196 të Ligjit të Procedurës Penale (CPA), i cili hyri në fuqi në vitin 1954.. Po ashtu, neni 246 i CPA-së i jep PPO-së autoritetin e vetëm për t'i ndjekur penalisht çështjet penale.

Në vitin 2008, korniza kundër korrupsionit e Koresë hyri në një fazë të re. Komisioni për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (ACRC) u themelua për të ndërtuar një sistem më efikas të qeverisjes, përmes bashkimit të KICAC-ut, Avokatit të Popullit të Koresë dhe Komisionit Administrativ të Apelit. Përveç kësaj, në vitin 2008 u shfuqizua Ligji Kundër Korrupsionit përmes miratimit të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Themelimin dhe Menaxhimin e Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (më tej "Ligji i ACRC-së").

Në vitin 2011, qeveria koreane miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve të Interesit Publik për të mbrojtur ata që raportojnë shkelje të interesit publik në lidhje me shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, konkurrencën e ndershme dhe interesat e konsumatorëve. Para miratimit, vetëm ata që raportonin rastet e korrupsionit në sektorin publik kishin mbrojtje nga Ligji i ACRC-së. Tani, edhe raportuesit e rasteve të korrupsionit në sektorin privat, përfshirë rastet e rryshfetit nga të huaj, kanë mbrojtje nga ligji.

Në vitin 2015 u miratua Ligji për Kërkesat e Pahijshme dhe Mashtrimet (që hyri në fuqi në shtator 2016). Sipas këtij ligji dënohet kushdo që u parashtron zyrtarëve publikë kërkesa të pahijshme, edhe nëse nuk jepet rryshfet. Edhe zyrtarët publikë që pranojnë para, dhurata ose mikpritje që vlejné më shumë se një milion won koreanë i nënshtrohen dënimit penal, pavarësisht nëse përfitimet e tilla merren në lidhje me detyrat e tyre zyrtare ose në këmbim të çfarëdo favorit. Edhe kompanitë përballen me sanksione nëse punonjësit e tyre bëjnë kërkesa të pahijshme u ose ofrojnë rryshfete zyrtarëve qeveritarë. Ky ligj ka filluar të gjenerojë ndryshime historike dhe të përhapura në shoqërinë koreane.²

Administrata e Moon Jae-in u inaugurua në maj të vitit 2017, e nxitur nga aspiratat e popullit për një komb transparent pas skandalit të madh të korrupsionit dhe shkarkimit të ish-presidentes. Administrata e re i vendosi “çrrënjosjen e keqpërdorimeve” dhe “reformën kundër korrupsionit” në krye të synimeve të politikës qeveritare, dhe me shpejtësi e shtyu përpara lëvizjen kundër korrupsionit.

Mbledhja e parë e Këshillit për Politikën Kundër Korrupsionit i kryesuar nga Presidenti Moon u mbajt në shtator të vitit 2017, dhe më 6 mars 2018 ACRC-ja lansoi Këshillin e Konsultimeve Publike- Private për Shoqëri Transparente, përmes të cilit biznesi, shoqëria civile, mediat dhe bota akademike do të marrin pjesë aktive në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave kundër korrupsionit.

2. Përshkrim i Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (ACRC)

ACRC u themelua në vitin 2008 përmes integritetit të Avokatit të Popullit të Koresë, KICAC-ut dhe Komisionit Administrativ të Apelit. Qëllimi i integritetit të këtyre tri institucioneve qeveritare ishte rritja e efikasitetit dhe kapaciteteve të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave civile duke trajtuar ankesat civile, korrupsionin dhe apelet administrative përmes një kanali të vetëm.

Funksionet e ACRC-së, siç janë paraparë në nenin 12 të Ligjit të ACRC-së, përfshijnë vlerësimin e niveleve të integritetit dhe përpjekjet kundër korrupsionit të organizatave publike; ofrimin e rekomandimeve për organizatat publike; ekzaminimin e faktorëve të rrezikut të korrupsionit në ligje dhe projektligje; ofrimin e trajnimeve kundër korrupsionit për zyrtarë publikë; rritjen e vetëdijesimit publik ndaj rreziqeve të korrupsionit; mbrojtjen dhe shpërbllimin e sinjalizuesve; dhe monitorimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes për Zyrtarët Publikë. Çdokush mund të raportojë një vepër korrupsioni ose shkelje të interesit publik tek ACRC-ja. Nëse ACRC-ja e sheh të nevojshme ta hetojë rastin e raportuar, ai referohet tek BAI, autoriteti hetues ose organi mbikëqyrës i institucionit publik përkatës. Pas përfundimit të hetimit, ACRC-ja mbledh rezultatet nga agjencitë hetuese përkatëse dhe informon raportuesit për mënyrën si janë trajtuar rastet e tyre.

² Për perceptimin e publikut mbi Ligjin dhe efektshmërinë e tij, ju lutemi shihni:
<http://www.acrc.go.kr/en/board.do?command=searchDetail&method=searchList&menuId=02031504>.

ACRC-ja është e përbërë nga 15 anëtarë të komisionit (d.m.th. një kryesues, tre zëvendës kryesues, tre komisionerë të përhershëm dhe 8 komisionerë jo të përhershëm). Kryesuesit, zëvendës kryesuesit dhe komisionerët janë anëtarë të emëruar ose të ngarkuar të personelit, të cilët pranohet se janë në gjendje t'i trajtojnë ankesat civile dhe të ndërmarrin iniciativa kundër korrupsionit në mënyrë të drejtë dhe të pavarur. Secili zëvendës kryesues ka për detyrë: trajtimin e ankesave civile; parandalimin e korrupsionit; menaxhimin e Komisionit Qendror Administrativ të Apelit (CAAC); dhe asistencën për kryesuesin.


Në kuadër të ACRC-së është organizuar një sekretariat për të menaxhuar çështjet administrative. Kryesuesi emëron një zëvendës kryesues që të shërbejë njëkohësisht si sekretar i përgjithshëm. Sekretari i përgjithshëm mbikëqyr departamentet e sekretariatit.

Përveç sekretariatit janë edhe një zëdhënës dhe këshilltarët ligjorë që i asistojnë kryesuesit, ndërsa zyra e planifikimit dhe koordinimit dhe një drejtor i auditimit dhe inspektimit mbështesin sekretarin e përgjithshëm. Selia e ACRC-së përbëhet nga Zyra e Planifikimit dhe Koordinimit, pesë byro (Byroja e Anti-Korrupsionit, Byroja e Inspektimit dhe Mbrojtjes, Byroja e Avokatit të Popullit, Byroja e Apeleve Administrative dhe Byroja për Përmirësimin Institucionale), dy zyra të zëvendës drejtorëve të përgjithshëm, një zyrë të zëdhënësit dhe 40 divizione. Që nga korriku 2018, për ACRC punojnë gjithsej 467 punonjës, me 51 personel shtesë që punojnë në dy organizata të lidhura (d.m.th. 29 punonjës që punojnë në Qendrën e Ankesave të ACRC-së në Seul, dhe 22 punonjës në Institutin e Trajnimit Kundër Korrupsionit).

Punonjës të ACRC-së

Gjithsej 521	Zyrtarë në shërbim politik	4
	Zyrtarë në shërbim të posaçëm	3
	Shërbimi civil i lartë	16
	Nivelet 3-4	14
	Niveli 4	31
	Nivelet 4-5	41
	Niveli 5	186
	Nivelet 6 dhe më poshtë	218
	Zyrtarë në shërbim profesional	7
	Hulumtues	1

Organigrama e ACRC-së



3. Mjedisi mundësues në Kore për futjen e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit (VRRK)

Duhet të theksohet se Vlerësimi i Rrezikut të Korrupsionit u miratua në Kore në kuadër të një konteksti të veçantë, i cili mundësoi funksionimin e një mjeti të tillë të politikës. Koreja gëzonte disa parakushte të favorshme kur miratoi VRRK-në:

▫ Vullneti i fortë politik i nivelit të lartë:

Presidentët e Republikës së Koresë kanë treguar vullnet të fortë politik për të shtuar dhe mbështetur iniciativat kundër korrupsionit. Pas tranzicionit demokratik të vendit në fillim të viteve 1990 dhe krizës financiare aziatike që goditi Korenë në vitin 1997, administrata e Kim Dae-jung (1998-2003) iu përgjigj kërkesës së publikut për një proces më transparent dhe më llogaridhënës të administratës publike duke miratuar Ligjin Kundër Korrupsionit, i cili siguroi bazën kryesore ligjore për përpjekjet kundër korrupsionit në Kore. KICAC-u, agjencia e parë kundër korrupsionit e Koresë, u themelua në vitin 2002 si rezultat i masave të reformave kundër korrupsionit të presidentit Kim Dae-jung.

Prej themelimit, KICAC-u u përpoq t'i mbajë ligjet dhe sistemet administrative të përditësuara, për të eliminuar rreziqet e korrupsionit në kuadër të legjislacionit. Ishte gjatë administratës së Roh Moohyun (2003-2008) që VRRK-ja u prezantua për herë të parë në Kore. Duke pranuar rëndësinë e krijimit të mekanizmave parandalues për të eliminuar rreziqet e korrupsionit në kuadër të projektligjeve para se të miratohen, Presidenti Roh Moohyun e autorizoi KICAC-un të zhvillojë mjetin e VRRK-së. Ky vullnet i fortë politik nga udhëheqësia e vendit ndihmoi në krijimin e momentumit që KICAC-u të zbatojë VRRK-në.

▫ Shfrytëzimi efektiv i përvojave dhe ekspertizave të mëparshme:

Para se të prezantohej VRRK-ka, KICAC-u përgatiti terrenin për VRRK-në duke kryer një analizë gjithëpërfshirëse të ligjeve dhe institucioneve të Koresë për të identifikuar faktorët që shkaktojnë korrupsionin (p.sh. në vitin 2003 KICAC-u analizoi ligjet për fushat e ndjeshme ndaj korrupsionit, të tilla si ndërtimi, financat lokale dhe zhvillimi rajonal). Duke përfutur nga përvojat e mëparshme, KICAC-u tashmë kishte ekspertizë të konsiderueshme në identifikimin e rreziqeve të korrupsionit në kuadër të legjislacionit aktual, dhe kështu ishte në gjendje të zhvillonte kriteret efektive të vlerësimit për zbulimin e rreziqeve të korrupsionit në projektligje, ligje dhe rregullore.

Gjithashtu, KICAC-u shfrytëzoi përvojat dhe mësimet e nxjerra nga institucionet e tjera qeveritare që përdorin metodologjitë e vlerësimit të ndikimit, siç janë Vlerësimi i Ndikimit në Mjedisi, Vlerësimi i Ndikimit të Trafikut dhe Analiza e Ndikimit Rregullator, të cilat u zbatuan në vitin 1998. Për të siguruar efikasitetin dhe efektshmërinë e VRRK-së, KICAC-u gjithashtu mori këshilla teknike nga ekspertë akademikë dhe zhvilloi konsultime me ministritë përkatëse.

▫ Zbatja strategjike e rezistencës nga institucionet qeveritare:

Gjatë zbatimit të VRRK-së, KICAC-u bëri përpjekje për të minimizuar barrën administrative në ministritë e qeverisë, duke i inkurajuar agjencitë qeveritare, herë me bukë e herë me gurë, që t'i institucionalizonin praktikatat e VRRK-së. Duke harmonizuar kohën e kryerjes së VRRK-së me fazën e shpalljes paraprake të një projektligji, kur institucionet qeveritare mbledhin opinione për propozimin e tyre legjislativ, KICAC-u ishte në gjendje të jepte rekomandime kur ministritë përkatëse ishin më të hapura për të marrë opinione. Për më tepër, kryerja e VRRK-së gjatë fazës së shpalljes paraprake parandaloi çdo vonesë në miratimin/rishikimin e projektligjeve, gjë që ka zvogëluar ngarkesën administrative të organizatave përkatëse.

KICAC gjithashtu e ka lidhur VRRK-në me Vlerësimin e Iniciativës Kundër Korrupsionit (VIKK), i cili vlerëson, rendit dhe shpalos publikisht përpjekjet kundër korrupsionit të institucioneve qeveritare. Duke e vendosur shkallën e përfshirjes së rekomandimeve të VRRK-së si një nga kriteret e VIKK-ut, KICAC-u ka motivuar kërret e institucioneve publike që të miratojnë rekomandimet e VRRK-së. Gjithashtu, shpalosja e rezultateve të VRRK-së në mbledhjet e zëvendësministrave/kabinetit ka kontribuar në institucionalizimin e praktikës së VRRK-së, pasi ministrive të qeverisë u kërkohet të japin arsye të justifikuara për mosmiratimin e rekomandimeve të VRRK-së kur merren në pyetje nga politikëbërësit e nivelit të lartë.

Burimi: Përshtatur nga Choi, Jinwook, Park, Joonghoon dhe Lee, Ahjung. 2017. Nr. 2 i Serisë së Mendimeve për Zgjidhjet e Zhvillimit: Politikat dhe institucionet kundër korrupsionit në Kore dhe Singapor. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Qendra e Politikave në Seul për Partneritetet e Zhvillimit Global, Seul. 27-44., dhe kontribute nga zyrtarët e ACRC-së.



II.

VLERËSIMI I RREZIKUT TË
KORRUPSIONIT NË SHIKIM TË PARË

II VLERËSIMI I RREZIKUT TË KORRUPSIONIT NË SHIKIM TË PARË

Përshkrim i shkurtër

1. Çka është VRRK-ja?

I vendosur në vitin 2006, Vlerësimi i Rrezikut të Korrupsionit (VRRK) i Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (ACRC) të Republikës së Koresë është një mjet parandalues kundër korrupsionit i cili identifikon dhe redukon rreziqet e korrupsionit në projektligje, ligje dhe rregullore. ACRC-ja i përdor rezultatet e VRRK-së për t'u dhënë rekomandime specifike agjencive përkatëse qeveritare për ndryshimin e dispozitave që kanë potencial të krijojnë korrupsion.³ Si i tillë, ky mjet ndihmon në rritjen e transparencës dhe efikasitetit të procesit të administratës publike në institucionet qeveritare dhe organizatat e shërbimeve publike, siç janë ndërmarrjet shtetërore.

2. Background and legal basis of CRA

Zhvillimi i VRRK-së u bë i mundur për shkak të kërkesës së fortë publike për të luftuar korrupsionin. Për shembull, një anketë publike e kryer në vitin 2005 tregoi se 60% e publikut korean perceptonte se zyrtarët publikë ishin të korruptuar. Në vitin 2005, Koreja u rendit e 40-ta (nga 159 vende) në Treguesin e Perceptimit të Korrupsionit (TPK), ndërsa ekonomia e Koresë në atë kohë ishte e 10-ta më e madhe në botë. Duke marrë parasysh një asimetri të tillë mes niveleve të korrupsionit dhe zhvillimit ekonomik, publiku e konsideroi rezultatin relativisht të ulët të TPK-së si dëshmi të nevojës kritike që vendi të miratonte mjete efektive për të luftuar korrupsionin.

Në veçanti, u bë e qartë nevoja për masa rigorozë dhe efektive për të parandaluar korrupsionin. Pa masa efektive për parandalimin e korrupsionit, vendi ishte i aftë vetëm që të reagoonte dhe të ekzekutoonte masat pas kontrollit, kur rasti i korrupsionit kishte ndodhur tashmë (d.m.th. zbulimi dhe ndëshkimi i aktiviteteve të korrupsionit). Megjithatë, këto masa pas kontrollit nuk mund të zgjidhnin shkaqet themelore të korrupsionit në administratën publike.

Prandaj, qeveria koreane rishikoi Ligjin kundër Korrupsionit më 29 dhjetor 2005, i cili më pas hyri në fuqi më 1 prill 2006. Duke pranuar se kërkohej krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të analizës së rrezikut të korrupsionit për të adresuar shkaqet institucionale të korrupsionit, Ligji i rishikuar siguroi bazën ligjore për zhvillimin dhe zbatimin e VRRK-së.

Kur VRRK-ja u krye fillimisht, ACRC-ja shqyrtoi projektligjet dhe ligjet (d.m.th. aktet ligjore dhe statutet e varura), së bashku me rregullat administrative dhe rregulloret komunale. Megjithatë, më 28 dhjetor 2007, ACRC-ja e zgjeroi fushëveprimin e VRRK-së për të mbuluar rregullat e brendshme dhe aktet nënligjore të organizatave të shërbimeve publike, pasi u shtuan aktivitetet qeveritare që iu besuan ose iu ngarkuan atyre organizatave, dhe aktivitetet e tyre ishin drejtpërdrejt të lidhura me jetën e përditshmen të qytetarëve.

³ "Korrupsioni" është përcaktuar në nenin 2 të Ligjit të ACRC-së si:

- Shpërdorimi i pozitës ose autoritetit të tij nga ndonjë zyrtar publik, ose shkelja e statutit në lidhje me detyrat e tij/saj për të kërkuar fitime për vete ose për ndonjë palë të tretë;
- Veprimi i shkakutimit të dëmeve në pronën e ndonjë institucioni publik në kundërshtim me statutin, në procesin e ekzekutimit të buxhetit të institucionit publik përkatës, marrjes, administrimit ose disponimit të pronës së institucionit publik përkatës, ose lidhjes dhe ekzekutimit të një kontrate në të cilën institucioni publik përkatës është palë; dhe
- Vepra e shtrëngimit, nxitjes, propozimit dhe shtyrjes drejt çdo veprë të përmendur në pikat (a) dhe (b) ose vepra e mbulimit.

Në vitin 2008, Ligji kundër Korrupsionit u ndryshua dhe u zëvendësua me "Ligjin për ACRC-në". Neni 3 i Ligjit për ACRC-në i obligon të gjitha organizatat publike koreane që të parandalojnë ose të çrrënjoshin aktivitetet e korruptuara për të nxitur etikën e shëndoshë shoqërore. Posaçërisht neni 12 (6) i jep ACRC-së mandat për të shqyrtuar dhe vlerësuar masat e politikave kundër korrupsionit të institucioneve publike. Gjithashtu, neni 28 i ligjit e autorizon ACRC-në që të vlerësojë rreziqet e korrupsionit në kuadër të ligjeve (d.m.th. aktet ligjore, dekretet presidenciale, dekretet e kryeministrit dhe të ministrive, si dhe direktivat, rregullat dhe njoftimet publike) dhe të ofrojë rekomandime kundër korrupsionit për institucionet qeveritare.

Për më tepër, Dekreti për Zbatimin e Ligjit Kundër Korrupsionit dhe Themelimin dhe Menaxhimin e Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (në tekstin e mëtejshëm: Dekreti për Zbatimin e ACRC-së) ofron bazën ligjore për kryerjen e VRRK-së nga ACRC-ja. Nenet 30 deri 32 të Dekretit japin udhëzime për kryerjen e VRRK-së. Nenet specifikojnë: cilat fusha duhet të mbulohen në vlerësim; si të formulohen dhe dorëzohen dokumentet e vlerësimit; si të krijohen udhëzime dhe të ndahen me agjencitë qeveritare; si të jepen rekomandime për agjencitë qeveritare; dhe si të njoftohen rezultatet e vlerësimit.

Neni 11 (6) i Dekretit të Presidentit për Rregullimin e Menaxhimit të Çështjeve Legjislative gjithashtu përcakton se kreu i një agjencie që propozon një projektligj duhet t'i kërkojë ACRC-së të kryejë VRRK-në në përputhje me nenin 28 të Ligjit të ACRC-së dhe nenin 30 të Dekretit për Zbatimin e ACRC-së, dhe se ACRC duhet ta njoftojë kreun e agjencisë për rezultatet e VRRK-së përpara shpalljes paraprake të legjislationit. Si i tillë, Dekreti institucionalizoi plotësisht zbatimin e VRRK-së në procesin formal legjislativ në Kore.

3. Objektivi i VRRK-së

Mjet i VRRK-s; është i dizajnuar për të identifikuar dhe parandaluar paraprakisht faktorët që shkaktojnë korrupsionin (p.sh. paqartësitë, irracionalizmat dhe zbrazëtirat) në kuadër të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve. Si i tillë, VRRK-ja synon gjithashtu: të analizojë dhe adresojë shkaktarin kryesor të korrupsionit në fushat e prirura për korrupsionin në kuadër të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve; të racionalizojë diskrecionet administrative; dhe të qartësojë proceset administrative. Me arritjen e objektivave të tilla, VRRK-ja synon të sjellë ndikime pozitive si parandalimi i korrupsionit; forcimi i themeleve për zbatimin e politikave efektive kundër korrupsionit; dhe përmirësimi i besueshmërisë dhe parashikueshmërisë së politikave.

Përfitimet e qasjes së VRRK-së

VRRK-ja ndihmon në zbutjen e rreziqeve aktuale dhe të ardhshme të korrupsionit që rrjedhin nga miratimi dhe rishikimi i projektligjeve, si dhe në kuadër të ligjeve dhe rregulloreve aktuale. Në periudhën afatgjatë, VRRK-ja mund të ndihmojë në përmirësimin e transparencës së ofrimit të shërbimeve publike dhe perceptimit pozitiv të publikut ndaj administratës publike, duke u dhënë kështu më shumë legjitimitet aktiviteve, vendimeve dhe veprimeve të administratës publike. Si i tillë, VRRK-ja është në përputhje me Synimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) 16 të Agjendës 2030, i cili synon në mënyrë specifike "reduktimin e ndjeshëm të korrupsionit dhe rryshfjetit në të gjitha format e tyre" (16.5) dhe "zhvillimin e institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet" (16.6).

Më konkretisht, VRRK-ja kontribuon në gjenerimin e përfitimeve të mëposhtme.

1. Përmirësimi i transparencës dhe drejtësisë në praktikat administrative publike

Kriteret e VRRK-së janë hartuar në mënyrë që amendamentet e rekomanduara përmes VRRK-së t'u japin agjencive qeveritare udhëzime specifike si të përmirësojnë transparencën dhe drejtësinë e praktikave të administratës publike të parapara në ligj. Mekanizmi i zbutjes së rrezikut ndaj korrupsionit në administratën publike forcon parimet e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit. Ai nxit konkurrencën e ndershme dhe vlerën për paratë, duke shfrytëzuar burimet e rritjes dhe punësimit.

Për shembull, kriteret e tilla si "përshtatshmëria e rregullave disiplinore" dhe "potenciali për keqalokim ose keqpërdorim të përkrahjes qeveritare" reduktojnë rreziqet e korrupsionit, duke përfshirë shpërdorimin e mundshëm të financimit të qeverisë dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të procedurave administrative publike.

VRRK-ja mund të përmirësojë edhe kënaqshmërinë e publikut me administratën publike, duke e bërë më të transparent dhe më të drejtë procesin administrativ të qeverisë dhe mekanizmin e ofrimit të shërbimeve publike. Kriteret e VRRK-së, si 'racionaliteti i kostove të pajtueshmërisë', 'qasshmëria', 'hapja' dhe 'qartësia në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ', mund të përdoren për të rritur transparencën dhe drejtësinë e procedurave administrative, duke përmirësuar edhe kënaqshmërinë e qytetarëve.

Kriteri i "racionalitetit të kostove të pajtueshmërisë" u ofron institucioneve qeveritare mundësi që të shqyrtojnë nëse kostot e zbatimit të vendosura ndaj publikut janë tepër të tepruara. Duke racionalizuar shpenzimet e tepërta të pajtueshmërisë, qytetarët mund të kursejnë kohën dhe përpjekjet e nevojshme për përbalimin e kostove të rënda të pajtueshmërisë të parashikuara në projektligje, ligje dhe rregullore.

Kriteri i "qasshmërisë" shqyrton nëse institucionet qeveritare po ofrojnë mundësi të mjaftueshme për publikun që të marrë pjesë në proceset administrative. Duke promovuar më shumë mundësi për pjesëmarrje qytetare, publiku mund t'i shprehë më mirë opinionet e veta gjatë procesit të hartimit të politikave. Duke i ftuar qytetarët në procesin e vendimmarrjes dhe duke përfshirë opinionet e tyre, mundësohet zhvillimi i një politike që i reflekton më mirë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Kriteri i "hapjes" shqyrton praktikën e institucioneve publike për shpалosjen e informacionit. Duke shfrytëzuar këtë kriter për të zgjeruar shpалosjen e informacionit të lidhur me procesin administrativ, mund të rritet transparenca dhe llogaridhënia e procesit administrativ. Publiku gjithashtu mund të përfitojë nga ky kriter, pasi mund të ketë qasje më të lehtë në informacionin cilësor që lidhet me procesin administrativ, çka mund të mos ketë qenë e mundur pa procesin e VRRK-së.

Së fundmi, kriteri i "qartësisë në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ" shqyrton nëse qytetarët mund të kuptojnë dhe parashikojnë qartë si do t'i ofrojë qeveria shërbimet publike dhe si do t'i trajtojë procedurat administrative. Ky kriter u lejon qytetarëve t'i kuptojnë më mirë dhe të parashikojnë procedurat administrative, çka u mundëson qytetarëve t'i kalojnë procedurat administrative dhe të marrin shërbime publike. Kjo mund të përshpejtojë procesin administrativ dhe kështu qytetarët kanë gjasa të jenë më të kënaqur me ofrimin më të shpejtë dhe më të parashikueshëm të shërbimeve publike dhe me procesin administrativ.

2. Rritja e kapaciteteve të brendshme të institucioneve publike kundër korrupsionit

Zbatimi konsistent i VRRK-së mund të ndihmojë edhe në identifikimin e tendencave të korrupsionit dhe zonave të cenueshme nga korrupsioni në administratën publike. Kjo mund të ndihmojë më tej në rritjen e kapaciteteve institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe për të shtuar strategjitë kombëtare kundër korrupsionit.

Në veçanti, duke ofruar kritere racionale dhe logjike, VRRK-ja ndihmon në nxitjen e të kuptuarit të përbashkët të iniciativave kundër korrupsionit dhe strategjive kundër korrupsionit në institucionet publike që angazhohen në këtë proces. Prandaj, VRRK-ja mund të shërbejë si mjet për ngritjen e vetëdijes për parandalimin e korrupsionit, si dhe të ofrojë mundësi për agjencinë kundër korrupsionit që të demonstrojë se si iniciativat e saja kundër korrupsionit janë të zbatueshme për institucionet e tjera qeveritare.

VRRK-ja ka edhe vlera edukative. Kur ACRC-ja kryen VRRK-në dhe ndan rekomandime me ministrinë e qeverisë, kjo siguron perspektiva të reja për zyrtarët qeveritarë, pasi ata bëhen të vetëdijshëm për rreziqet e korrupsionit që ata nuk ishin në gjendje t'i identifikonin vetë. Ata njihen më mirë me konceptet kundër korrupsionit dhe, me kalimin e kohës, mund të ndërtojnë kapacitetet e veta për zbulimin e rreziqeve të korrupsionit në kornizën ligjore dhe të politikave. Përmes praktikave të përsëritura të VRRK-së dhe konsultimeve me institucionet qeveritare, VRRK kthehet në një instrument trajnimi që informon institucionet qeveritare për aspektet që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të projektligjeve/ligjeve.

Duke mësuar nga rekomandimet e VRRK-së, ministrat mund t'i zbulojnë më mirë rreziqet e korrupsionit në kuadër të dispozitave ligjore gjatë hartimit të projektligjeve në të ardhmen. Në rastin e Koresë, institucionet qeveritare që kanë marrë rekomandimet e VRRK-së kanë konstatuar se janë shumë të dobishme për punën e tyre, pasi VRRK-ja u ka ndihmuar të parandalojnë dëme potenciale dhe të kursejnë përpjekjet shtesë për të reaguar ndaj aktiviteteve të korrupsionit të cilat mund të kishin ndodhur për shkak të zbrazëtive në propozimet e tyre legjislative.

3. Ruajtja e parave të taksapaguesve dhe zvogëlimi i ryshfetit

VRRK-ja ndihmon financat publike duke zbuluar dispozita ligjore që paraqesin potencial të keqalokimit ose shpërdorimit të llojeve të ndryshme të përkrahjes së qeverisë, duke përfshirë subvencionet. Për më tepër, VRRK-ja ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve të ryshfetit dhe lobimit të paligjshëm në ofrimin e shërbimeve publike. Me tej, duke adresuar shkaqet e mundshme të rasteve të korrupsionit, VRRK-ja mund të ndihmojë në reduktimin e kostove ekonomike dhe sociale të marrjes së masave pasi të ketë ndodhur korrupsioni, të cilat janë më të mëdha sesa parandalimi i korrupsionit në radhë të parë.



III.

METODOLOGJIA DHE ADMINISTRIMI
I VRRK-SË NË KORE

III METODOLOGJIA DHE ADMINISTRIMI I VRRK-SË NË KORE

Baza ligjore për VRRK-në

1. Baza ligjore

Siç është përmendur më parë në sfondin dhe bazën ligjore të seksionit të VRRK-së, Ligji i ACRC-së dhe Dekreti për Zbatimin e ACRC-së përcaktojnë mandatin e qartë për administrimin e VRRK-së. Nenet dhe dispozitat specifike të pohuara në Ligjin e ACRC-së dhe Dekretin për Zbatimin e ACRC-së i japin ACRC-së autoritetin e ligjshëm për të kryer VRRK-në për projektligjet, ligjet dhe rregulloret e propozuara nga organet ekzekutive. Nenet kyçe që specifikojnë mandatet e ACRC-së dhe obligimet e institucioneve qeveritare në lidhje me VRRK-në janë ilustruar në kutinë e mëposhtme.

Përmbledhje e neneve kyçe në legjislacion që përcaktojnë administrimin e VRRK-së në Republikën e Koresë

Nenet kyçe ku janë paraparë mandatet e ACRC-së

◦ Ligji i ACRC-së

- Neni 12 (5): ACRC-ja mund të hartojë dhe ofrojë iniciativa dhe masa përmirësimi institucional për institucionet publike për të parandaluar korrupsionin
- Neni 28 (1): ACRC-ja mund të analizojë dhe shqyrtojë faktorët që shkaktojnë korrupsionin në kuadër të ligjeve (d.m.th. aktet ligjore, dekretet presidenciale, dekretet e kryeministrit dhe të ministrive), statuteve të varura (d.m.th. direktivat, aktvendimet, rregullat dhe njoftimet publike), rregulloreve dhe rregullave komunale, si dhe mund t'u rekomandojë krerëve të organizatave publike përkatëse të bëjnë korrigjime
- Neni 28 (2): Procedurat dhe metodat e VRRK përcaktohen me Dekretin Presidencial (d.m.th. neni 30 i Dekretit për Zbatimin e ACRC-së)
- Neni 29 (1): ACRC-ja mund të kërkojë nga çdo institucion publik që të dorëzojë dokumente (p.sh. shpjegime, materiale, dokumente etj.) dhe mund të kryejë një ekzaminim në terren për të shqyrtuar gjendjen operacionale të institucionit publik

◦ Dekreti për Zbatimin e ACRC-së

- Neni 30 (1): ACRC-ja mund të kryejë VRRK-në për ligjet, statutet e varura, rregulloret dhe rregullat komunale për të gjetur dhe hequr faktorët që shkaktojnë korrupsionin, në përputhje me nenin 28 të Ligjit të ACRC-së
- Neni 30 (2): Për ta kryer VRRK-në në mënyrë efikase, ACRC-ja mund të vendosë udhëzime për VRRK-në (p.sh. objektet, kriteret, metodologjia dhe planet e vlerësimit) dhe mund t'ia komunikojë udhëzimet kreut të një organizate publike
- Neni 30 (3): Gjatë kryerjes së VRRK-së, ACRC-ja mund të kërkojë nga kreu i një organizate publike që të dorëzojë materialet e nevojshme të vlerësimit dhe kreu përkatës i organizatës bashkëpunon me ACRC-në
- Neni 30 (4): Kur ACRC-ja i ofron kreut të një organizate publike rekomandimet e VRRK-së për të hequr faktorët e rrezikut të korrupsionit, i jep kreut të organizatës përkatëse një njoftim me shkrim (që përmban detaje të rekomandimeve dhe afatin kohor për zbatimin e veprimeve korrigjuese)
- Neni 30 (7): Qeveria lokale mund t'i kërkojë ACRC-së që të kryejë VRRK-në për rregulloret komunale
- Neni 33 (1): Kur ACRC-ja kërkon nga organizata publike që të paraqesë dokumentet e nevojshme në përputhje me nenin 29 (1) të Ligjit të ACRC-së, i dorëzon një kërkesë me shkrim organizatës publike përkatëse
- Neni 33 (2): Kur ACRC kryen ekzaminim në terren, në përputhje me nenin 29 (1) të Ligjit të ACRC-së, duhet të dorëzojë paraprakisht njoftimin me shkrim (që përmban detajet e qëllimit të ekzaminimit, datën, vendndodhjen, informacionin mbi hetuesin etj.) për organizatën publike në fjalë

Nenet kyçe që përcaktojnë organizimin dhe menaxhimin e grupit këshillues të VRRK-së

▫ Ligji i ACRC-së

- Neni 24: ACRC-ja mund të organizojë një grup këshillimor dhe të kërkojë këshillat e tyre për përmbushjen e detyrave të ACRC-së në përputhje me nenin 31 të Dekretit për Zbatimin e ACRC-së

▫ Dekreti për Zbatimin e ACRC-së

- Neni 31: ACRC-ja mund të organizojë një grup këshillues për ta kryer VRRK-në në mënyrë të drejtë dhe profesionale. Çështjet e nevojshme për organizimin dhe menaxhimin e grupit këshillues përcaktohen nga kryesuesi, pas miratimit të rezolutës së Bordit.

Nenet kyçe që përcaktojnë detyrimet e institucioneve qeveritare që i nënshtrohen VRRK-së

▫ Ligji i ACRC-së

- Neni 3 (1): Institucionet publike kanë përgjegjësinë për të bërë përpjekje për të parandaluar shfaqjen e korrupsionit

▫ Dekreti për Zbatimin e ACRC-së

- Neni 30 (9): Kreu i një organizate të shërbimit publik mund të kërkojë nga ACRC-ja që të kryejë VRRK-në për rregullat dhe aktet nënligjore të brendshme të organizatës së vet (duke përfshirë rregullat dhe aktet nënligjore që dëshirojnë të miratojnë ose rishikojnë)

▫ Rregulloret për Menaxhimin e Çështjeve Legjislative

- Neni 11 (6): Kreu i një agjencie qeveritare që propozon një projektligj duhet të kërkojë nga kryesuesi i ACRC-së që ta kryejë VRRK për projektligjin në fjalë në përputhje me nenin 28 të Ligjit të ACRC-së dhe nenin 30 të Dekretit për Zbatimin e ACRC-së.

2. Mandati dhe përgjegjësitë e ACRC-së dhe udhëzimet e qeverisë që i nënshtrohen VRRK

Nenet dhe dispozitat e përmendura më lart, e shprehin qartë mandatin e ACRC-së për të zhvilluar metodologjinë e VRRK-së dhe për të kryer VRRK-në për identifikimin dhe heqjen e faktorëve që shkaktojnë korrupsion në kuadër të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve.


Kur organizatat publike hartojnë propozime legjislative për të miratuar ose rishikuar aktet ligjore dhe statutet e varura, ata duhet të kërkojnë nga ACRC-ja që të kryejë VRRK-në për propozimin e tyre legjislativ, si dhe duhet të dorëzojnë materialet e nevojshme të vlerësimit në ACRC. ACRC-ja përdor kriteret e VRRK-së për të shqyrtuar faktorët e rrezikut të korrupsionit në kuadër të propozimeve legjislative dhe ndan rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së me organizatat publike përkatëse. Pas marrjes së rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së, organizatat publike e ndryshojnë propozimin legjislativ bazuar në rekomandimet e ACRC-së.

ACRC-ja mund të kërkojë ndihmë nga një grup këshillues ose ekspertë të jashtëm për të shfrytëzuar aftësitë dhe ekspertizën e tyre gjatë kryerjes së VRRK-së. Grupi këshillues dhe ekspertët japin opinione këshilluese për faktorët e vetvetishëm që shkaktojnë korrupsionin në kuadër të ligjeve dhe institucioneve. Grupet e ekspertëve gjithashtu shqyrtojnë mundësinë e pajtueshmërisë së agjencisë me rezultatet e vlerësimit ose arsyet e saj për mos zbatimin e rekomandimeve të VRRK-së.

Fushëveprimi i VRRK-së

VRRK-ja kryhet për aktet ligjore dhe statutet e varura, rregullat administrative, rregulloret komunale, dhe rregullat dhe aktet nënligjore të organizatave të shërbimeve publike. Legjislacioni që i nënshtrohet VRRK-së ilustron në figurën e mëposhtme.

Legjislacioni që i nënshtrohet VRRK-së



Teksa VRRK-ja që kryhet për aktet ligjore dhe statutet e varura menaxhohet nga divizioni VRRK-së i ACRC-së, organizatat publike që kanë autoritetin për të miratuar ose rishikuar rregullat administrative, rregulloret komunale dhe rregullat dhe aktet nënligjore të organizatave të shërbimeve publike, kryejnë vlerësime autonome. Në raste të tilla, divizioni i vlerësimit në kuadër të organizatës përkatëse kryen VRRK-në për propozimet legjislative të hartuara nga divizioni i hartimit. Nëse divizioni i vlerësimit përballet me sfida në kryerjen e VRRK-së vullnetare, institucioni qeveritar mund të kërkojë nga ACRC-ja që ta kryejë VRRK në emër të organizatës, për të siguruar që rreziqet e korrupsionit të identifikohen dhe zbuten siç duhet. Rolet dhe përgjegjësitë specifike të institucioneve qeveritare dhe ACRC-së janë shpjeguar më tej në tabelën e mëposhtme.

Administrimi i Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit

Legjislacioni që i nënshtrohet VRRK-së	Institucionet publike që i nënshtrohen VRRK-së	Veprimet e ACRC-së
Projekt aktet ligjore dhe statutet e varura/aktet ligjore dhe statutet e varura të rishikuara	Projektligjet/Projektligjet e rishikuara	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Kryen VRRK para datës së mbylljes së para-shpalljes së legjislacionit (përgjithësisht brenda 40 ditëve) ▫ Nëse është e nevojshme, gjithashtu shqyrton dispozitat aktuale që mund të kenë faktorë që shkaktojnë korrupsion
Aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale	Plani afatmesëm/afatgjatë	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Dorëzojnë objektet e vlerësimit për ligjet aktuale ▫ Përzgjedh dhe shqyrton objektet e vlerësimit afatmesëm/afatgjatë
	Çështje të spikatura	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Prioritizon objektet e vlerësimit për të adresuar çështjet urgjente dhe të spikatura
Rregullat administrative	Projekt-rregull/rregulli i rishikuar	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Operojnë sisteme të brendshme të vlerësimit autonom (në parim) ▫ Kërkojnë nga ACRC-ja të kryejë VRRK kur miratojnë ose rishikojë rregulla të caktuara administrative, të cilat më parë janë rishikuar sipas rekomandimit të VRRK-së së ACRC-së, ose kur nuk ka gjasa për përmirësime autonome
	Rregullat aktuale	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Dorëzojnë materialet relevante të vlerësimit kur kërkohet nga ACRC-ja ▫ Zhvillon dhe shpërndan doracakët e brendshëm të VRRK-së dhe ofron trajnime për institucionet publike ▫ Kryen VRRK-në për rregullat e kërkuara administrative (përgjithësisht brenda 40 ditëve, ngjashëm me vlerësimin e akteve ligjore dhe statuteve) ▫ Përzgjedh dhe vlerëson rregullat administrative me faktorët që shkaktojnë korrupsion ▫ Gjatë kryerjes së VRRK-së për aktet ligjore dhe statutet, shqyrton edhe rregullat përkatëse administrative kur është e nevojshme
Rregulloret komunale	Projekt rregulloret/rregulloret e rishikuara	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Operojnë sisteme të brendshme të vlerësimit autonom (në parim) ▫ Kërkojnë nga ACRC-ja të kryejë VRRK-në nëse nuk ka gjasa për përmirësime autonome
	Rregulloret aktuale	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Zhvillon dhe shpërndan doracakët e brendshëm të vlerësimit dhe ofron trajnime për institucionet publike ▫ Vlerëson rregulloret komunale sipas kërkesës ▫ Përzgjedh dhe vlerëson rregulloret komunale me faktorët që shkaktojnë korrupsion
Rregullat për organizatat e shërbimeve publike	Projekt rregullat/rregullat e rishikuara dhe rregullat aktuale	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Zhvillon dhe shpërndan doracakët e brendshëm të VRRK-së dhe ofron trajnime për institucionet publike ▫ Vlerëson aktet themeluese dhe aktet nënligjore sipas kërkesës

Sipas Ligjit të ACRC-së, ACRC-ja mund të kryejë VRRK për projektligjet, ligjet dhe rregulloret e miratuara ose të rishikuara nga organizatat ekzekutive, qeveritë lokale dhe organizatat e shërbimeve publike. Teksa ligji i ACRC-së nuk e kufizon mandatin e ACRC-së vetëm në shqyrtimin e projektligjeve të propozuara nga ministrinë e qeverisë, projektligjet e propozuara nga parlamentarët nuk vlerësohen sipas VRRK-së në kontekstin e Koresë. Arsyeja për fushëveprimin e VRRK-së së ACRC-së shpjegohet më tej në kutinë e mëposhtme.

Arsyetimi për fushëveprimin e VRRK-së së ACRC-së

ACRC-ja është e vendosur nën Zyrën e Kryeministrit dhe është pjesë e krahut ekzekutiv të qeverisë. Prandaj, i është dhënë mandati nga Ligji i ACRC-së për të kryer VRRK-në për projektligjet e nxjerra nga dega ekzekutive. Në këtë strukturë institucionale, ACRC-ja natyrisht fokusohet në kryerjen e VRRK-së për projektligjet e hartuara nga dega ekzekutive.

Përveç kësaj, mund të ketë ndjeshmëri rreth kryerjes së VRRK-së për projektligjet e paraqitura nga deputetët individualë, pasi ato projektligje mbajnë emra të veçantë të deputetëve, andaj disa deputetë mund të reagojnë negativisht ndaj ndryshimeve të propozuara nga një agjenci kundër korrupsionit, përveç nëse asaj agjencie i është dhënë mandat i qartë ligjor me ligj.

Megjithatë, sapo projektligji të miratohet nga parlamenti dhe të kthehet ligj, ACRC pastaj mund të kryejë VRRK-në për një ligj të tillë kur organet qeveritare kërkojnë të rishikojnë disa dispozita.

1. Aktet ligjore dhe statutet e varura

Çdo agjenci administrative që ka për qëllim të miratojë ose rishikojë një statut të veçantë, duhet të dërgojë propozime legjislative dhe materiale vlerësimi në ACRC, si dhe të kërkojë VRRK-në sapo agjencia të fillojë konsultimet me agjencitë përkatëse. Aktet ligjore dhe statutet e varura të cilat i nënshtrohen VRRK-së përfshijnë aktet ligjore, dekretet presidenciale, dekretet e kryeministrit dhe urdhëresat e ministrive. Si projektligjet ashtu edhe ligjet ekzistuese bien nën fushëveprimin e vlerësimit të ACRC-së. Megjithatë, metodat dhe procedurat e vlerësimit ndryshojnë në varësi të faktit nëse VRRK-ja kryhet për një projektligj ose një ligj ekzistues.

Për vlerësimin e projektligjeve, çdo agjenci përkatëse duhet të dorëzojë në ACRC projektligjet me materiale vlerësimi, dhe të kërkojë VRRK-në. ACRC-ja vlerëson rreziqet e korrupsionit që mund të rezultojnë nga miratimi ose ndryshimi i akteve ligjore dhe statuteve nënligjore. ACRC-ja gjithashtu shqyrton dispozitat përkatëse aktuale që konsiderohen se kanë faktorë që shkaktojnë korrupsion, kur shihet e nevojshme. Pas përfundimit të vlerësimit, ACRC-ja informon agjencitë përkatëse për rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet, në mënyrë që të mund të adresohen faktorët e rrezikut të korrupsionit në kuadër të projektligjeve.

Për vlerësimin e ligjeve aktuale, ACRC-ja mund të formulojë dhe zbatojë një plan vlerësimi afatmesëm/afatgjatë. Pas vendosjes së planit të vlerësimit që shënjestron ligje dhe rregullore specifike që kanë faktorë që shkaktojnë korrupsion, ACRC-ja kërkon nga agjencitë administrative qendrore dhe qeveritë lokale që të dorëzojnë materialet relevante të vlerësimit. Pastaj, ACRC-ja i përdor materialet e dorëzuara për të kryer VRRK-në për ligjet dhe rregulloret në fjalë.

Për kryerjen e VRRK-së për ligjet dhe rregulloret aktuale, ACRC-ja mund të zgjedhë edhe objektet e vlerësimit (p.sh. zonat e prirura ndaj korrupsionit, zonat ku kanë ndodhur skandalet e fundit të korrupsionit ose zonat ku janë zbuluar disa probleme të korrupsionit gjatë VRRK-së paraprake) dhe të kryejë VRRK-në për objektet e përzgjedhura. Kjo është qasja që preferon zakonisht ACRC-ja kur kryen VRRK për ligjet dhe rregulloret aktuale.

Në të dyja rastet, pas kryerjes së një procesi të brendshëm të zgjidhjes, ACRC-ja e kryen VRRK-në duke u bazuar në materialet e vlerësimit bazë të paraqitura nga agjencitë përkatëse qeveritare gjatë periudhës së dhënë të vlerësimit. Pas vlerësimit, ACRC-ja ndan rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së me organizatat përkatëse për të siguruar që të bëhen përmirësimet e nevojshme.

2. Rregullat administrative

Në parim, agjencitë publike që miratojnë ose rishikojnë rregulla administrative (të cilat përfshijnë direktiva, rregullore, lajmërimi, njoftime dhe udhëzime) janë përgjegjës për kryerjen e një VRRK-je autonome për rregullat administrative përkatëse. ACRC-ja ofron doracakët e VRRK-së dhe listat kontrolluese të vlerësimit që mbështesin agjencitë publike në zhvillimin e mekanizmave të vetë-vlerësimit.

Gjithashtu, ACRC mund ta kryejë VRRK-në për rregullat administrative të miratuara ose të rishikuara kur: a) agjencia publike është duke miratuar ose ndryshuar rregullin administrativ të rishikuar më parë sipas rekomandimit të ACRC-së; dhe b) agjencia publike është duke u ballafaquar me sfida në realizimin e përmirësimeve autonome. Në raste të tilla, agjencitë përkatëse publike duhet të kërkojnë nga ACRC-ja të kryejë VRRK-në në emër të organizatave të tyre, dhe ACRC-ja, në përgjithësi, e përfundon vlerësimin brenda 40 ditëve dhe ia njofton rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së organizatave përkatëse.

Për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në rregullat aktuale administrative, ACRC-ja zgjedh rregulla specifike administrative si objekte vlerësimi që janë dëmtuar nga skandalet e korrupsionit. Kur ACRC kryen VRRK-në për projekt-aktet ligjore/aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale, mund të shqyrtojë edhe rregullat përkatëse administrative për të identifikuar dhe hequr efektivisht faktorët e rrezikut të korrupsionit kur ligjet në fjalë delegojnë mandate specifike ose procedura administrative në rregullat e varura administrative.

3. Rregulloret komunale

Divizioni i vlerësimit (p.sh. zyra e auditimit dhe inspektimit dhe zyra ligjore) i qeverisjes lokale ka mandatin për të kryer në mënyrë autonome VRRK-në për projekt-rregulloret/rregulloret aktuale komunale (të cilat përfshijnë urdhëresat dhe rregullat komunale).

Megjithatë, ACRC-ja mund ta kryejë VRRK-në edhe për rregulloret komunale kur: a) kërkohet nga qeveria lokale; ose b) kur rregulla të caktuara komunale lidhen me skandalet e korrupsionit dhe qytetarët ngrenë zërin për të ndërmarrë veprime korrigjuese. Në rastet kur opinionet kontradiktore mes zyrave përkatëse pengojnë procesin e VRRK-së, kreu i qeverisjes lokale mund të kërkojë nga ACRC-ja ta kryejë VRRK në emër të organizatës. Kur ndodhin skandale të korrupsionit të lidhura me rregullore të caktuara të komunës, ose kur rregulla të veçanta komunale konsiderohen të kenë faktorë që shkaktojnë korrupsion, ACRC-ja mund ta kryejë drejtpërdrejtë VRRK-në për rregulloret e tilla komunale.

4. Rregullat dhe aktet nënligjore për organizatat e shërbimeve publike

Ngjashëm me VRRK-në e kryer për rregulloret komunale, çdo organizatë e shërbimit publik përdor një sistem vlerësimi autonom të përshtatur për kontekstet e veta institucionale. Rregullat (që përfshijnë aktet e themelimit, rregullat e brendshme dhe aktet nënligjore) të organizatës së shërbimit publik mund të jenë subjekt i vlerësimit të ACRC-së kur kjo kërkohet nga kreu i organizatës. Në këtë rast, ACRC-ja mund ta kryejë VRRK-në për rregullat e brendshme dhe aktet nënligjore të organizatave të shërbimeve publike sipas nenit 30 (9) të Dekretit për Zbatimin e ACRC-së.

Kriteret e VRRK-së dhe lista kontrolluese e vlerësimit

VRRK-ja shqyrton projektligjet, ligjet dhe rregulloret duke përdorur katër fusha vlerësimi (respektivisht, pajtueshmërinë, ekzekutimin, procedurën administrative dhe kontrollin e korrupsionit). Për katër fushat e vlerësimit zbatohen 11 kriteret universale për të shqyrtuar faktorët e rrezikut të korrupsionit në legjisllacion. Për zbatimin efektiv të kriterëve të vlerësimit, ACRC-ja ka krijuar një listë të veçantë për secilin kriter, që e përdor për të zbuluar faktorët që shkaktojnë korrupsionin në kuadër të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve. Shpjegimi i hollësishëm i kriterëve të VRRK-së është ilustruar në tabelën e mëposhtme.

Kriteret e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit

Fusha e vlerësimit	Kriteret	Shpjegimi i kriterëve
Pajtueshmëria	Racionaliteti i kostove të pajtueshmërisë	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet a janë racionale shpenzimet e pajtueshmërisë (p.sh. kostoja ose sakrificat e vendosura ndaj publikut, kompanive apo organizatave për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në ligje) të përcaktuara në ligje dhe rregullore
	Përshtatshmëria e rregulloreve disiplinore	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet a janë të përshtatshme përmbajtja dhe niveli i sanksioneve të vendosura për shkeljen e legjislacionit
	Rreziku i dhënies së trajtimit preferencial	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet a gjenerohet trajtim ose përfitim preferencial për një kompani, organizatë ose person të caktuar kur zbatohet legjislacioni
Ekzekutimi	Konkretësia dhe objektiviteti i themelit të vendimmarrjes	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet nëse ligjet që lidhen me kompetencat diskrecionare (p.sh. ligjet që përcaktojnë: kush është i autorizuar të ushtrojë kompetencat, fushëveprimin e kompetencave, standardin dhe procedurën për ushtrimin e kompetencave etj.) janë shprehur në mënyrë të qartë, të prerë, konkrete dhe objektive ▫ Të përcaktohet nëse janë vendosur mekanizmat e kontrollit për të parandaluar ushtrimin e tepruar të kompetencave diskrecionare
	Transparenca dhe llogaridhënia e dhënies në besim/komisionimit	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet nëse kushtet, fushëveprimi dhe kufizimet e dhënies në besim/komisionimit, dhe procedurat e përzgjedhjes, etj., janë të përcaktuara qartë dhe të shprehura në ligje dhe rregullore ▫ Të përcaktohet nëse është vendosur mekanizmi i menaxhimit/monitorimit për të siguruar llogaridhënien për dhënien në besim/komisionimin
	Rreziku i keqalokimit ose keqpërdorimit të përkrahjes së qeverisë	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet nëse ka ndonjë përsëritje në përkrahjen financiare ▫ Të vlerësohen rreziqet e shpërdorimeve buxhetore që rezultojnë nga standarde të paqarta për përkrahjen financiare ▫ Të vlerësohet nëse mekanizmat e menaxhimit/monitorimit janë vendosur për të parandaluar shpërdorimet buxhetore
Procedurat administrative	Qasshmëria	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet nëse ofrohen mundësi të mjaftueshme për palët e interesit (përfshirë publikun, kompanitë dhe organizatat) për të marrë pjesë në procedurat administrative (p.sh. politikëbërja dhe kundërshtimi) ▫ Të kontrollohet nëse palët e interesit janë të përfaqësuara mirë kur mblidhen opinionet e tyre
	Hapja	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet nëse informacioni mbi proceset administrative (p.sh. dokumentet e kërkuara, procedurat e trajtimit, etj.) është i mjaftueshëm për palët e interesit dhe publikun
	Qartësia në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet nëse qytetarët që bëjnë kërkesa mund t'i kuptojnë procedurat administrative dhe të parashikojnë se çfarë lloj materialesh apo përgatitjeje kërkohet për të marrë shërbime administrative
Kontrolli i korrupsionit	Rreziku i konfliktit të interesit	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet nëse ka standarde, procedura ose mekanizma pas kontrollit për të parandaluar situatat e konfliktit të interesit (d.m.th. ndërhyrja e interesave private në procesin administrativ)
	Nevoja për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të përcaktohet nëse kërkohet krijimi i mekanizmave të kontrollit të korrupsionit ose zbatimi i ligjeve kundër korrupsionit për të parandaluar rreziqet e korrupsionit që rezultojnë nga zbatimi i projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve

Pajtueshmëria

1. Racionaliteti i kostove të pajtueshmërisë:

Ky kriter shqyrton a janë rationale dhe jo të tepruara shpenzimet që përballohen nga individët dhe bizneset për të përmbushur detyrimet e deklaruar në projektligje, ligjet dhe rregulloret. Kur kostot e pajtueshmërisë janë të tepruara, rritet rreziku i korrupsionit, pasi kjo i nxit aktorët që të shmangin ose lehtësojnë barrën duke paguar një rryshfet.

Ky kriter shqyrton në mënyrë specifike a) bazën ligjore për vendosjen e kostove të pajtueshmërisë, b) nevojën për vendosjen e kostove të pajtueshmërisë, dhe c) metodologjinë për racionalizimin e kostove të pajtueshmërisë.

a) Baza ligjore për vendosjen e kostove të pajtueshmërisë:

ACRC-ja vlerëson nëse kostot e zbatimit janë të vendosura në bazë të bazave ligjore konkrete që përcaktojnë qartë kërkesat dhe fushëveprimin e aplikimit. Shqyrtohet edhe nëse fushëveprimi i vendosjes së kostos së pajtueshmërisë është në përputhje me ligjet e prore.

Shënim

Compliance costs reviewed by ACRC include financial and non-financial compliance costs such as economic costs (e.g. cash disbursements and in-kind/service provisions), various types of legal acts and omissions, sacrifices, and opportunity costs.

b) Nevoja për vendosjen e kostove të pajtueshmërisë:

ACRC-ja vlerëson a është e nevojshme vendosja e kostove të pajtueshmërisë për arritjen e objektivave administrative të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve, duke shqyrtuar sfondin dhe arsyetimin për vendosjen e këtyre shpenzimeve.

c) Metodologjia për racionalizimin e kostove të pajtueshmërisë:

Kur faktorët e rrezikut të korrupsionit janë të kufizuara në fusha të caktuara, ACRC-ja shqyrton nëse fushëveprimi i kostove të pajtueshmërisë shtrihet në mënyrë të panevojshme në një publik të papërcaktuar (p.sh. vendosja e kostove dhe sakrificave për publikun e gjerë, kur duhet të zbatohet ndaj një individi apo grupi të caktuar). Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton nëse janë vendosur kosto të tepruara të pajtueshmërisë për publikun për hir të oportunitetit administrativ, ose nëse ekziston rreziku i një barrë shtesë të kostos që kufizon jetën e qytetarëve. Gjithashtu, shqyrtohen mundësitë e miratimit të masave alternative për të zëvendësuar/zbutur kostot e pajtueshmërisë.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të "racionalitetit të kostove të pajtueshmërisë"

1. A është shprehur qartë në projektligje, ligje dhe rregullore baza ligjore për vendosjen e kostove të pajtueshmërisë? A janë fushëveprimi dhe llojet e kostove të tilla në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjet e prore?
2. A është e domosdoshme vendosja e kostos së pajtueshmërisë për arritjen e objektivave administrative?
3. A janë kostot e zbatimit (fushëveprimi dhe niveli) të vendosura në nivelin minimal për arritjen e objektivave administrative?
4. A ka kosto të pajtueshmërisë të vendosura në mënyrë të panevojshme (p.sh. vendosja e barrës mbi grupe të shumta kur duhet të kufizohet vetëm në grupe të caktuara të qytetarëve)?
5. A ka rreziqe të vendosjes së kostove të tepruara të pajtueshmërisë?
6. Kur kostot e pajtueshmërisë konsiderohen të tepruara, a ka masa alternative për të zbutur dhe/ose zëvendësuar kostot e tepruara të pajtueshmërisë të parashikuara në projektligje, ligje dhe rregullore?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e “racionalitetit të kostove të pajtueshmërisë”

“Act on the Control of Military Uniforms and Accouterments”

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 5 (Revokimi i lejes, etj.)</p> <p>① Ministri i Mbrojtjes Kombëtare mund të revokojë lejen për biznesin e prodhimit ose shpërndarjes, ose ta pezullojë biznesin deri në 6 muaj.</p> <p>Me kusht që, nëse bie nën nënparagrafin 1, 2 ose 5, leja do të revokohet:</p> <p>4. Kur subjekti i biznesit nuk arrin të mbajë objektin që ka instaluar në kohën kur subjekti ka marrë lejen.</p>	<p>▫ Subjekti i biznesit duhet të pajiset me objekte të përcaktuara me Dekretin Presidential për të marrë leje për prodhimin dhe shpërndarjen e uniformave dhe pajimeve ushtarake.</p> <p>▫ Sipas nënparagrafit 4, subjekti i biznesit duhet të mbajë të njëjtin objekt si kur ka marrë lejen. Kjo mund të vendosë barrë të tepruar mbi subjektet, pasi u duhet të mbajnë objektet e tyre të vjetruara për të qenë në pajtim aktin, edhe kur objektet mund të shkallërriten duke adoptuar teknologji të reja.</p>	<p>Neni 5 (Revokimi i lejes, etj.)</p> <p>① (Njësoj si më parë)</p> <p>4. Kur subjekti i biznesit nuk arrin të mbajë në mënyrë të kënaqshme standardet e objektit të kërkuara për leje të tillë.</p>

2. Përshtatshmëria e rregulloreve disiplinore:

Ky kriter shqyrton nëse sanksionet e vendosura për shkelje të ligjeve dhe rregulloreve janë të tepruara ose të dobëta. Nivelet e papërshtatshme të sanksioneve mund të rrisin rreziqet e korrupsionit. Sanksionet tepër të rrepta mund të inkurajojnë aktorët që t’i shmangin sanksionet duke paguar një ryshfet, ndërkohë që sanksionet e lehta mund të ulin stimujt për të respektuar projektligjet, ligjet dhe rregulloret.

Ky kriter shqyrton a) rregulloret për sanksionet, b) nevojën për vendosjen e sanksioneve, c) sanksionet e ngjashme të përcaktuara në ligje të tjera, d) përshtatshmërinë e nivelit të sanksioneve, dhe e) masat për të racionalizuar sanksionet.

a) Rregulloret për sanksionet:

ACRC-ja vlerëson legjislacionin (p.sh. dispozitat e miratuara/rishikuara ose legjislacioni në tërësi) të lidhur me vendosjen e sanksioneve.

b) Nevoja për vendosjen e sanksioneve:

ACRC vlerëson cilat probleme synojnë të adresojnë sanksionet, shkakun rrënjësor të problemeve dhe objektivat administrative të vendosjes së sanksioneve. Gjithashtu, ACRC-ja vlerëson shkallën e kostove sociale dhe madhësinë e shkeljes së ligjeve dhe rregulloreve, si dhe shqyrton nëse kostot e tilla shoqërore mund të adresohen përmes masave alternative (p.sh. lënda civile dhe parimi i autonomisë private).

c) Sanksione të ngjashme të përcaktuara në ligje të tjera:

Për të shqyrtuar nëse niveli i sanksioneve është i përshtatshëm, ACRC-ja krahason sanksionet e përcaktuara në legjislacionin përkatës me sanksionet e vendosura nga ligjet dhe rregulloret e tjera në raste të ngjashme. Nëse rregulloret për sanksionet dëshmojnë se janë më strikte apo më të buta se rregulloret e ngjashme të përcaktuara në ligje dhe rregullore të tjera, ACRC-ja shqyrton nëse ka arsye të justifikueshme për dallime të tilla.

d) Përshtatshmëria e nivelit të sanksioneve:

ACRC-ja shqyrton statusin specifik të një shkeljeje (lloji, shkalla, rëndësia, numri i shkeljeve) dhe sanksionet (lloji dhe niveli i sanksioneve) për të vlerësuar përshtatshmërinë e nivelit të sanksioneve (nëse sanksioni është i rreptë apo i butë).

e) Masat për të racionalizuar sanksionet:

Nëse niveli i sanksioneve konsiderohet i papërshtatshëm, ACRC-ja identifikon nivelin e përshtatshëm të sanksioneve. Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton nëse është e mundur të merren masa më efektive për të kontrolluar aktivitetet e paligjshme si korrupsioni, pa vendosur sanksione.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të "përshtatshmërisë së rregulloreve disiplinore"

1. A janë të nevojshme sanksionet e parashikuara në projektligje, ligje dhe rregullore kur sanksione të ngjashme janë parashikuar tashmë në ligje dhe rregullore, apo kur merren parasysh ndikimet sociale të shkeljes së ligjeve dhe rregulloreve?
2. A janë vendosur sanksione edhe pse mund të shfrytëzohen masa të mjaftueshme alternative (p.sh. rastet civile dhe parimi i autonomisë private) për të adresuar shkeljet e rregullave?
3. A ka arsye të justifikueshme për vendosjen e sanksioneve strikte/të butë kur merret parasysh shkalla e dëmit social që rrjedh nga shkelja e ligjeve dhe rregulloreve?
4. Duke marrë parasysh rëndësinë e problemit që rrjedh nga shkelja e ligjeve dhe rregulloreve, a është i përshtatshëm niveli i sanksioneve për të parandaluar shkeljet ligjore?
5. Nëse nivelet e sanksioneve janë të buta, a ka mundësi të dëmtohet parandalimi i korrupsionit?
6. Nëse nivelet e sanksioneve konsiderohen të papërshtatshme, cili është niveli i duhur i sanksioneve?
7. A ka masa më efektive për të kontrolluar korrupsionin, përveç vendosjes së sanksioneve?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e "përshtatshmërisë së rregulloreve disiplinore"

"Enforcement Regulation on Social and Economic Development and Support of Gyeongsangbuk-do"

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 6 (Revokimi i përcaktimit të Ndërmarrjeve Sociale Përgatitore)</p> <p>① Guvernatori mund të revokojë përcaktimin e ndërmarrjeve sociale përgatitore në rast se bie nën ndonjë nga nënparagrafët e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kandidatët janë emëruar në bazë të informatave të rreme ose me mjete të paligjshme; 2. Kandidatët nuk i plotësojnë më kushtet e nevojshme; <p>Shënim</p> <p>Një ndërmarrje sociale përgatitore është një subjekt biznesi që ofron shërbime sociale dhe vende pune për grupet e cenueshme shoqërore, teksa përgatitet të kthehet në ndërmarrje sociale.</p>	<p>Rreziqet potenciale të korrupsionit</p> <ul style="list-style-type: none"> ▫ Emërimi në bazë të informatave të rreme ose me mjete të paligjshme është një shkelje e rëndë e ligjit, prandaj përcaktimi duhet të anulohet në raste të tilla pa asnjë përjashtim. ▫ Emërimi duhet të revokohet nëse ndërmarrjet sociale përgatitore nuk përmbushin kërkesat minimale. ▫ Lejimi i guvernatorit që të vendosur revokimin e përcaktimit të ndërmarrjeve sociale përgatitore mund të inkurajojë subjektet që t'i paguajnë rryshfet guvernatorit për t'iu shmangur sanksioneve. 	<p>Rekomandimi i VRRK-së</p> <p>Neni 6 (Revokimi i përcaktimit të Ndërmarrjeve Sociale Përgatitore)</p> <p>① Guvernatori e revokon përcaktimin e ndërmarrjeve sociale përgatitore në rast se bie nën ndonjë nga nënparagrafët e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kandidatët janë emëruar në bazë të informatave të rreme ose me mjete të paligjshme; 2. Kandidatët nuk i plotësojnë më kushtet e nevojshme;

3. Rreziku i dhënies së trajtimit preferencial:

Ky kriter shqyrton rrezikun e projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve që u japin përfitime ose avantazhe individëve ose grupeve të qytetarëve. Rreziqet e korrupsionit mund të lindin kur nuk ka dispozita të qarta ligjore për rregullimin e trajtimit preferencial, pasi kjo mund t'i inkurajojë aktorët të paguajnë ryshfet për të marrë, mbajtur ose zgjeruar përfitimet ose avantazhet. Projektligjet, ligjet dhe rregulloret që janë të cenueshme nga trajtimi preferencial përfshijnë dispozitat që parashikojnë dhënien e kontratave, lejeve, licencave, subvencioneve, përjashtimeve nga taksat dhe përzgjedhjen e panelit të vlerësimit.

Kriteri shqyrton a) dispozitat që japin përfitime ose favore, b) rrezikun e dhënies së përfitimeve ose trajtimeve preferenciale për grupe të caktuara, c) nivelin e përshtatshëm të trajtimit preferencial dhe d) ekzistencën e mekanizmave kundër korrupsionit për të kontrolluar trajtimin preferencial.

a) Dispozitat që japin përfitime ose favore:

ACRC-ja shqyrton kërkesat, procedurat, përfituesit dhe objektivat e përfitimeve ose favoreve të parashikuara në dispozitat përkatëse. Gjithashtu, vlerësohen edhe legjislacioni dhe dispozitat administrative të cilat sigurojnë ose mund të sigurojnë përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton legjislacionin e varur nëse ligjet dhe rregulloret në fjalë përcaktojnë përfitime specifike ose trajtime preferenciale në statutet e varura.

b) Rreziku i dhënies së përfitimeve ose trajtimeve preferenciale për grupe të veçanta:

Për të shqyrtuar nëse projektligji, ligjet dhe rregulloret në fjalë japin përfitime që janë të kufizuara për persona, biznese ose organizata specifike, ACRC-ja krahason marrësit e përfitimeve ose trajtimeve preferenciale të përcaktuara në legjislacionin përkatës me ato të ligjeve të ngjashme.

c) Niveli i përshtatshëm i trajtimit preferencial:

për të shqyrtuar nëse projektligjet, ligjet dhe rregulloret e vlerësuara ofrojnë përfitime të tepruara, ACRC-ja krahason shkallën e përfitimeve ose avantazheve të përcaktuara në legjislacion me ato të ligjeve të ngjashme.

d) Ekzistenca e mekanizmave kundër korrupsionit për të kontrolluar trajtimin preferencial:

ACRC-ja shqyrton nëse është vendosur një mekanizëm kundër korrupsionit për të kontrolluar trajtimin preferencial që përmban faktorë që shkaktojnë korrupsion.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të "rrezikut të dhënies së trajtimit preferencial"

A ka ndonjë rrezik të dhënies së përfitimeve apo favoreve (duke përfshirë përfitimet ligjore dhe praktike) një personi të caktuar kur zbatohet ligji apo veprimi administrativ?

A i parashikojnë qartë dhe në mënyrë të drejtë dispozitat që japin përfitime ose favore përfituesit, procedurat për dhënien e trajtimit preferencial dhe objektivat e dhënies së përfitimeve apo favoreve të tilla?

A vlejnë përfitimet apo favorët e përcaktuara në dispozita vetëm për grupe të caktuara qytetarësh?

A janë të tepruar fushëveprimi dhe niveli i përfitimeve apo favoreve të parashikuara në projektligje, ligje dhe rregullore?

A është e nevojshme të krijohet një mekanizëm specifik për të kontrolluar trajtimet preferenciale apo përfitimet që mund të shkaktojnë korrupsion?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e "rrezikut të dhënies së trajtimit preferencial"

"Rregullorja e Zbatimit për Zhvillimin Social dhe Ekonomik dhe Përkrahjen e Gyeongsangbuk-do"

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 12 (Raportimi i Aktiviteteve të Përvojës Bregdetare)</p> <p>① Operatorët e aktiviteteve të përvojës bregdetare duhet të hartojnë planet e menaxhimit të sigurisë dhe t'ia raportojnë planet Drejtorit të Rojës Bregdetare. Kjo nuk do të zbatohet nëse bie nën ndonjë nga nënparagrafët e mëposhtëm:</p> <p>2. Ku një grup fetar kryen aktivitete të përvojës bregdetare</p>	<p>▫ Përfshajtimi i grupeve fetare nga hartimi dhe raportimi i planeve të menaxhimit të sigurisë mund të ofrojë përfitime për grupet fetare dhe të dëmtojë sigurinë publike.</p>	<p>Të fshihet nënparagrafi 2</p> <p>2. Ku një grup fetar kryen aktivitete të përvojës bregdetare</p>

Ekzekutimi

4. Konkretësia dhe objektiviteti i themelit të vendimmarrjes:

Ky kriter shqyrton nëse dispozitat në projektligje, ligje dhe rregullore përcaktojnë qartë fushëveprimin e kompetencave diskrecionare dhe mënyrën si ushtrohen ato. Ligjet dhe rregulloret mund t'u lejojnë zyrtarëve qeveritarë të ushtrojnë kompetenca diskrecionare, pasi funksionet e administratës publike janë bërë të larmishme dhe komplekse, çka mund të kërkojë fleksibilitet në vendimmarrje. Megjithatë, kjo mbart rreziqet e korrupsionit, pasi zyrtarët qeveritarë mund t'i interpretojnë në mënyrë arbitrare dispozitat mbi kompetencat diskrecionare dhe të abuzojnë me kompetencat e tyre për të përfituar ata që kanë paguar ryshfet.

Kriteri shqyrton a) qartësinë e personit që ushtron kompetenca diskrecionare, b) konkretësinë e kërkesave të kompetencave diskrecionare dhe mënyrën si ushtrohen ato, c) përshtatshmërinë e gamës së kompetencave diskrecionare, d) qartësinë e rregullave diskrecionare dhe e) ekzistencën e një mekanizmi kontrolli për të parandaluar ushtrimin e tepruar të kompetencave diskrecionare.

a) Qartësia e personit që ushtron kompetenca diskrecionare:

ACRC-ja shqyrton nëse zyrtarët qeveritarë ose institucionet e autorizuara për ushtrimin e kompetencave diskrecionare janë të përcaktuara qartë në projektligje, ligje dhe rregulloret.

b) Konkretësia e kërkesave të kompetencave diskrecionare dhe mënyra si ushtrohen ato:

ACRC-ja shqyrton nëse kërkesat, standardet dhe proceset për ushtrimin e kompetencave diskrecionare janë të shprehura qartë në projektligje, ligje dhe rregullore. Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton nëse kriteret kryesore të diskrecionit dhe proceset e diskrecionit që duhet të përcaktohen në aktet ligjore dhe në statutet e varura janë të përcaktuara në rregullat e varura administrative (p.sh. direktivat, rregullat e vendosura, njoftimet, udhëzimet etj.).

c) Përshtatshmëria e gamës së kompetencave diskrecionare:

ACRC-ja krahason aktivitetet e kompetencave diskrecionare dhe ndikimet e tyre të përcaktuara në legjislacion me ato të ligjeve dhe rregulloreve të ngjashme, për të shqyrtuar nëse fushëveprimi i kompetencave diskrecionare është i tepruar.

d) **Qartësia e rregulloreve diskrecionare:**

ACRC-ja shqyrton mundësitë e rreziqeve të korrupsionit që rezultojnë nga abuzimi ose interpretimi arbitrar i dispozitave diskrecionare. Nëse rezultatet e vlerësimit tregojnë se dispozitat diskrecionare janë të paqarta në projektligje, ligje dhe rregullore, ACRC-ja shqyrton nëse mbrojtësi i të drejtave themelore mund të parashikojë detajet e kompetencave diskrecionare, si dhe nëse ekziston një mekanizëm sigurie për të parandaluar ushtrimin arbitrar të kompetencave diskrecionare nga institucionet publike.

e) **Ekzistenca e një mekanizmi kontrolli për të parandaluar ushtrimin e tepruar të kompetencave diskrecionare:**

ACRC-ja shqyrton nëse për të kontrolluar kompetencat diskrecionare janë vendosur mekanizmat e pjesëmarrjes së palëve të interesit (p.sh. procesi i njoftimit paraprak, procesi i dëgjimit publik etj.). Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton funksionimin e sistemit publik në aspektin e shpalosjes publike të informacionit të lidhur me kompetencat diskrecionare (p.sh. shënimet e mbledhjes, dokumentet zyrtare, etj.).

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të "konkretësisë dhe objektivitetit të themelit të vendimmarrjes"

1. A e parashikojnë dispozitat kush i ushtron kompetencat diskrecionare?
2. A i parashikojnë qartë dispozitat kërkesat, standardet e gjykimit dhe procedurat për ushtrimin e kompetencave diskrecionare?
3. A janë standardet kryesore të diskrecionit dhe procedurat për ushtrimin e kompetencave diskrecionare të përcaktuara në rregullat administrative (p.sh. direktivat, rregullat e vendosura, njoftimet, udhëzimet), kur ato duhet të përcaktohen me ligje eprore?
4. A ka një kuptim të përbashkët të standardeve të diskrecionit mes grupeve që i nënshtrohen rregullimit dhe palëve të interesit? A është ky kuptim dhe interpretim i përbashkët i standardeve identik me interpretimin e kompetencave diskrecionare të zyrtarit administrativ?
5. A mund të zbatohen drejtpërsëdrejti standardet apo faktorët specifike të diskrecionit për konsideratat e parashikuara në dispozita, pa përdorur shpjegime shtesë apo udhëzime?
6. Kur legjislati përcakton standardet e diskrecionit dhe faktorët për konsideratat e dekretit presidencial, të urdhëresave të kryeministrit dhe të urdhëresave të ministrive, a zbatohen në mënyrë specifike dhe individuale dispozitat mbi standardet e diskrecionit dhe faktorët për shqyrtim?
7. A është e tepruar gama e kompetencave diskrecionare?
8. A lejojnë ligjet e varura dhe rregullat administrative kompetenca të reja diskrecionare për zyrtarët qeveritarë kur baza ligjore për ushtrimin e kompetencave të tilla diskrecionare nuk është përcaktuar në ligjet eprore?
9. A ka rreziqe që zyrtarët qeveritarë të abuzojnë ose të ushtrojnë në mënyrë arbitrare kompetenca diskrecionare që rezultojnë nga dispozita të paqarta diskrecionare?
10. A ka mekanizma kontrolli për të zbutur ndikimet negative të rregullave të paqarta diskrecionare?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e "konkretësisë dhe objektivitetit të themelit të vendimmarrjes"

"Dekreti për Zbatimin e Ligjit për Teknologët e Shërbimit Mjekësor, etj."		
Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 12 (Ri-lëshimi i licencave)</p> <p>② Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies nuk mund të ri-lëshojë licencën e anuluar nëse kjo konsiderohet e padrejtë, duke shqyrtuar shenjat e pendimit të treguara nga mbajtësi i licencës, si dhe detajet dhe motivet që shkaktuan anulimin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Licenca mund të ri-lëshohet nëse zgjidhet arsyeja e anulimit. Megjithatë, në rast të një shkeljeje të rëndë të ligjit, licenca nuk duhet të ri-lëshohet. ▫ "Pendimi" është gjendje abstrakte, dhe zyrtarët publikë mund ta interpretojnë në mënyrë arbitrare shenjën e pendimit dhe ta ri-lëshojnë një licencë, kur ajo duhet të anulohet në fakt. 	<p>Neni 12 (Ri-lëshimi i licencave)</p> <p>② Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies nuk mund ta ri-lëshojë një licencë të anuluar në rast se bie nën ndonjë nga nënparagrafët e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Licencat janë anuluar më shumë se një herë; 2.Licencat janë pezulluar më shumë se o herë.

5. Transparenca dhe llogaridhënia e dhënies në besim ose komisionimit:

Ky kriter shqyrton nëse projektligjet, ligjet dhe rregulloret i përcaktojnë qartë procedurat e dhënies në besim ose komisionimit që ndodhin kur institucionet qeveritare ua besojnë kompetencat ose funksionet e veta partnerëve të sektorit privat ose agjencive të tjera qeveritare. Dispozitat e dykuptimta dhe të paqarta mbi fushëveprimin, kërkesat, procedurat dhe monitorimin e dhënies në besim ose komisionimit mund të shkaktojnë rreziqe korrupsioni, pasi zyrtarët qeveritarë mund t'ia besojnë në mënyrë arbitrare punën e tyre agjencive me të cilat ata kanë lidhje të ngushta personale.

Kriteri shqyrton a) kërkesat dhe bazën ligjore për dhënien në besim/komisionimin, b) transparencën procedurale të dhënie në besim/komisionimit, c) përshtatshmërinë e menaxhimit dhe monitorimin e dhënies në besim/komisionimit, dhe d) mekanizmat ndëshkimorë për të trajtuar aktivitetet e paligjshme të institucioneve ofruese/të mirëbesimit

a) Kërkesat dhe baza ligjore për dhënien në besim/komisionimin:

ACRC-ja shqyrton nëse kërkesat dhe bazat ligjore për dhënien në besim/komisionimin janë përcaktuar qartë në projektligje, ligje dhe rregullore. Gjithashtu, shqyrtohet a i zbusin kërkesat e deklaruara në ligjet eprore objekti dhe fushëveprimi i dhënies në besim/komisionimit.

b) Transparenca procedurale e dhënies në besim/komisionimit:

ACRC-ja shqyrton nëse procesi i përzgjedhjes për dhënien në besim/komisionimin është përcaktuar në mënyrë specifike në projektligje, ligje dhe rregullore. Shqyrtohen edhe rreziqet që agjenci të caktuara të monopolizojnë dhënien në besim/komisionimin.

c) Përshtatshmëria e menaxhimit dhe monitorimit të dhënies në besim/komisionimit:

ACRC-ja shqyrton nëse janë kryer vlerësimet e institucioneve ofruese/të mirëbesimit për të arritur qëllimin e dhënies në besim/komisionimit. Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton nëse rregulloret përcaktojnë: dorëzimin e materialeve të nevojshme për menaxhimin e dhënies në besim/komisionimit; mirëmbajtjen e rregullt; dhe detyrimin e raportimit.

d) Mekanizmat ndëshkimorë për të trajtuar aktivitetet e paligjshme të institucioneve ofruese/të mirëbesimit:

ACRC-ja shqyrton nëse janë vendosur mekanizmat ndëshkimorë (p.sh. pezullimi i shërbimeve dhe revokimi i përcaktimeve, etj.) aktivitetet e paligjshme të institucioneve ofruese/të mirëbesimit.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të "transparencës dhe llogaridhënies së dhënies në besim/komisionimit"

1. A ka një bazë të qartë ligjore për dhënien në besim/komisionimin dhe a është qëllimi i dhënies në besim/komisionimit në përputhje me ligjin epror?
2. A ekziston rreziku i lejitimit të dhënies në besim/komisionimit të paligjshëm duke zbutur kërkesat e dhënies në besim/komisionimit të përcaktuara në ligjin epror?
3. A ekziston rreziku i dëmtimit të interesit publik dhe drejtësisë së veprimeve administrative si pasojë e dhënies në besim/komisionimit?
4. A parashikojnë dispozitat në mënyrë të qartë dhe të drejtë kriteret e përzgjedhjes, përshtatshmërinë e institucioneve të mirëbesimit dhe procedurat për dhënien në besim/komisionimin?
5. A janë zgjedhur agjencitë e mirëbesimit përmes një procesi të hapur të ofertimit? Nëse ka kufizime për pjesëmarrjen në ofertim, a janë kufizime të arsyeshme?
6. A shpalos institucioni informacion mbi kriteret e proceseve të përzgjedhjes për dhënien në besim/komisionimin?
7. Nëse agjencitë e mirëbesimit përzgjidhen ose revokohen përmes një procesi që nuk është përcaktuar në dispozitat ligjore për dhënien në besim/komisionimin (p.sh. me aktimin), a ka dispozita për të shpalosur rezultatet?
8. A janë periudha e dhënies në besim/komisionimit dhe numri i zgjatjeve të kontratave të përcaktuara qartë në legjislacion?
9. A ka rreziqe korrupsioni që rezultojnë nga monopolizimi i vazhdueshëm/i nënçmuar i dhënies në besim/komisionimit?
10. Për të arritur qëllimin e dhënies në besim/komisionimit, a ka dispozita që përcaktojnë krijimin e mekanizmave të përshtatshme të menaxhimit/monitorimit (p.sh. dorëzimi i detyrueshëm i raporteve, monitorimi i rregullt i kryer nga agjencia mbikëqyrëse etj.) për të inspektuar institucionet e mirëbesimit?
11. A ka dispozita që kërkojnë një proces konsultimi/aprovimi me institucionet e mirëbesimit kur institucionet e mirëbesimit/të komisionuara vendosin tarifat?
12. A ka sanksione për penalizimin e sjelljeve të paligjshme të organizatës së mirëbesimit (p.sh. anulimi apo pezullimi i dhënies në besim/komisionimit etj.) dhe masa reaguese për të adresuar ngjarje të tilla?
13. Nëse kërkohet sigurimi i llogaridhënies, a ka dispozita që i njohin punonjësit e institucioneve të mirëbesimit si zyrtarë publikë kur penalizohen veprimet e tyre të paligjshme?
14. Kur organizatat e mirëbesimit shkelin ligjet dhe rregulloret, a ka dispozita për kthimin e subvencioneve të dhëna organizatës së mirëbesimit?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e "transparencës dhe llogaridhënies së dhënies në besim/komisionimit"

"Ligji për Menaxhimin e Ujërave dhe Përkrahjen e Banorëve në Pellgun e Katër Lumenjve të Mëdhenj"

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 11 (Qendra për Menaxhimin Ekologjik dhe Mbështetjen e Vijës Ujore)</p> <p>① Kombi mund të themelojë ose të caktojë një institut/organizatë hulmuese ose korporatë private për të shërbyer si Qendra për Menaxhimin Ekologjik dhe Mbështetjen e Vijës Ujore (në tekstin e mëtejshëm: Qendra për Mbështetje).</p> <p>③ Krerët e organizatave përkatëse administrative mund të kanalizojnë fonde ose të sigurojnë përkrahje tjetër të nevojshme për Qendrën për Mbështetje..</p>	<p>▫ Legjislacioni përcakton institutet/organizatat hulmuese si operues të programeve në emër të kombit. Megjithatë, nuk ka asnjë dispozitë që përcakton si do të hetohen ose mbikëqyren programet e tyre.</p> <p>▫ Legjislacioni, gjithashtu, lejon që agjencitë qeveritare të sigurojnë përkrahje financiare për institucionet hulmuese të mirëbesimit, por nuk përcakton si do të vendosen sanksione për të penalizuar aktivitetet e paligjshme të organizatave të mirëbesimit.</p>	<p>Neni 11 (Qendra për Menaxhimin Ekologjik dhe Mbështetjen e Vijës Ujore)</p> <p>④ – ③ (Njësoj si më parë)</p> <p>④ Në përputhje me nenin 3 të ligjit, drejtuesit e organizatave përkatëse administrative mund të marrin raporte, ose të kryejnë hetime dhe mbikëqyrje mbi punën e Qendrës për Mbështetje të përshkruar me dekretet presidenciale. Të shtohet dispozita Neni 00 (Emërimi dhe Anulimi i Qendrës së Mbështetjes)</p> <p>① Krerët e organizatave përkatëse administrative mund të anulojnë përcaktimin e Qendrës për Mbështetje ose të pezullojnë punën e saj deri në gjashtë muaj, nëse bie nën ndonjë nga nënparagrafët e mëposhtëm;</p> <p>1. – 4. <Lënë jashtë></p>

6. Rreziku i keqalokimit ose keqpërdorimit të përkrahjes së qeverisë:

Ky kriter shqyrton nëse përkrahja financiare e parashikuar në projektligje, ligje dhe rregullore përputhet me ndihmën tjetër të qeverisë të parashikuar nga ligje të ndryshme (p.sh., subvencionet kombëtare) ose nëse ekziston rreziku i shpërdorimit të buxhetit të qeverisë për shkak të keqalokimit ose keqpërdorimit të përkrahjes qeveritare. Gjithashtu, kriteri shqyrton nëse ekziston një mekanizëm monitorimi për të parandaluar shpërdorimet buxhetore.

Ky kriter shqyrton a) bazën ligjore për ofrimin e përkrahjes financiare, b) drejtësinë dhe transparencën e procesit të përkrahjes financiare, c) mekanizmin pas menaxhimit të përkrahjes financiare, dhe d) mekanizmat për të siguruar llogaridhënie në sigurimin e përkrahjes financiare.

a) Baza ligjore për ofrimin e përkrahjes financiare:

ACRC-ja shqyrton nëse përkrahja e qeverisë e parashikuar në dispozitat përkatëse është në përputhje me ligjin e përgjithshëm (për shembull ligjin e menaxhimit të subvencioneve, ligjin e pronës shtetërore, dhe ligjin për rregullimin e rasteve të veçanta të pronës shtetërore). Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton nëse arsyetimi, objektivat, kërkesat dhe procedurat për sigurimin e përkrahjes financiare janë përshkruar në mënyrë specifike. Analiza krahasuese (p.sh. krahasimi i projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve përkatëse me ligjet që ofrojnë përkrahje të ngjashme financiare) kryhet për të vlerësuar rreziqet e shpërdorimeve buxhetore që rezultojnë nga ndihma financiare e pakujdesshme.

b) Drejtësia dhe transparenca e procesit të përkrahjes financiare:

ACRC-ja shqyrton nëse dispozitat e përcaktojnë qartë organin vendimmarrës, metodologjinë e përzgjedhjes, dokumentet që duhet të dorëzohen, gamën e aplikantëve dhe proceset e aplikimit. Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton nëse kriteret e përzgjedhjes dhe procesi i përzgjedhjes janë shpalosur për publikun për të siguruar drejtësinë dhe transparencën e procesit të vendimmarrjes kur sigurohet përkrahje financiare.

c) **Mekanizmi pas menaxhimit të përkrahjes financiare:**

ACRC-ja shqyrton nëse janë vendosur detyrat e raportimit dhe dorëzimi i raporteve të performancës për të vlerësuar efektshmërinë e programit të përkrahjes financiare. Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton nëse është krijuar një proces vlerësimi i performancës për të arritur objektivat e përkrahjes financiare.

d) **Mekanizmat për të siguruar llogaridhënie në sigurimin e përkrahjes financiare:**

ACRC-ja shqyrton nëse ka bazë ligjore për anulimin e përkrahjes së paligjshme financiare. Gjithashtu, shqyrtohet a është vendosur një mekanizëm i përshtatshëm kontrolli për të rikthyer përkrahjen e paligjshme financiare.

Listë kontrolli për vlerësimin e kriterit të "rrezikut të keqalokimit ose keqpërdorimit të përkrahjes së qeverisë"

1. A e përcaktojnë qartë dispozitat bazën ligjore dhe kërkesat për ofrimin e përkrahjes financiare?
2. A korrespondojnë metodat e përkrahjes financiare (p.sh. metodat e kontratës) me karakteristikat e tyre?
3. A është e domosdoshme përkrahja financiare, kur ndihma e ngjashme financiare është e përcaktuar tashmë në ligje dhe rregullore të tjera?
4. A është i përshtatshëm niveli i përkrahjes së qeverisë?
5. A ka dispozita për mbledhjen e opinionëve të palëve të interesit dhe të ekspertëve kur vendosen kriteret e përzgjedhjes së përfituesve? A janë shpalosur për publikun?
6. A ka dispozita specifike të cilat përcaktojnë procesin e aplikimit dhe përzgjedhjes, si dhe kriteret e përzgjedhjes? A janë shpalosur për publikun?
7. A ka mekanizma vlerësimi për të përzgjedhur përfitues të përshtatshëm për përkrahjen financiare? A ka mekanizma për të siguruar drejtësinë e vlerësimit?
8. A ka dispozita që parashikojnë masa (p.sh. ruajtja e dëshmimeve materialeve të shpenzimeve, dorëzimi i detyrueshëm i raporteve pas programeve) për të kontrolluar nëse përkrahja financiare përdoret në mënyrë të përshtatshme?
9. A ka mekanizma kontrolli për të parandaluar përfitimin e paligjshëm të përkrahjes financiare?
10. A ka mekanizma kontrolli për të parandaluar shpenzimet e paligjshme të përkrahjes financiare?
11. A ka mekanizma ndëshkimore për të rikthyer përkrahjen financiare kur është shpenzuar në mënyrë të paligjshme?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e "rrezikut të keqalokimit ose keqpërdorimit të përkrahjes së qeverisë"

"Ligji për caktimin dhe menaxhimin e zonave të tregtisë së lirë"

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 49 (Përkrahja, etj. për zhvillim teknologjik nga ndërmarrjet e vendosura)</p> <p>① Shteti ose qeveritë lokale mund të subvencionojnë ndërmarrjet e vendosura në zonat e tregtisë së lirë për të inkurajuar aktivitetet e zhvillimit të teknologjisë dhe trajnimin e burimeve njerëzore.</p> <p>② Qeveritë shtetërore ose lokale do të përpiqen t'i mirëmbajnë dhe riparojnë fabrikat e marra me qira nga ndërmarrjet rezidente, do të zgjerojnë infrastrukturën e ndryshme (p.sh. objektet mjekësore, objektet arsimore, banesat etj.) dhe mund të sigurojnë subvencione për ndërmarrjet e vendosura në zonat e tregtisë së lirë</p>	<p>▫ Shteti ose qeveritë lokale mund të ofrojnë subvencione financiare për ndërmarrjet private në zonat e tregtisë së lirë.</p> <p>▫ Megjithatë, legjislacioni aktual nuk ka dispozita që përcaktojnë standarde specifike për menaxhimin e subvencioneve (p.sh. si ndahen, shfrytëzohen dhe menaxhohen).</p> <p>▫ Zyrtarët e qeverisë mund t'i vendosin arbitrarisht marrësit dhe shkallën e subvencioneve, çka mund të rezultojë në një menaxhim të papërshtatshëm të buxheteve dhe shpërdorim të buxheteve të qeverisë.</p>	<p>Neni 49 (Përkrahja, etj. për zhvillim teknologjik nga ndërmarrjet e vendosura)</p> <p>① - ② (Njësoj si më parë)</p> <p>Të shtohet dispozita</p> <p>③ Në pajtim me paragrafin 1 të Ligjit, çështjet e nevojshme për dhënie subvencioneve (p.sh. standardet e përzgjedhjes, mënyrën si do të shfrytëzohen ose menaxhohen subvencione etj.) do të përcaktohen me dekretet presidenciale.</p>

Procedurat administrative

7. Qasshmëria:

Ky kriter shqyrton nëse palëve të interesit (duke përfshirë individë, biznese dhe organizata) u jepen mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e hartimit të politikave (p.sh. dëgjimet publike, propozimet e politikave, paraqitja e opinionëve dhe proceset e tjera pjesëmarrëse, etj.) dhe për të shprehur opinionet e tyre. Gjithashtu, shqyrton nëse të gjitha palët relevante të interesit janë të përfaqësuara në procesin administrativ. Përfshirja e palëve relevante të interesit dhe ekspertëve mund të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e procesit administrativ, si dhe mund të parandalojë shkeljen e procedurave administrative ose kryerjen e aktiviteteve të paligjshme nga politikëbërësit, çka, nga ana tjetër, zvogëlon rreziqet e korrupsionit.

Ky kriter shqyrton a) dispozitat që përcaktojnë pjesëmarrjen qytetare, b) mjaftueshmërinë dhe efektshmërinë e pjesëmarrjes qytetare, dhe c) nevojën për krijimin e mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare.

a) Dispozitat që parashikojnë pjesëmarrjen qytetare:

ACRC-ja shqyrton nëse mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare janë përfshirë në procedurat administrative. Gjithashtu, shqyrtohen përmbajtja, periudha dhe metodat e pjesëmarrjes qytetare të theksuara në dispozita.

b) Mjaftueshmëria dhe efektshmëria e pjesëmarrjes qytetare:

ACRC-ja shqyrton nëse pjesëmarrja qytetare është e qasshme dhe e përshtatshme, dhe nëse janë ofruar mundësi të mjaftueshme për publikun për të marrë pjesë në proceset administrative. Gjithashtu, ACRC-ja vlerëson efektshmërinë e pjesëmarrjes qytetare, duke shqyrtuar nëse mundësia e pjesëmarrjes është e kufizuar tek disa palë të interesit.

c) Nevoja e themelimit të mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare:

Kur nuk janë vendosur mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare, ACRC-ja shqyrton nëse ekzistojnë arsye të justifikuara për mungesën e mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të "qasshmërisë"

1. A ekziston një mekanizëm që u lejon qytetarëve të marrin pjesë në procedurën e trajtimit?
2. Nëse ekziston një mekanizëm i pjesëmarrjes, a është mekanizmi i qasshëm dhe i përshtatshëm për publikun?
3. Nëse ekziston një mekanizëm i pjesëmarrjes, a ofron mundësi të mjaftueshme për pjesëmarrje?
4. A është pjesëmarrja qytetare e kufizuar në grupe të caktuara? Nëse po, a është e nevojshme të zgjerohet pjesëmarrja?
5. A ka arsye të justifikueshme për mosfunksionimin e një sistemi të pjesëmarrjes qytetare, apo kur konsiderohet e panevojshme?
6. A është e nevojshme të zbatohet një sistem i pjesëmarrjes qytetare në të ardhmen e afërt për të rritur transparencën e procedurave administrative?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e "qasshmërisë"

"Enforcement Ordinance on the Special Act on the Establishment and Operation of Rapid Bus System"

Neni relevant	Reziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 7 (Aprovimi i Planeve)</p> <p>② Personi i cili mban autoritetin për aprovim në pajtim me nenin 7.2 të Ligjit të Posaçëm do të publikojë të paktën një herë në gazetën lokale ose në faqet e vet të internetit informacionin e mëposhtëm, në mënyrë që qytetarët t'i shfletojnë për të paktën 14 ditë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendndodhja e sheshit të ndërtimit 2. Stacione të mëdha të autobusëve 	<p>▫ Neni përcakton vetëm mënyrën e publikimit të informatave relevante për publikun pa ofruar metoda specifike për mbledhjen dhe përfshirjen e opinionëve të qytetarëve.</p>	<p>Neni 7 (Aprovimi i Planeve)</p> <p>② (Njësoj si më parë)</p> <p>Të shtohet dispozita</p> <p>③ Ata që kanë opinionë për informacionin në përputhje me paragrafin 2 të Ligjit, mund të dorëzojnë raporte të opinionit tek personi që mban autoritetin e aprovimit, brenda afatit të shpalljes.</p> <p>④ Personi i cili mban autoritetin e aprovimit do të shqyrtojë opinionet e dorëzuara në pajtim me paragrafin 3 të Ligjit, dhe do të njoftojë personin i cili ka dorëzuar opinionet për rezultatet brenda 00 ditëve pas mbylljes së periudhës së shpalljes.</p>

8. Hapja

Ky kriter shqyrton nëse institucionet qeveritare shpallin informacione të mjaftueshme në lidhje me procesin administrativ për publikun dhe palët e interesit. Kjo përfshin ndarjen e informacionit kur kërkohet nga qytetarët, si dhe agjencitë publike që informojnë në mënyrë aktive publikun. Shpallja e informacionit rrit transparencën dhe llogaridhënien e procesit, duke frenuar korrupsionin.

Ky kriter shqyrton a) dispozitat e lidhura me shpalljen e informacionit, b) efektshmërinë e shpalljes së informacionit, dhe c) nevojën e vendosjes së mekanizmave për shpalljen e informacionit.

a) Dispozitat në lidhje me shpalsjen e informacionit:

ACRC-ja shqyrton përmbajtjen, periudhën dhe metodat e procesit të publikimit të informacionit publik.

b) Efektshmëria e shpalsjes së informacionit:

ACRC-ja shqyrton nëse palët aktuale të interesit mund të kenë qasje në informacionin e shpalosur, dhe nëse informacioni u shpaloset vetëm palëve të caktuara.

c) Nevoja e themelimit të mekanizmave të shpalsjes së informacionit:

Kur nuk janë vendosur mekanizmat e shpalsjes së informacionit, ACRC-ja shqyrton nëse ekzistojnë arsye të justifikuara për mungesën e mekanizmave të shpalsjes së informacionit.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të "hapjes"

1. A ekziston një mekanizëm për shpalsjen e informacionit që shpalos për publikun informacionin e lidhur me procesin e trajtimit administrativ?
2. Nëse ekziston një mekanizëm për shpalsjen e informacionit, a munden palët e interesit apo qytetarët aplikues të kenë qasje në informata?
3. A është fushëveprimi i shpalsjes së informacionit i kufizuar në grupe të caktuara të palëve të interesit? Nëse po, a është e nevojshme të zgjerohet fushëveprimi i shpalsjes së informacionit?
4. A ka arsye të justifikueshme për mos krijimin e një sistemi të shpalsjes së informacionit, apo kur konsiderohet e panevojshme?
5. A është e domosdoshme të zbatohet në të ardhmen e afërt një sistem për shpalsjen e informacionit për të rritur transparencën e procedurave administrative?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e "hapjes"

"Dekreti për Zbatimin të Ligjit për Promovimin e Shkencës dhe Teknologjisë për Tokën, Infrastrukturën dhe Transportin"		
Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 4 (Formulimi dhe Modifikimi i Planeve të Zbatimit, etj.)</p> <p>③ Kur Ministri i Tokës, Infrastrukturës dhe Transportit ka formuluar ose ndryshuar një plan zbatimi, ai/ajo do ta shpalosë çështjen dhe mund të mbajë një mbledhje informuese për projektin, nëse është e nevojshme, për të publikuar projektin përkatës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Ministri i Tokës, Infrastrukturës dhe Transportit do të krijojë dhe zbatojë një plan gjithëpërfshirës për të nxitur shkencën dhe teknologjinë për tokën, infrastrukturën dhe transportin, çdo vit. ▫ Megjithatë, legjislacioni nuk specifikon si shpalosen planet e zbatimit. ▫ Zyrtarët qeveritarë përgjegjës për shpalsjen e një plani zbatimi mund të shpalosin planet sipas diskrecionit të vet (vetëm për biznese të caktuara etj.) ose mund të mos shpalosin fare informacion. Kjo rrit rreziqet nga korrupsioni, pasi zyrtarët qeveritarë mund të ofrojnë trajtim preferencial për grupe të caktuara qytetarësh kur zgjedhin bizneset e hulumtimit dhe zhvillimit. 	<p>Neni 4 (Formulimi dhe Modifikimi i Planeve të Zbatimit, etj.)</p> <p>③ Kur Ministri i Tokës, Infrastrukturës dhe Transportit ka formuluar ose ndryshuar një plan zbatimi, ai/ajo do ta shpalosë planin në faqen zyrtare të ministrisë. Përveç kësaj, nëse është e nevojshme, ai/ajo mund të mbajë një mbledhje për projektin për të publikuar informacionin përkatës të projektit.</p>

9. Qartësia në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ:

Ky kriter shqyrton nëse qytetarët mund të kuptojnë dhe parashikojnë qartë si do t'i ofrojë qeveria shërbimet publike dhe si do t'i trajtojë procedurat administrative. Nëse ligjet dhe rregulloret nuk përcaktojnë qartë procedurat administrative (p.sh. dokumentet e kërkuara, periudhat e trajtimit etj.), është e vështirë për publikun të paraqesë ankesa ose të marrë shërbime publike. Kjo gjithashtu mund të dëmtojë objektivitetin dhe transparencën e procedurave administrative dhe të inkurajojë aktivitetet e korruptuara, pasi publiku mund t'u paguajë ryshfete zyrtarëve të qeverisë për të marrë informacion ose për të marrë shërbime publike.

Ky kriter shqyrton a) dispozitat që përcaktojnë proceset administrative, b) kuptueshmërinë e dispozitave të procesit administrativ, c) parashikueshmërinë, dhe d) nevojën e vendosjes së mekanizmave institucionale për të rritur qartësinë.

a) Dispozitat që parashikojnë proceset administrative:

ACRC-ja shqyrton dispozitat e projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve përkatëse si dhe dispozitat e legjislacionit përkatës (duke përfshirë aktet nënligjore, rregullat administrative) për të shqyrtuar nëse legjislacioni përcakton dokumentet e kërkuara, procesin administrativ dhe periudhat për trajtimin e peticioneve civile.

b) Kuptueshmëria e dispozitave të procesit administrativ:

ACRC-ja shqyrton nëse publiku i gjerë mund t'i kuptojë lehtësisht rregulloret që përcaktojnë proceset administrative. Nëse dispozitat përbajnë terma teknike ose shprehje të vështira, ACRC-ja shqyrton nëse ekzistojnë arsye të justifikueshme për shfrytëzimin e zhargoneve të tilla, të cilat mund të dëmtojnë parashikueshmërinë dhe kuptueshmërinë për publikun e gjerë.

c) Parashikueshmëria:

ACRC-ja shqyrton nëse janë vendosur dispozita specifike për t'u ndihmuar qytetarëve ta kuptojnë dhe ta parashikojnë procesin administrativ.

d) Nevoja e vendosjes së mekanizmave institucionale për të rritur qartësinë:

ACRC-ja shqyrton nëse duhet të zbatohen masat për të parandaluar ndikimet negative që rezultojnë nga qartësia e ulët e procesit administrativ.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të “qartësisë në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ”

1. A parashikojnë dispozitat se çfarë duhet të përgatitet për paraqitjen e peticioneve civile dhe si do të trajtohen ato (p.sh. proceset administrative, periudha e trajtimit, etj.)?
2. A mund ta kuptojë lehtë publiku gjuhën e përdorur në dispozitat që përcaktojnë proceset administrative?
3. A ka arsye të justifikueshme për shfrytëzimin e kushteve të vështira ose teknike që mund të dëmtojnë parashikueshmërinë dhe kuptueshmërinë për publikun?
4. A i parashikojnë qartë dispozitat masat vijuese që mund të shfrytëzohen kur nuk plotësohen kërkesat, proceset dhe periudha e kërkuar për paraqitjen e peticionit civil?
5. Kur vepron një sistem paraprak autorizimi (p.sh. aprovimi i kushtëzuar ose aprovimi paraprak), a ka dispozita që përcaktojnë mundësinë e dhënies së autorizimit paraprak, kërkesat e aplikimit, procesin dhe periudhën e aplikimit?
6. Kur janë vendosur proceset e konsultimit/aprovimit, a ka dispozita që përcaktojnë institucionet përkatëse publike, standardet e konsultimit/aprovimit dhe periudhën e trajtimit?
7. A kanë qytetarët kërkesë nevojë për shpjegime shtesë apo ndihmë nga zyrtarët qeveritarë për të kuptuar procesin administrativ dhe standardet e tij?
8. A ka arsye të justifikueshme për parashikueshmërinë e ulët të procesit administrativ?
9. A është e nevojshme të zbatohen masa përmirësuese për të parandaluar ndonjë efekt anësor të procesit administrativ që rezulton nga parashikueshmëria e ulët?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e “qartësisë në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ”

"Ligji Kornizë për Kualifikimet"		
Neni relevant	Potential corruption risks	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 23 (Arritja e kualifikimit të akredituar, etj.)</p> <p>② Menaxheri i akredituar i kualifikimit lëshon një certifikatë që vërteton fitimin e një kualifikimi të akredituar nga personi që përmbush kërkesat e caktuara të kualifikimit, mes atyre që kanë kaluar provimet kualifikuese ose kanë përfunduar kurse të arsimit dhe formimit sipas paragrafit ①.</p>	<p>▫ Kërkesat për arritjen e një kualifikimi të akredituar (kërkesa të caktuara kualifikimi) nuk janë të përcaktuara qartë dhe është e vështirë për publikun të kuptojë se cilat kualifikime specifike kërkohen për marrjen e certifikatës.</p>	<p>Neni 23 (Arritja e kualifikimit të akredituar, etj.)</p> <p>② Menaxheri i akredituar i kualifikimit i lëshon një certifikatë të akredituar personit që plotëson kërkesat specifike të kualifikimit, siç përcaktohet me dekret presidencial, mes atyre që kanë kaluar provimet kualifikuese ose kanë përfunduar kurse të arsimit dhe formimit sipas paragrafit ①.</p>

Kontrolli i korrupsionit

10. Rreziku i konfliktit të interesit:

Ky kriter shqyrton nëse projektligjet, ligjet dhe rregulloret ofrojnë masa për të parandaluar konfliktin e interesit. "Konflikti i interesit" i referohet një situatë ku interesat private të zyrtarëve qeveritarë mund të dëmtojnë kryerjen e drejtë të detyrave të tyre zyrtare. Pa krijimin e një mekanizmi parandalues për të adresuar konfliktin e interesit, mund të lindin rreziqet e korrupsionit, pasi zyrtarët publikë mund t'i vendosin përfitimet personale përpara interesit publik.

Ky kriter shqyrton a) rrezikun e ballafaqimit me konfliktin e interesit, b) ekzistencën e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit, c) përshtatshmërinë e mekanizmave parandalues të konfliktit të interesit dhe d) metodat për të rritur fuqinë normative të mekanizmave parandalues të konfliktit të interesit.

a) Rreziku i ballafaqimit me konfliktin e interesit:

ACRC-ja shqyrton çdo rrezik që një komision ose individ në një organ vendimmarrës të dëmtojë legjitimitetin e procesit të vendimmarrjes kur ndryshon dispozitat që përcaktojnë të drejtat/detyrimet e qytetarëve, ose kur shqyrton dhe bën diskutime për dispozitat që lidhen ngushtë me jetën e publikut

a) Ekzistenca e mekanizmave parandalues të konfliktit të interesit:

ACRC-ja shqyrton nëse janë krijuar mekanizma për parandalimin e situatave të konfliktit të interesit. Në rastin e Koresë, zbatohen katër lloje të masave parandaluese, të cilat janë: Përrjashtimi automatik; Kërkesa/Peticioni për përrjashtim; Vetë-përrjashtimi (abstenim vullnetar); dhe Shkarkimi.

• Përrjashtimi automatik:

Nëse çështja në fjalë lidhet me interesin privat të një individi në organin vendimmarrës, ai individ mund të përrjashtohet automatikisht në bazë të një vendimi nga komisioni i organit përkatës vendimmarrës.

• Kërkesa/peticioni për përrjashtim:

Palët e interesit (p.sh. qytetarët, interesat e të cilëve mund të preken nga vendimi) mund të kërkojnë përrjashtimin e individëve të caktuar në organet vendimmarrëse, të cilët kanë potencialin për të komprometuar drejtësinë, besueshmërinë dhe neutralitetin e vendimeve të organeve vendimmarrëse.

• Përrjashtimi (abstenimi vullnetar):

Individët në organin vendimmarrës të cilët kanë potencialin për të komprometuar drejtësinë, besueshmërinë dhe neutralitetin për një çështje të caktuar, mund të abstenojnë vullnetarisht nga vendimmarrja e lidhur me çështjen.

• Shkarkimi:

Kreu i organeve vendimmarrëse mund t'i shkarkojë anëtarët e subjektit që nuk abstenojnë nga procesi i vendimmarrjes kur ballafaqohen me konflikt interesi, ose që kanë kryer korrupsion, si marrja e ryshfetit.

c) Përshtatshmëria e mekanizmave parandalues të konfliktit të interesit:

ACRC-ja shqyrton nëse dispozitat përcaktojnë mekanizma të përshtatshëm (p.sh. përrjashtimi automatik, kërkesa/peticioni për përrjashtim, vetë-përrjashtimi (abstenim vullnetar) dhe shkarkimi, ndalimi i punësimit të njëkohshëm si zyrtarë qeveritarë dhe fitimprurës etj.) për të parandaluar një situatë konflikti interesi.

d) Metodat për të shtuar kompetencat normative të mekanizmave parandalues të konfliktit të interesit:

ACRC-ja shqyrton nëse janë vendosur rregulloret për shkarkimin dhe penalizimin e aktiviteteve të paligjshme.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të "rrezikut të konfliktit të interesit"

1. A ekziston rreziku i konfliktit të interesit (d.m.th. interesi privat që dëmton kryerjen e detyrave publike)?
2. A i përcaktojnë qartë dispozitat kualifikimet për emërimin e anëtarëve të komisionit?
3. A ekziston një mekanizëm (p.sh. kufizimi i mandatit ose i mandateve të njëpasnjëshme, etj.) për të parandaluar krijimin e lidhjeve personale që rezultojnë nga qëndrimi afatgjatë në detyrë i zyrtarëve publikë?
4. A ekziston një dispozitë që përcakton mekanizmin e përrjashtimit automatik?
5. A ekziston ndonjë dispozitë që përcakton kërkesën/peticionin për mekanizmin e përrjashtimit?
6. A ekziston një dispozitë që përcakton mekanizmin e vetë-përrjashtimit (abstenimit vullnetar)?
7. A ka dispozita që përcaktojnë ndalimin e punësimit të njëkohshëm ose fitimeve për të parandaluar një proces të padrejtë administrativ që rezulton nga situata e konfliktit të interesit?
8. A ka rregulla që përcaktojnë shkarkimin për të penalizuar një individ që dëmton drejtësinë e shqyrtimeve duke mos ushtruar vetë-përrjashtimin (abstenim vullnetar), ose duke marrë para dhe sende me vlerë?
9. A ekziston një dispozitë që përcakton se sanksionet (p.sh. dispozitat kundër ryshfetit) e vendosura kundër veprimeve të paligjshme të anëtarëve të komisionit nga sektori privat do të jenë të barabarta me dënimet e dhëna për zyrtarët qeveritarë?
10. A ekziston një dispozitë që kërkon që komisionet të mbajnë shënime të mbledhjeve dhe t'i mbajnë këto dokumente për një periudhë të caktuar?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e "rrezikut të konfliktit të interesit"

"Dekreti për Zbatimin e Ligjit të Agjentëve të Licencuar të Patundshmërive"

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Article 1.2 (Composition of the Licensed Real Estate Agent Policy Deliberation Committee)</p> <p>① Neni 1.2 (Përbërja e Komisionit për Shqyrtimin e Politikave të Agjentit të Licencuar të Patundshmërive)</p> <p>② Anëtarët emërohen ose autorizohen nga Ministri i Tokës, Infrastrukturës dhe Transportit nga personat e mëposhtëm:</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Dispozitat aktuale nuk përcaktojnë mekanizma (p.sh. përjashtimi automatik, kërkesa për përjashtim dhe vetë-përjashtimi (abstenimi vullnetar) për të parandaluar konfliktin e interesit. ▫ Dispozitave aktuale u mungojnë mekanizmat pas kontrollit (p.sh. shkarkimi i anëtarëve të komisionit) për të penalizuar anëtarët e komisionit që dëmtuan drejtësinë e procesit të vendimmarrjes duke mos abstenuar nga procesi i vendimmarrjes kur u përballën me situatën e konfliktit të interesit ose duke kryer korrupsion. 	<p>Të shtohet një nen</p> <p>Neni 00 (Përjashtimi automatik, kërkesa për përjashtim, vetë-përjashtimi (abstenimi vullnetar) dhe shkarkimi i anëtarëve)</p> <ul style="list-style-type: none"> ① Anëtarët do të përjashtohen nga procesi i shqyrtimit dhe zgjidhjes në situatat si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> 1.Kur interesat private të anëtarëve të komisionit janë drejtpërdrejt të lidhura me vendimin e komisionit; dhe 2.Kur anëtarët, ose ata që kanë/kanë pasur marrëdhënie farefisnore me anëtarët, janë të lidhur me një çështje ② Kur palët e interesit kërkojnë që anëtarët e komisioneve të veçanta të përjashtohen nga procesi i shqyrtimit. ③ Anëtarët e komisionit duhet të abstenojnë vullnetarisht nga pjesëmarrja në procesin e shqyrtimit kur pritet të dëmtojnë drejtësinë. ④ Anëtarët që nuk abstenojnë nga procesi i diskutimit dhe kanë dëmtuar drejtësinë e procesit të diskutimit do të shkarkohen.

11. Nevoja për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit:

Projektligjet, ligjet dhe rregulloret mund të përmbajnë rreziqe korrupsioni që nuk mund të zbulohen nga kriteret e VRRK-së. Gjithashtu, mund të kërkohej vendosja/rritja e mekanizmave të kontrollit të korrupsionit ose zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve të tjera kundër korrupsionit, për të parandaluar korrupsionin në mënyrë efektive. Në rrethana të tilla, ACRC-ja e përdor këtë kriter për të shqyrtuar nëse është e nevojshme të vendosen mekanizmat e kontrollit të korrupsionit apo të zbatohen ligjet dhe rregulloret kundër korrupsionit për të parandaluar korrupsionin që mund të ndodhë gjatë zbatimit të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve përkatëse. Duke promovuar vendosjen e masave vullnetare kundër korrupsionit, siç është zhvillimi i sistemeve të raportimit të korrupsionit, ky kriter synon të rrisë kapacitetin e parandalimit të korrupsionit të organizatave qeveritare.

Kriteri shqyrton a) rastet relevante të korrupsionit, b) efektshmërinë e rregullave kundër korrupsionit, dhe c) nevojën për përmirësimin e mekanizmave për parandalimin e korrupsionit.

a) Raste relevante të korrupsionit:

ACRC-ja shqyrton rastet e mëparshme të korrupsionit të cilat kanë ndodhur në kontekste të ngjashme ligjore dhe institucionale, për të shqyrtuar nëse projektligjet, ligjet dhe rregulloret përkatëse gjithashtu përmbajnë rreziqe të ngjashme korrupsioni.

b) Efektshmëria e rregulloreve kundër korrupsionit:

ACRC-ja shqyrton mekanizmat e vendosur kundër korrupsionit për të shqyrtuar nëse përpjekjet e tilla janë efektive në parandalimin e korrupsionit.

c) Nevoja për përmirësimin e mekanizmave parandalues të korrupsionit:

ACRC-ja shqyrton nevojën për përmirësime të mekanizmave për parandalimin e korrupsionit, duke shqyrtuar nëse institucionet qeveritare duhet të zhvillojnë mekanizma të tillë. Gjithashtu, ACRC-ja shqyrton rastet ku janë raportuar aktivitetet e vazhdueshme të korrupsionit, edhe pse janë vendosur masat kundër korrupsionit.

Lista kontrolluese për vlerësimin e kriterit të “nevojës për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit”

1. A ka pasur raste të korrupsionit që shkelin projektligjet, ligjet dhe rregulloret në fjalë që po vlerësohen nga VRRK-ja? A ka pasur raste të korrupsionit në funksione të tjera administrative të ngjashme?
2. A ka mekanizma për parandalimin e korrupsionit?
3. Nëse po, a veprojnë mekanizmat parandalues të korrupsionit në mënyrë efektive (duke shqyrtuar rregulloret relevante dhe rastet aktuale të operimit)?
4. A vazhdojnë rastet e korrupsionit edhe përkundër ekzistencës së mekanizmave kundër korrupsionit?
5. A ka ndonjë arsye të justifikueshme për mungesën e mekanizmave për parandalimin e korrupsionit?
6. A është e nevojshme të vendosen mekanizmat kundër korrupsionit?

Shembulli i VRRK-së të lidhur me kriterin e “nevojës për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit”

"Kodi i Sjelljes për Punonjësit e Shërbimit të Shqyrtimit dhe Vlerësimit të Sigurimeve Shëndetësore"

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 16 (Identifikimi i biznesit me pronare femër, etj.)</p> <p>(3) Ministri i NVM-ve dhe Bizneseve Fillestare mund të organizojë dhe operojë një komision vlerësimi të dedikuar për kryerjen e hetimeve në terren.</p>	<p>▫ Legjislacioni aktual nuk ka ndonjë dispozitë që përcakton si sanksionohen anëtarët e vlerësimit civil që kanë kryer veprimtari mashtruese ose të paligjshme.</p>	<p>Të shtohet një nen Neni 00 (Zbatimi i Dispozitave Penale për anëtarët civilë të komisionit)</p> <p>Anëtarë civilë të komisionit vlerësues do të konsiderohen si zyrtarë publikë dhe do të aplikohen nenet 129-132 të Ligjit Penal për penalizimin e aktiviteteve të paligjshme të anëtarëve civilë.</p>

Pyetjet më të shpeshta

Për të mbështetur vendet e interesuara për të kuptuar dhe përshtatur VRRK-në për procesin e tyre legjislativ, ky seksion përpilon disa nga pyetjet më të shpeshta nga vendet bë lidhje me ACRC-në dhe VRRK-në, si dhe përgjigjet e dhëna.

1. Cila është marrëdhënia e ACRC-së me strategjitë kombëtare të Koresë kundër korrupsionit?

ACRC-ja harton çdo vit strategjinë kombëtare kundër korrupsionit, e cila përcakton prioritetet dhe objektivat kundër korrupsionit (p.sh. strategjia kombëtare kundër korrupsionit e hartuar në vitin 2018 zgjodhi rritjen e mekanizmave kundër korrupsionit për të parandaluar situatën e konfliktit të interesit, si një nga fushat me prioritet të lartë) për iniciativat e përgjithshme kundër korrupsionit në Kore.

Pas ndarjes së strategjisë kombëtare kundër korrupsionit me institucionet përkatëse qeveritare, ACRC-ja përdor strategjinë kundër korrupsionit si një referencë dhe zhvillon planin vjetor të punës kundër korrupsionit. Plani i punës specifikon si duhet t' i zbatohet ACRC-ja mjetet e politikës kundër korrupsionit (p.sh. VIKK, VRRK, etj.) për të arritur objektivat e strategjisë kombëtare kundër korrupsionit. Pas hartimit të planit vjetor të punës kundër korrupsionit, ACRC-ja realizon iniciativat e veta vjetore kundër korrupsionit, duke shfrytëzuar planin si një referencë.

2. Cila është marrëdhënia e ACRC-së me parlamentin?

ACRC-ja është e themeluar institucionalisht nën Zyrën e Kryeministrit dhe është pjesë e krahut ekzekutiv të qeverisë. Megjithatë, ACRC-ja mban llogaridhënie të dyfishtë; raporton çdo vit në zyrën e Kryeministrit dhe në parlament.

3. A mundet ACRC-ja të kryejë VRRK për projektligjet e propozuara nga parlamentarët?

Teksa ligji i ACRC-së nuk e kufizon mandatin e ACRC-së vetëm në shqyrtimin e projektligjeve të propozuara nga ministritë qeverisë, në Kore projektligjet e propozuara nga parlamentarët nuk vlerësohen sipas VRRK-së.

ACRC-ja është e vendosur nën Zyrën e Kryeministrit dhe pjesë e krahut ekzekutiv të qeverisë. Në këtë strukturë institucionale, ACRC-ja natyrisht fokusohet në kryerjen e VRRK-së për projektligjet e propozuara nga dega ekzekutive.

Përveç kësaj, mund të ketë ndjeshmëri rreth kryerjes së VRRK-së për projektligjet e paraqitura nga deputetët individualë, pasi ato projektligje mbajnë emrat specifikë të deputetëve. Disa deputetë mund të reagojnë negativisht ndaj amendamenteve të propozuara nga një agjenci kundër korrupsionit, përveç nëse ka një bazë të qartë ligjore për autorizimin e agjencisë kundër korrupsionit për të kryer VRRK-në për projektligjet e propozuara nga deputetët.

Në këto kontekste, ACRC-ja nuk e kryen VRRK-në për miratimin/rishikimin e projektligjeve të propozuara nga parlamenti. Por sapo të miratohet projektligji dhe të bëhet pjesë e legjislacionit, ACRC-ja mund të bëjë VRRK-në për ato dispozita që organet qeveritare synojnë t'i rishikojnë. Prandaj, ACRC-ja mund të kryejë në mënyrë indirekte VRRK-në për ligjet e miratuara nga parlamenti, edhe pse ACRC-ja nuk shqyrton projektligjet e paraqitura nga parlamentarët.

4. Si përputhet procesi VRRK-së me procesin legjislativ të Koresë?

Kur institucioni qeveritar ka për qëllim të miratojë/ndryshojë projektligjet, institucioni së pari parashtron propozimet e veta legjislative dhe materialet e vlerësimit tek ACRC-ja.

Pas marrjes së propozimeve legjislative dhe materialeve të vlerësimit, ACRC-ja kryen VRRK-në për të identifikuar faktorët e rrezikut të korrupsionit në kuadër të projektligjeve. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, ACRC-ja i ofron rekomandime organit ekzekutiv për të hequr faktorët që shkaktojnë korrupsion në kuadër të projektligjit përkatës.

Pas marrjes së rezultateve të VRRK-së dhe rekomandimeve të ACRC, organi ekzekutiv përfshin rekomandimet e ACRC-së dhe paraqet propozimin e rishikuar legjislativ në Ministrinë e Legjislacionit të Qeverisë (MOLEG), për të kaluar shqyrtimin legjislativ.

5. A mundet organi legjislativ të kryejë VRRK-në?

Teksa në rastin e Koresë VRRK-ja kryhet nga organi ekzekutiv, VRRK-ja mund të zbatohet edhe nga organi legjislativ.

Nëse VRRK-në e kryen organi legjislativ, VRRK-ja mund të lidhet më efektivisht me procesin e shqyrtimit legjislativ. Nga ana tjetër, nëse VRRK-në e kryen organi ekzekutiv, VRRK-ja mund të zbatohet në një mënyrë më praktike, sepse gjatë procesit të VRRK-së shqyrtohen edhe rregullat e varura (p.sh. rregullat administrative që përcaktojnë drejtpërsëdrejti veprimet specifike të një agjencie qeveritare). Argumente më të detajuara pro dhe kundër për VRRK-në e kryer nga organi legjislativ/ekzekutiv jepen në Kapitullin VII: Qasjet strategjike për vendosjen e VRRK-së: Opsionet dhe faktorët për shqyrtim.

6. A ka konflikt mes ACRC-së dhe ministrive të qeverisë kur zbatohet VRRK-ja?

Kur u prezantua për herë të parë VRRK-ja, sfida më të mëdha që hasi ACRC-ja ishte ngritja e ndërgjegjësimit të organeve ekzekutive se VRRK-ja është një proces i detyrueshëm që duhet të kryhet përpara se t'i dorëzojnë projektligjet në mbledhjet e zëvendësministrave/kabinetit. Duhej kohë dhe përpjekje për ACRC-në që të informonte organet ekzekutive për natyrën e detyrueshme të shqyrtimit të VRRK-së.

ACRC nuk u përball me rezistencë të fortë nga ministrinë e qeverisë kur ndau rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së. Duke qenë se kriteret e VRRK-së janë shumë logjike, rezultatet e VRRK-së dhe rekomandimet që rridhnin nga kriteret ishin shumë bindëse. Edhe kryerja e konsultimeve paraprake me institucionet përkatëse qeveritare para se të nxirreshin rezultatet e vlerësimit kontribuan në zbutjen e rezistencës, pasi kjo ofroi mundësi të mjaftueshme për ACRC-në që t'ua shpjegojë arsyetimin për rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së institucioneve qeveritare duke përfshirë opinionet e tyre. Kjo ka kontribuar në ofrimin e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së që janë të pranueshme për ministrinë e qeverisë.

Shpalosja e kriterëve dhe rekomandimeve të VRRK-së bazuar në kriteret e qarta dhe rationale të VRRK-së, dhe kryerja e konsultimeve paraprake me ministrinë përkatëse të qeverisë përpara se të nxirreshin rezultatet e VRRK-së, kontribuan në zbutjen e rezistencës së organeve qeveritare ndaj procesit të VRRK-së.

Vlen të përmendet se ministrinë e qeverisë mund të përfitojnë nga praktika e VRRK-së. Nëpërmjet VRRK-së, ACRC-ja siguroi njohuri të reja për zbulimin e faktorëve të mundshëm të rrezikut të korrupsionit, çka nuk ishte e mundur kur institucionet qeveritare vetëm i hartonin propozimet legjislative. Edhe rekomandimet e ACRC-së që rrodhën nga VRRK-ja ishin shumë të dobishme, pasi agjencitë qeveritare mund të parandalonin dëmtime dhe shpenzime të panevojshme që do të rezultonin nga aktivitetet e korrupsionit që mund të kishte ndodhur nëse nuk do të ishin adresuar zbrazëtitrat në propozimet legjislative.

Duke promovuar përfitimet e praktikave të VRRK-së për institucionet qeveritare, VRRK-ja mund të shërbejë si një pikë hyrjeje për një agjenci kundër korrupsionit për të rritur ndikimin e saj në institucionet qeveritare, pasi VRRK-ja është një mekanizëm praktik dhe solid që mund të fuqizojë si agjencinë kundër korrupsionit ashtu dhe palët e tjera relevante të interesit.

7. Si e kryen ACRC-ja VRRK-në për ligjet aktuale?

Kur zbulohen faktorë që shkaktojnë korrupsionin në ligjet ekzistuese, ACRC-ja krijon dhe inicion një plan vlerësimi afatmesëm/afatgjatë për të kryer VRRK-në për ligjet ekzistuese. Për të krijuar plane afatmesme/afatgjata, ACRC-ja informon çdo agjenci qendrore administrative dhe qeverisjen lokale për ligjet dhe rregulloret që kanë/mund të kenë faktorë që shkaktojnë korrupsion, dhe kërkon nga institucionet qeveritare të paraqesin materialet e vlerësimit. Pas kalimit të një procesi të brendshëm të zgjidhjes, ACRC-ja kryen VRRK-në bazuar në materialet e vlerësimit bazë të paraqitura nga agjencia qendrore administrative dhe qeveritë lokale gjatë periudhës së dhënë të vlerësimit. Gjatë vlerësimit, ACRC-ja mund të shfrytëzojë dëgjimet publike për të mbledhur opinionet e agjencive përkatëse qeveritare, palëve të interesit dhe ekspertëve, për të shqyrtuar faktorët kryesorë të rrezikut të korrupsionit në kuadër të ligjeve dhe rregulloreve aktuale.

Sidoqoftë, në vend që të zbatojë plane afatmesme/afatgjata, ACRC-ja zakonisht zgjedh objekte specifike të vlerësimit për kryerjen e VRRK-së për ligjet aktuale. Kjo qasje ndodh kur: a) rreziqet e korrupsionit në lidhje me ligjin në fjalë janë njohur si çështje sociale ose pritet të shtojnë shqetësimet sociale; b) është e nevojshme të shqyrtohen fusha të caktuara në kuadër të ligjeve që janë strukturalisht të prirura për korrupsion; c) ekziston një nevojë urgjente për të hequr ose zvogëluar faktorët që shkaktojnë korrupsionin (p.sh. kur ligjet dhe rregulloret në fjalë bien në një fushë të politikës e cila promovohet si prioritet kombëtar, ose kur një legjislacioni i tillë bie nën një fushë ku janë rritur shpenzimet buxhetore); dhe d) VRRK-ja e kryer për projektligje të miratuara/të ndryshuara, zbulon faktorët që shkaktojnë korrupsionin në aktet ligjore dhe statutet e varura relevante ose të lidhura aktualisht.

Fokusi i ACRC-së në kryerjen e VRRK-së për projektligjet e miratuara/rishikuara është të theksojë rëndësinë e masave proaktive dhe parandaluese në luftën kundër korrupsionit. Pasi të hyjnë në fuqi ligjet dhe rregulloret që përmbajnë faktorët e rrezikut të korrupsionit, nevojiten më shumë kohë dhe burime për të adresuar aktivitetet e korrupsionit që rezultojnë nga faktorët që shkaktojnë korrupsionin në kuadër të ligjeve dhe rregulloreve. Gjithashtu, ka sfida në adresimin e rreziqeve të korrupsionit në ligjet dhe rregulloret aktuale, çka shpjegohet më tej në kapitullin VII: Qasjet strategjike për vendosjen e VRRK-së: Opsionet dhe faktorët për shqyrtim.

8. Si realizohet vlerësimi autonom?

Në parim, divizioni i vlerësimit në kuadër të institucioneve përkatëse qeveritare mban përgjegjësinë kryesore për të kryer VRRK-në autonome për të hequr faktorët që shkaktojnë korrupsionin në kuadër të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve.

ACRC-ja përpqet të rrisë kapacitetin për VRRK të divizioneve të vlerësimit. Së pari, ACRC-ja publikon, dhe ndan me institucionet qeveritare, doracakët e VRRK-së dhe praktikat shembullore të VRRK-së autonome, në mënyrë që divizioni i vlerësimit ta kuptojë më mirë çka është VRRK-ja dhe se mund të kryejnë vlerësime më të mira autonome. Gjithashtu, ACRC-ja siguron programe trajnimi online dhe në terren për të edukuar zyrtarët qeveritarë për mënyrat si mund të kryejnë vlerësime autonome.

Gjithashtu, ACRC-ja ofron stimuj për institucionet qeveritare që kryejnë vlerësime autonome. Kur ACRC-ja kryen VIKK-un, një instrument vlerësimi që mat dhe rendit përpjekjet kundër korrupsionit të institucioneve qeveritare, një nga kriteret e vlerësimit siguron vlerësim shtesë për institucionet qeveritare që kryejnë vlerësim autonom. Duke qenë se administrimi i një VRRK-je autonome lidhet drejtpërdrejt me rezultatet e VIKK-ut, të cilat u shpalosen si institucioneve qeveritare ashtu edhe publikut, kjo është dëshmuar të jetë shumë efektive në kontekstin e Koresë, pasi udhëheqësit e institucioneve publike janë shumë të ndjeshëm ndaj rezultateve të integritetit të institucioneve të tyre.

Kur hasen sfida në kryerjen e një vlerësimi autonom (p.sh. kur ka opinione konfliktuese mes divizioneve, kur projektligji përmban çështje të ndjeshme, etj.) ACRC-ja mund ta kryejë VRRK-në për projektligjet, ligjet dhe rregulloret e tilla kur kjo kërkohet nga kreu i institucionit qeveritar.

9. A është e detyrueshme që politikëbërësit t'i pranojnë rekomandimet e VRRK-së?

Nuk është ligjërish e detyrueshme që politikëbërësit t'i pranojnë rekomandimet e VRRK-së, por pasi që rezultatet e vlerësimit bazohen në kriteret racionale dhe të mirë-përcaktuara, organi ekzekutiv zakonisht i pranon rekomandimet e ACRC-së.

Nëse institucionet qeveritare e kanë të vështirë t'i pranojnë rekomandimet e VRRK-së, ata duhet të japin shpjegime për mosmiratimin e rekomandimeve. Por, duke qenë se ACRC-ja kryen konsultime paraprake me agjencitë qeveritare për të shpjeguar dhe diskutuar rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së, ata zakonisht i pranojnë rekomandimet e ACRC-së. Për më tepër, raportet dhe rekomandimet e VRRK-së shpalosen edhe gjatë mbledhjeve të zëvendësministrave dhe shqyrtimeve të legjislacionit të MOLEG-ut. Kjo e bën të vështirë për agjencitë qeveritare që t'i refuzojnë rekomandimet e ACRC-së pa arsye të justifikueshme, pasi më vonë mund të vihen në dyshim nga vendimmarrësit e nivelit të lartë.

Teksa kjo ndodh rrallë në Kore, institucionet qeveritare mund të kërkojnë nga ACRC-ja që të kryejë një rivlerësim të VRRK-së. Pas marrjes së kërkesave për rivlerësim, ACRC-ja shqyrton me kujdes: a) qëllimin dhe vlefshmërinë e kërkesës për rivlerësim; b) nëse rivlerësimi është i nevojshëm për shkak të ndryshimeve në rrethana (p.sh. ndryshimet në mjedisin e jashtëm); dhe c) arsye të tjera të justifikuara (p.sh. vështirësitë e konsultimit dhe koordinimit me institucionet përkatëse) të cilat mund të kërkojnë një rivlerësim të faktorëve të rrezikut të korrupsionit.

Gjatë kryerjes së një rivlerësimi të VRRK-së, ACRC-ja cakton një vlerësues të ri për vlerësimin, i cili nuk ka marrë pjesë në procesin fillestar të VRRK-së. Gjithashtu, ACRC-ja mbledh opinionet e ekspertëve për të përfshirë perspektiva të ndryshme për kryerjen e një rivlerësimi të drejtë të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve.

10. A ndikon VRRK-ja në gjykimin e degës gjyqësore?

Qëllimi i VRRK-së qëndron në eliminimin e faktorëve që shkaktojnë korrupsionin në projektligje, ligje dhe rregullore, jo të ndikojë në gjykime ligjore. Pasi rekomandimet e VRRK-së të pasqyrohen në ligje, dega gjyqësore thjesht interpreton ligjet dhe rregulloret e rishikuara dhe bën gjykime ligjore.

11. A duhet të ndryshohet ligji kundër korrupsionit i vendit që kërkon të zhvillojë një mekanizëm të ngjashëm me VRRK-në, nëse dispozitat aktuale nuk e autorizojnë agjencinë kundër korrupsionit të kryejë një vlerësim të tillë?

Kjo varet nga konteksti specifik i secilit vend, por është e rëndësishme që agjencisë kundër korrupsionit t'i jepet autoritet legjitim për të kryer VRRK-në. Pa krijuar një bazë të qartë ligjore për zbatimin e VRRK-së, institucionet qeveritare mund t'i rezistojnë procesit të VRRK-së, meqë vlerësimi nuk është përcaktuar në ligjet dhe rregulloret kundër korrupsionit.

12. Çfarë lloj kapacitetesh dhe ekspertize nevojiten për funksionimin e VRRK-së?

ACRC-ja sugjeron që kur VRRK-ja analizon projektligjet, ligjet dhe rregulloret në fusha të ndryshme, personeli me ekspertizë jo vetëm në çështjet ligjore, por edhe në fusha dhe sektorë të ndryshëm, do të ishte i dobishëm për kryerjen e vlerësimit. Kur ACRC-ja e krijoi për herë të parë Divizionin e vet të VRRK-së, 1/3 e personelit (nga 30 në total) ishin avokatë të angazhuar me kontratë. Pjesa tjetër ishin zyrtarë qeveritarë nga sektorë të ndryshëm. Përbërja e tillë e ekipit i mundësoi divizionit të VRRK-së që të ketë ekspertizën e nevojshme ligjore, së bashku me një kuptim gjithëpërfshirës të administratës së përgjithshme publike.

Për të identifikuar rreziqet e korrupsionit dhe për të ofruar rekomandime, personeli duhet të jetë i aftësuar për gamën e plotë të kriterëve të VRRK-së, pasi mund të ketë nevojë të aplikohen njëkohësisht kriteret e ndryshme të VRRK-së për të zbuluar rreziqet e korrupsionit në kuadër të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve. Personeli që kryen VRRK-në mund të shihet si gjeneralista, në kuptimin që ata duhet të jenë në gjendje të shfrytëzojnë të gjitha kriteret e VRRK-së gjatë kryerjes së një vlerësimi.

Ata gjithashtu duhet të kuptojnë si ndërlihen projektligjet, ligjet dhe rregulloret përkatëse me ligjet dhe rregulloret e tjera epore dhe të varura. Për shembull, gjatë kryerjes së vlerësimit të VRRK-së për një urdhëresë ministrrore, disa nga dispozitat e saj mund të përcaktohen nga ligjet epore, ndërsa dispozitat që përcaktojnë veprime administrative mund të caktohen në rregulloret e varura. Pa ndërmarrë një qasje holistike për analizimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve relevante, mund të mos jetë e mundur të mbulohen rreziqet aktuale të korrupsionit në kuadër të projektligjeve dhe ligjeve të vlerësuara.

ACRC-ja shfrytëzon një bazë të dhënash ku ruhen të gjitha lëndët dhe rekomandimet e VRRK-së. Duke shfrytëzuar këto të dhëna si materiale trajnimi, edhe personeli i sapo punësuar i Divizionit të VRRK-së mund të mësojë me shpejtësi se cilat janë rreziqet aktuale të korrupsionit, dhe si mund të përdoren kriteret e VRRK-së për të zbuluar faktorët që shkaktojnë korrupsion. Ata gjithashtu mund të mësojnë nga rekomandimet shembullore të VRRK-së të bëra në të kaluarën për të rritur kapacitetet e tyre për të zhvilluar rekomandime efektive të VRRK-së.

Procesi i VRRK-së është shumë efektiv në aspektin e kostove: VRRK-ja mund të zbatohet me një numër të vogël të personelit me ekspertizën e duhur, pasi mjeti të jetë vendosur mirë në kuadër të agjencisë kundër korrupsionit. ACRC-ja sugjeron shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore në fazën fillestare të zbatimit të VRRK-së, në mënyrë që më vonë të zbatohet me një numër të vogël të personelit me ekspertizën e duhur.

13. A i referohet ACRC-ja materialeve të tjera dëshmuese kur kryen VRRK-në?

Siç u përmend në pyetjen 12, zyrtarët gjithashtu shqyrtojnë ligjet dhe rregulloret e tjera relevante që kanë një marrëdhënie të ngushtë me projektligjet, ligjet dhe rregulloret që i nënshtrohen VRRK-së. Ata analizojnë tekstet përkatëse ligjore dhe ofrojnë rekomandimet e VRRK-së bazuar në një kuptim gjithëpërfshirës të kornizës ligjore.

14. Nga duhet t'ia nisi një vend zbatimit të VRRK-së?

Duhet theksuar se procesi i VRRK-së duhet të përshtatet me kontekstin ligjor dhe procedural të vendit, duke u siguruar administrimi efektiv i VRRK-së.

Gjatë fazës fillestare, në mënyrë që të demonstron efikasiteti i vlerësimit, ACRC-ja sugjeron që prioritet të jetë zbatimi i VRRK-së për ligjet që kanë një ndikim më të madh në jetën e përditshme të qytetarëve, të cilat janë:

a. Ligjet e varura siç janë rregullat administrative:

Rregullat administrative përcaktojnë mandate dhe veprime specifike të institucioneve qeveritare. Prandaj, heqja e faktorëve që shkaktojnë korrupsion në kuadër të rregullave administrative, forcon integritetin e administratës publike, çka ndikon në jetën e qytetarëve.

b. Rregullat e brendshme të kompanive shtetërore:

Kompanitë shtetërore zakonisht kryejnë punën e besuar nga organet ekzekutive, duke pasur ndikime të konsiderueshme në jetën e përditshme të qytetarëve. Për të zbutur faktorët që shkaktojnë korrupsion në kuadër të kompanive shtetërore, ACRC-ja propozoi një projektligj në parlament, i cili do ta autorizonte ACRC-në që të kryente VRRK-në për rregullat e brendshme të kompanive shtetërore kur ligji të hynte në fuqi. Teksa parlamenti nuk e ka kaluar projektligjin, ai është duke u shqyrtuar pozitivisht nga parlamentarët.

c. Adresimi i sektorëve specifikë në kuadër të të gjitha ligjeve ekzistuese:

Gjatë kryerjes së VRRK-së, ACRC-ja gjithashtu përzgjedhi sektorë të caktuar në kuadër të ligjeve dhe rregulloreve, siç është sektori i prokurimit, dhe i shqyrtoi kolektivisht të gjitha ligjet, dekretet, rregullat administrative, etj. Kjo qasje i mundësoi ACRC-së që të identifikojë dhe të largojë zonat e prirura për korrupsion në kuadër të ligjeve dhe rregulloreve.

IV.

VRRK I KRYER PËR AKTE LIGJORE DHE
STATUTE TË VARURA, DHE
RREGULLA ADMINISTRATIVE

IV VRRK I KRYER PËR AKTE LIGJORE DHE STATUTE TË VARURA, DHE RREGULLA ADMINISTRATIVE

Vlerësimi i projekt akteve ligjore dhe statuteve të varura

VRRK-ja kryhet përmes një procesi standard kur institucionet qeveritare kërkojnë nga ACRC-ja që të shqyrtojë projekt-aktet e tyre ligjore dhe statutet e varura. Tabela e mëposhtme përshkruan procedurën e përgjithshme të VRRK-së të kryer për projektligjet.

Procedura e VRRK-së për shqyrtimin e projekt akteve dhe statuteve të varura

Procedura e VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga institucioni qeveritar që i nënshtrohet VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga ACRC-ja
1. Kërkesa për VRRK	<ul style="list-style-type: none"> Dorëzon materialet e vlerësimit (përfshirë projektligjin) tek ACRC-ja 	<ul style="list-style-type: none"> Merr materialet e vlerësimit dhe përgatitet për VRRK-në
2. Kryerja e VRRK-së	<ul style="list-style-type: none"> Kalon proceset e tjera legjislative (p.sh. kryerja e konsultimeve me institucionet përkatëse dhe dhënia e njoftimit paraprak të legjislacionit) 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit e divizionit të VRRK-së kryejnë VRRK-në për materialet e dorëzuara të vlerësimit
3. Nxjerrja e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së		<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit njoftojnë institucionet përkatëse qeveritare për rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së
4. Masat pas vlerësimit	<ul style="list-style-type: none"> Përfshin rekomandimet e VRRK-së në projektligj dhe paraqet një raport pas vlerësimit tek ACRC-ja Dorëzon projektligjin e rishikuar në MOLEG për shqyrtimin e legjislacionit 	<ul style="list-style-type: none"> Monitoron nëse rekomandimet e VRRK-së janë përfshirë në projektligj përpara se të dorëzohet në MOLEG

1. Kërkesa për VRRK

VRRK-ja fillon në fazën e hartimit kur divizionet e hartimit të legjislacionit në kuadër të institucioneve qeveritare bëjnë propozim legjislativ për miratimin ose rishikimin e ligjeve dhe rregulloreve. Pas pranimit të konfirmimit nga divizionet e vlerësimit ligjor, institucionet qeveritare dorëzojnë në ACRC propozimin legjislativ, materialet e vlerësimit dhe kërkesat për VRRK.

Materialet e kërkuara të vlerësimit të dorëzuara në ACRC varen nga fakti nëse ligjet janë miratuar/rishikuar tërësisht ose pjesërisht. Materialet e kërkuara të vlerësimit që duhet të dorëzohen në ACRC janë ilustruar në tabelën e mëposhtme

Materialet e vlerësimit të dorëzuara në ACRC

Niveli i miratimit/rishikimit	Materialet e vlerësimit	Shënim
Rishikimi i pjesshëm i akteve dhe statuteve të varura	<ul style="list-style-type: none"> Propozimi legjislativ Materialet e vlerësimit bazë Shpjegimet e brendshme të lidhura me rishikimin 	<ul style="list-style-type: none"> Materialet shtesë (p.sh. materialet e vlerësimit të detajuar, deklarata specifike për rishikimin e secilës dispozitë, dokumentet e dëgjimit publik, të dhënat e hulumtimit etj.) duhet të dorëzohen kur kërkohen nga ACRC-ja
Miratimi ose rishikimi i të gjithë dispozitave në aktet ligjore dhe statutet e varura	<ul style="list-style-type: none"> Propozimi legjislativ Materialet e vlerësimit bazë Materialet e vlerësimit të detajuar Shpjegimet e brendshme të lidhura me miratimin ose rishikimin 	<ul style="list-style-type: none"> Materialet shtesë (p.sh. deklarata specifike për arsyet e miratimit ose rishikimit të secilës dispozitë, dokumentet e dëgjimit publik, të dhënat e hulumtimit etj.) duhet të dorëzohen kur kërkohen nga ACRC-ja

Në rastin e Koresë, aktet ligjore dhe statute të varura të caktuara janë të përjashtuara nga VRRK-ja (p.sh. Aktet ligjore dhe statutet e varura që përcaktojnë: strukturat e organizatave; emrin e vendit; flamurin kombëtar dhe emrin e epokës; çmimet/dekoratat, precedentët ligjorë dhe festat kombëtare; pagat dhe kompensimet; dokumentet; vulën zyrtare dhe menaxhimin e automjeteve). Vlerësuesit mund ta kryejnë VRRK-në për legjislacionin e tillë nën diskrecionin e vet, kur vlerësohet i nevojshëm.

Nëse propozimet e dorëzuara legjislative rishikohen më tej gjatë konsultimeve me agjencitë përkatëse ose para shpalljes së periudhës së legjislacionit, institucioni qeveritar duhet t'i njoftojë vlerësuesit pa vonesë për detajet dhe arsyetimin pas rishikimeve shtesë të projektligjeve.

2. Kryerja e VRRK-së

Vlerësuesit në kuadër të divizionit të VRRK-së të ACRC-së e kryejnë VRRK-në për të identifikuar faktorët që shkaktojnë korrupsion në projektligje duke aplikuar kriteret e vlerësimit të VRRK-së ndaj materialeve të vlerësimit të paraqitura nga institucionet qeveritare. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve, vlerësuesit shqyrtojnë edhe dispozita të tjera relevante të cilat konsiderohen se kanë faktorë që shkaktojnë korrupsion, për të zbutur rreziqet e korrupsionit në ligjet dhe rregulloret aktuale.

Gjatë gjithë procesit të VRRK-së, vlerësuesit angazhohen në konsultime të vazhdueshme me institucionet përkatëse qeveritare dhe mbledhin opinionet e agjencive përkatëse dhe palëve të tjera të interesit kur është e nevojshme.

Kur vlerësuesit shqyrtojnë dispozitat që lidhen me agjenci të shumëfishta ose kur kërkohet një nivel më i lartë i ekspertizës për identifikimin e faktorëve të rrezikut të korrupsionit, ata mund të kërkojnë këshilla nga ekspertë të jashtëm (p.sh. ekspertë nga grupi këshillues i VRRK-së ose nga profesionistë të regjistruar në grupin e ekspertëve të ACRC-së) për ta kryer VRRK-në në mënyrë të drejtë dhe efektive.

Gjatë pritjes së njoftimeve të rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së, institucionet qeveritare ndjekin proceset e nevojshme legjislative që kërkohen për miratimin ose rishikimin e projektligjeve, siç janë kryerja e konsultimeve me ministritë relevante dhe marrja e njoftimit paraprak të legjislacionit. Tabela e mëposhtme jep një shembull të rastit të VRRK-së të kryer për një projekt-akt ligjor.

Shembull i VRRK-së: “Ligji për arsimin në fëmijëri të hershme”

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
Neni 49 (dispozitat penale)	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Kriteri i "përshtatshmërisë së rregullave disiplinore" mund të përdoret për të zbuluar rreziqet e korrupsionit. ▫ Sanksionet për ndëshkimin e keqpërdorimit ose shitjes së informacionit tek një palë e tretë janë të përcaktuara në ligjin tjetër të lidhur. ▫ Megjithatë, legjislacioni në fjalë nuk ka ndonjë dispozitë që përcakton si do të ndëshkohet keqpërdorimi i kopshteve të fëmijëve dhe kontrollit mjekësor, ose dhënia e një informacioni të tillë një pale të tretë. Kjo nuk siguron një nivel të përshtatshëm të rregulloreve disiplinore. 	<p>Article 49 (Penal Provisions)</p> <p>Të shtohet dispozita Cilido person që keqpërdor ose siguron shënime të fëmijëve në lidhje me aktivitete të tyre në kopsht, ose historikun e shënimeve të tyre mjekësore tek një palë e tretë, Do të burgoset për jo më shumë se 00 vite ose do të gjobitet jo më shumë se 00 KRW.</p>

3. Nxjerrja e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së

Vlerësuesit zakonisht e përfundojnë procesin e VRRK-së brenda 40 ditëve (d.m.th. nga fazat e konsultimeve që përfshijnë agjencitë përkatëse deri në datën e mbylljes së njoftimit paraprak të legjislacionit) për të siguruar që VRRK-ja nuk e ngadalëson procesin legjislativ. Nëse VRRK-ja nuk mund të kompletohet me shpalljen paraprake të caktuar të periudhës së legjislacionit për shkaqe të arsyeshme (p.sh. paraqitja e vonuar e një projektligji, domosdoshmëria për plotësimin e materialeve të vlerësimit, vonesat në procesin e konsultimeve ose ndryshimet shtesë të projektligjit), periudha e vlerësimit mund të zgjatet deri në 40 ditë nga dita e fundit e shpalljes paraprake të legjislacionit. Megjithatë, vlerësuesit duhet ta përfundojnë VRRK-në sa më shpejt që të jetë e mundur.

Pas përfundimit të procesit të VRRK-së, vlerësuesit përpilojnë menjëherë raportet e vlerësimit me shkrim. Para njoftimit zyrtar të rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së, vlerësuesit së pari konsultohen me institucionet përkatëse dhe shpjegojnë arsyetimin pas rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së. Ky proces konsultimi u ndihmon vlerësuesve të minimizojnë rezistencën e institucioneve qeveritare ndaj rezultateve të VRRK-së, duke ofruar mundësi të mjaftueshme për të shpjeguar dhe diskutuar rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së me ministrinë përkatëse të qeverisë. Rezultatet e vlerësimit të VRRK-së janë: aprovimi i projektligjit të dorëzuar; aprovimi i pjeshëm i projektligjit të dorëzuar me rekomandime për përmirësim; dhe tërheqja e projektligjit të dorëzuar. Në vend që të refuzojnë projektligjin e parashtruar, vlerësuesit përpiqen të japin rekomandime për institucionet qeveritare, në mënyrë që ata të mund të heqin faktorët që shkaktojnë korrupsionin në projektligjet e tyre fillestare dhe të dorëzojnë propozimet legjislative të rishikuara në MOLEG për shqyrtimin e legjislacionit, pa u dashur të ri-kryhet i tërë procesi i VRRK-së.

ACRC-ja mund të ndajë rezultatet e VRRK-së me Komisionin e Reformës Rregullatore nëse rezultatet e vlerësimit janë relevante për Analizën e Ndikimit Rregullator. Nëse rezultatet e VRRK-së mund të shërbejnë si referencë për shqyrtimin e legjislacionit, ACRC-ja mund t'i transferojë rezultatet e VRRK-së në MOLEG.

Për më tepër, rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së ofrohen si materiale reference për mbledhjet e zëvendësministrave dhe mbledhjet e kabinetit. Kjo e bën të vështirë që institucionet qeveritare të neglizhojnë rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së, pasi më vonë mund të merren në pyetje nga vendimmarrësit e nivelit të lartë.

4. Masat pas vlerësimit

Pas marrjes së rezultateve të VRRK-së, institucionet përkatëse qeveritare i përfshijnë rekomandimet e VRRK-së dhe dorëzojnë raporte me shkrim pas vlerësimit në ACRC për të shpjeguar si janë përfshirë rekomandimet e nxjerra nga VRRK-ja në propozimin e tyre legjislativ. Raportet pas vlerësimit duhet të dorëzohen tek ACRC-ja para se institucionet qeveritare të dorëzojnë propozimet legjislative të rishikuara në MOLEG për shqyrtimin e legjislacionit. Nëse institucionet qeveritare nuk mund t'i miratojnë rekomandimet e VRRK-së, arsyet për mospërfshirjen e rekomandimeve duhet të theksohen në raportet pas vlerësimit.

Megjithëse kjo ndodh rrallë në Kore, institucionet qeveritare mund të kërkojnë rivlerësimin e projektligjeve të tyre nga ACRC-ja. Gjatë marrjes së kërkesave për rivlerësim, ACRC-ja shqyrton me kujdes nëse ka arsye të justifikueshme për kryerjen e rivlerësimit të VRRK-së, duke ekzaminuar: a) qëllimin dhe vlefshmërinë e kërkesës për rivlerësim; b) ndryshimet në rrethana (p.sh. ndryshimet në mjedisin e jashtëm) që kërkojnë rivlerësim; dhe c) arsye të tjera të justifikuara (p.sh. vështirësitë e konsultimit dhe koordinimit me institucionet relevante, etj.). Gjatë kryerjes së një rivlerësimi, ACRC-ja cakton një vlerësues të ri për të kryer vlerësimin, i cili nuk ka marrë pjesë në VRRK-në fillestare, dhe mbledh opinionet e ekspertëve për ta kryer vlerësimin në mënyrë të drejtë dhe efektive.

ACRC-ja monitoron rregullisht nëse institucionet publike janë duke zbatuar në mënyrë aktive rekomandimet e VRRK-së, duke kontrolluar nivelin e bashkëpunimit. Rezultatet e monitorimit më vonë përfshihen në vlerësimin e performancës së institucioneve përkatëse. ACRC-ja vlerëson: a) sa shpejt u dorëzua projektligji tek ACRC-ja; b) gatishmërinë e institucionit qeveritar për të siguruar materialet e vlerësimit; c) statusin e zbatimit të rekomandimeve të VRRK-së; dhe d) vendosjen dhe funksionimin e një sistemi vlerësimi autonom.

Vlerësimi i akteve ligjore dhe statuteve të varura aktuale

VRRK-ja kryhet edhe për aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale përmes një procesi standard. Tabela e mëposhtme përshkruan procedurën e përgjithshme të VRRK-së të kryer për aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale.

Procedura e VRRK-së për shqyrtimin e akteve ligjore dhe statuteve të varura aktuale

Procedura e VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga institucioni qeveritar që i nënshtrohet VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga ACRC-ja
1. Përzgjedhja e objekteve të vlerësimit	<ul style="list-style-type: none"> Dorëzon materialet e vlerësimit tek ACRC-ja 	<ul style="list-style-type: none"> Zgjedh dhe njofton objektet e vlerësimit tek institucionet qeveritare Merr materialet e vlerësimit dhe përgatit VRRK-në
2. Kryerja e VRRK-së	<ul style="list-style-type: none"> Ofron materiale shtesë të vlerësimit dhe angazhohet në konsultime me ACRC-në 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit në kuadër të divizionit të VRRK-së kryejnë VRRK-në për materialet e vlerësimit të dorëzuara duke përdorur kriteret e vlerësimit
3. Nxjerrja e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së		<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit njoftojnë institucionet përkatëse qeveritare për rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së
4. Masat pas vlerësimit	<ul style="list-style-type: none"> Përfshin rekomandimet e VRRK-së në projektligj dhe paraqet një raport pas vlerësimit tek ACRC-ja Dorëzon projektligjin e ndryshuar në MOLEG për shqyrtimin e legjislacionit 	<ul style="list-style-type: none"> Monitoron nëse rekomandimet e VRRK-së janë përfshirë në projektligj përpara se të dorëzohet në MOLEG

1. Zgjedhja e subjekteve të vlerësimit

Vlerësuesit e divizionit të VRRK-së mund të kryejnë VRRK-në edhe për të shqyrtuar faktorët që shkaktojnë korrupsionin në kuadër të akteve ligjore dhe statuteve të varura aktuale. Gjatë kryerjes së vlerësimit të akteve ligjore dhe statuteve të varura aktuale, vlerësuesit konsultohen me institucionet qeveritare për të identifikuar objektet e vlerësimit (ligjet ose detyrat specifike të nevojshme për adresimin e rreziqeve të korrupsionit) dhe për të marrë materialet e vlerësimit nga institucionet qeveritare për të kryer VRRK-në.

Vlerësuesit zgjedhin objektet e vlerësimit duke vendosur një plan vlerësimi afatmesëm/afatgjatë. Kur vlerësuesit vendosin të krijojnë plane afatmesme/afatgjata, ACRC-ja kërkon nga agjencitë administrative qendrore dhe institucionet e qeverisjes lokale të paraqesin objektet e vlerësimit për statutet aktuale. Pas kalimit të një procesi të brendshëm të zgjidhjes, ACRC-ja finalizon planet e vlerësimit, si dhe objektet e vlerësimit, dhe kërkon nga institucionet qeveritare të paraqesin materialet e nevojshme të vlerësimit për të kryer VRRK-në.

Vlerësuesit gjithashtu mund të zgjedhin objektet e vlerësimit duke shqyrtuar çështje të rëndësishme të cilat janë: legjislacioni ku janë identifikuar rreziqet e korrupsionit gjatë vlerësimit paraprak, dhe dispozitat e lidhura me skandalet e korrupsionit nxitën publikun të kërkojë veprime korrigjuese. Vlerësuesit zgjedhin si objekte vlerësimi ligjet dhe rregulloret relevante për çështjet e spikatura, dhe kryejnë VRRK-në për të zbutur rreziqet e korrupsionit në kuadër të akteve dhe statuteve të varura aktuale.

2. Kryerja e VRRK-së

Pas finalizimit të objekteve të vlerësimit, agjencitë qeveritare përgatisin dhe dorëzojnë materialet e vlerësimit tek ACRC-ja. Vlerësuesit mund të kryejnë hetime paraprake dhe anketa për të vlerësuar materialet shtesë të vlerësimit (p.sh. raportet e veprimeve disiplinore, rezultatet e auditimeve/hetimeve, trajtimi i ankesave etj.) kur konsiderohen të nevojshme për kryerjen e VRRK-së. Tabela e mëposhtme jep një shembull të rastit të VRRK-së të realizuar për një akt ligjor aktual.

Shembull i VRRK-së: "Ligji për arsimin fillor dhe dytësor"

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 31-2 (Largimi dhe diskualifikimi)</p> <p>① Personi që bie nën ndonjë nën-paragraf të Neni 33 i Ligjit për Zyrtarët Publikë Shtetërorë nuk zgjidhet si anëtar i Komisionit për Qeverisje të Shkollës.</p> <p>② Çdo anëtar i një komisioni operativ të shkollës që bie nën ndonjë nga nën-paragrafët e përshkruar në Neni 33 i Ligjit për Zyrtarët Publikë Shtetërorë, do të tërhiqet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Kriteri i "Konkretësisë dhe objektivitetit të bazës së vendimmarrjes" mund të përdoret për të zbuluar rreziqet e korrupsionit. ▫ Neni ka nevojë për një dispozitë që kufizon ri-zgjedhjen e anëtarëve të komisionit. Përndryshe, zyrtarët qeveritarë mund të ushtrojnë kompetenca diskrecionare në mënyrë arbitrare për të ri-zgjedhur anëtarët e komisionit që kanë kryer korrupsionin. 	<p>Neni 31-2 (Largimi dhe diskualifikimi)</p> <p>Të shtohet dispozita</p> <p>③ Një anëtar i komisionit i cili është larguar nga komisioni për shkak të shpërdorimit të kompetencës së tij/saj për të fituar interesa private, nuk do të rizgjidhet si anëtar i komisionit për oo vite.</p>

3. Nxjerrja e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së

Para nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit dhe rekomandimeve për institucionet qeveritare, vlerësuesit konsultohen me institucionet qeveritare në lidhje me rekomandimet e VRRK-së (që rrjedhin nga analizat e mënyrave si interpretohen statutet aktuale, si dhe nga rezultatet e VRRK-së). Për ofrimin e rekomandimeve që lidhen me çështje të rëndësishme⁴, vlerësuesit mbajnë dëgjime publike ose debate për të mbledhur opinione nga agjencitë relevante, palët e interesit dhe ekspertët, për të siguruar që pikëpamjet e tyre janë përfshirë në rekomandimet.

Pas përfundimit të proceseve të konsultimit, vlerësuesit hartojnë raportet e vlerësimit dhe i ndajnë me institucionet përkatëse qeveritare për t'i informuar për rekomandimet e VRRK-së dhe afatet e zbatimit.

⁴ "Çështjet e rëndësishme" përcaktohen në nenin 9 (3) të Udhëzimeve Operacionale për VRRK-në si në vijim:

- (a) Çështjet që kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e qytetarëve;
- (b) Kur ballafaqohen me konflikte të rënda të interesit, ose kur ACRC-ja dhe agjencia përkatëse kanë opinione kontradiktore; dhe
- (c) Çështjet që kanë të bëjnë me shumë agjenci administrative qendrore.

4. Masat pas vlerësimit

Pas marrjes së rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së, institucionet përkatëse qeveritare i përfshijnë rekomandimet e VRRK-së dhe hartojnë propozime legjislative për të ndryshuar aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale që kanë faktorë që shkaktojnë korrupsion. Institucionet qeveritare gjithashtu paraqesin tek ACRC-ja raportet pas vlerësimit për të shpjeguar si janë përfshirë rekomandimet e VRRK-së në propozimet legjislative. Raportet pas vlerësimit duhet të dorëzohen tek ACRC-ja para se institucionet qeveritare të dorëzojnë propozimet legjislative të rishikuara në MOLEG për shqyrtimin legjislativ. Nëse institucionet qeveritare nuk mund t'i miratojnë rekomandimet e VRRK-së, arsyet për mospërfshirjen e rekomandimeve duhet të theksohen në raportet pas vlerësimit.

Megjithëse kjo ndodh rrallë në Kore, institucionet qeveritare mund të kërkojnë rivlerësimin e akteve të tyre ligjore dhe statuteve të varura aktuale nga ACRC-ja. Gjatë marrjes së kërkesave për rivlerësim, ACRC-ja shqyrton me kujdes nëse ka arsye të justifikueshme për kryerjen e rivlerësimit të VRRK-së, duke ekzaminuar: a) qëllimin dhe vlefshmërinë e kërkesës për rivlerësim; b) ndryshimet në rrethana (p.sh. ndryshimet në mjedisin e jashtëm) që kërkojnë rivlerësim; dhe c) arsye të tjera të justifikuara (p.sh. vështirësitë e konsultimit dhe koordinimit me institucionet relevante, etj.). Gjatë kryerjes së një rivlerësimi, ACRC-ja cakton një vlerësues të ri për të kryer vlerësimin, cili nuk ka marrë pjesë në VRRK-në fillestare dhe mbledh opinionet e ekspertëve për ta kryer vlerësimin në mënyrë të drejtë dhe efektive.

ACRC-ja monitoron rregullisht statusin e zbatimit të rekomandimeve të VRRK-së dhe gatishmërinë e institucionit qeveritar për të bashkëpunuar. Rezultatet e monitorimit pasqyrohen më vonë në vlerësimin e performancës së agjencisë. Kur ndryshohen ligjet dhe rregulloret aktuale të vlerësuara nga VRRK-ja, dhe kështu duhet të shqyrtohen nga VRRK-ja, ACRC-ja kontrollon nëse rekomandimet e mëparshme të VRRK-së janë përfshirë në projektligje.

Vlerësimi i projekt rregullave administrative

Në parim, çdo agjenci administrative është përgjegjëse për kryerjen e VRRK-së autonome për të hequr faktorët që shkaktojnë korrupsion në kuadër të projekt-rregullave të tyre administrative. ACRC-ja zhvillon dhe shpërndan doracakët dhe listat kontrolluese të VRRK-së, si dhe rastet shembullore të VRRK-së, për të rritur kapacitetin e vlerësimeve vullnetare të institucioneve qeveritare.

Gjithashtu, ACRC-ja mund të kryejë në mënyrë të drejtpërdrejtë VRRK-në për rregullat administrative në rrethanat e mëposhtme: a) kur vlerësuesit janë duke miratuar ose rishikuar rregullat administrative të cilat janë shqyrtuar më parë nga ACRC-ja; dhe b) kur agjencia administrative përballlet me sfida në kryerjen e vlerësimit vullnetar për të hequr faktorët që shkaktojnë korrupsion.

Në bazë të kërkesës, ACRC-ja zakonisht e kryen dhe e përfundon VRRK-në për projekt-rregullat administrative brenda 40 ditëve, dhe dërgon raporte vlerësimi me shkrim në agjencitë administrative.

Vlerësimi i rregullave aktuale administrative

Për të hequr faktorët që shkaktojnë korrupsion në kuadër të rregullave aktuale administrative, ACRC-ja mund të zgjedhë si objekte vlerësimi rregulla specifike administrative që kanë faktorë që shkaktojnë korrupsion, dhe të kryejë VRRK-në për to. Gjithashtu, ACRC-ja mund të shqyrtojë rregullat administrative gjatë kryerjes së VRRK-së për projekt-aktet ligjore dhe projekt-statutet e varura, për ta kryer vlerësimin në mënyrë efektive. Aktet dhe statutet e varura shpesh i delegojnë procedurat ose veprimet specifike administrative të institucioneve qeveritare në rregulla administrative. Prandaj, pa trajtuar faktorët që shkaktojnë korrupsionin në kuadër të rregullave administrative, shqyrtimi i akteve dhe statuteve të varura mund të mos jetë i mjaftueshëm për të parandaluar aktivitetet e korrupsionit.

Nëse rregulla të caktuara administrative janë përzgjedhur si objekte të VRRK-së të ACRC-së, agjencitë qeveritare përkatëse dorëzojnë materiale vlerësimi kur kërkohet nga vlerësuesit e ACRC-së. Nëse vlerësohet e nevojshme, vlerësuesit kryejnë hetime paraprake dhe anketime për të vlerësuar materialet e vlerësimit të paraqitura nga agjencitë qeveritare.

Para nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit dhe rekomandimeve për institucionet qeveritare, vlerësuesit konsultohen me institucionet qeveritare në lidhje me rekomandimet e VRRK-së (që rrjedhin nga analizat e statusit aktual të rregullave administrative, si dhe nga rezultatet e VRRK-së). Për ofrimin e rekomandimeve që lidhen me çështje të rëndësishme, vlerësuesit mbajnë dëgjime publike ose debate për të mbledhur opinione nga agjencitë relevante, palët e interesit dhe ekspertët, për të siguruar që pikëpamjet e tyre janë përfshirë në rekomandimet.

Pas përfundimit të proceseve të konsultimit, vlerësuesit hartojnë raportet e vlerësimit dhe i ndajnë me institucionet përkatëse qeveritare për t'i informuar për rekomandimet e VRRK-së dhe afatet e zbatimit.

Pas marrjes së rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së, institucionet përkatëse qeveritare i përfshijnë rekomandimet e VRRK-së dhe hartojnë propozime legjislative për të ndryshuar rregullat aktuale administrative që kanë faktorë që shkaktojnë korrupsion. Institucionet qeveritare gjithashtu paraqesin tek ACRC-ja raportet pas vlerësimit për të shpjeguar si janë përfshirë rekomandimet e nxjerra nga VRRK-ja në propozimet legjislative. Raportet pas vlerësimit duhet të dorëzohen tek ACRC-ja para se institucionet qeveritare të dorëzojnë propozimet legjislative të rishikuara në MOLEG për shqyrtimin legjislacionit. Nëse institucionet qeveritare nuk mund t'i miratojnë rekomandimet e VRRK-së, arsyet për mospërfshirjen e rekomandimeve duhet të theksohen në raportet pas vlerësimit.



V.

VRRK I KRYER PËR RREGULLORE
KOMUNALE

V VRRK I KRYER PËR RREGULLORE KOMUNALE

Vlerësimi i projekt rregulloreve komunale

Ngjashëm me VRRK-në e kryer për rregullat administrative, divizionet e vlerësimit në kuadër të qeverive komunale kryejnë vlerësim autonom për rregulloret komunale të miratuara ose të rishikuara. Tabela e mëposhtme përshkruan procedurën e përgjithshme të VRRK-së të kryer për projekt-rregulloret komunale.

Procedura e VRRK-së për shqyrtimin e projekt-rregulloreve komunale

Procedura e VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga divizioni hartues që i nënshtrohet VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga divizioni i vlerësimit
1. Kërkesa për VRRK	<ul style="list-style-type: none"> Dorëzon materialet e vlerësimit (duke përfshirë projektligjin) në divizionin e vlerësimit 	<ul style="list-style-type: none"> Merr materialet e vlerësimit dhe përgatitet për VRRK-në
2. Kryerja e VRRK-së	<ul style="list-style-type: none"> Kalon proceset e tjera legjislative (p.sh. kryerja e konsultimeve me institucionet përkatëse dhe dhënia e njoftimit paraprak të legjislacionit) 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit në kuadër të divizionit të VRRK-së kryejnë VRRK-në për materialet e dorëzuara të vlerësimit
3. Nxjerrja e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së		<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit njoftojnë divizionin e hartimit për rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së
4. Masat pas vlerësimit	<ul style="list-style-type: none"> Përfshin rekomandimet e VRRK-së në projektligj dhe paraqet projektligjin e rishikuar në divizionin e çështjeve gjyqësore për shqyrtimin e legjislacionit 	

1. Kërkesa për VRRK

Divizioni i hartimit në kuadër të pushtetit lokal harton një propozim legjislativ për miratimin ose rishikimin e rregulloreve komunale. Menjëherë pas fillimit të konsultimit me agjencitë dhe divizionet përkatëse, divizioni i hartimit dërgon në divizionin e vlerësimit (p.sh. zyra e kontrollit dhe inspektimit, zyra e çështjeve ligjore etj.) një kërkesë zyrtare me shkrim, një propozim legjislativ (duke përfshirë një tabelë e cila krahason dispozitat origjinale me dispozitat e reja të miratuara/rishikuara), materialet e vlerësimit bazë dhe shpjegimet për miratimin ose rishikimin e rregulloreve komunale.

Rregulloret komunale që përcaktojnë çështje të thjeshta ose teknike që nuk lidhen me faktorët që shkaktojnë korrupsion (p.sh. menaxhimi i dokumenteve, etj.) përjashtohen nga VRRK-ja. Por divizioni i vlerësimit mund të vazhdojë të kryejë VRRK për rregullore të tilla nën diskrecionin e vet.

Vlerësuesit në kuadër të divizionit të vlerësimit ruajnë çdo dokument të paraqitur, duke iu vendosur numra serikë sipas rendit të dorëzimit të dokumenteve. Çdo material vlerësimi shtesë dhe dokumentet e hartuara për kryerjen e VRRK-së duhet të përpilohen në një dosje të vetme, derisa të përfundojë vlerësimi. Vlerësuesit shqyrtojnë propozimet legjislative dhe materialet e vlerësimit bazë për të shqyrtuar nëse mungojnë materiale të caktuara të vlerësimit dhe nëse materialet e vlerësimit janë përgatitur siç duhet. Nëse nevojiten më shumë materiale vlerësimi për kryerjen e VRRK-së, vlerësuesit kërkojnë nga divizioni i hartimit të dorëzojë materiale shtesë të vlerësimit.

2. Kryerja e VRRK-së

Pas përgatitjes së materialeve të mjaftueshme të vlerësimit, vlerësuesit kryejnë VRRK-në për të identifikuar faktorët që shkaktojnë korrupsion në projekt-rregulloret komunale, duke aplikuar kriteret e VRRK-së për materialet e vlerësimit të dorëzuara nga divizioni i projekteve. Vlerësuesit gjithashtu mund të shqyrtojnë rregullat përkatëse administrative (p.sh. udhëzimet, rregullat, etj.) për të hequr efektivisht faktorët që shkaktojnë korrupsion në kuadër të rregulloreve komunale.

Gjatë pritjes së njoftimeve të rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së, divizioni hartues ndjek proceset e nevojshme legjislativë që kërkohen për miratimin ose rishikimin e projektligjeve, siç janë kryerja e konsultimeve me agjencitë relevante dhe marrja e njoftimit paraprak të legjislacionit. Tabela e mëposhtme jep një shembull të rastit të VRRK-së të realizuar për një projekt-rregullore komunale.

Shembull i VRRK-së: "Urdhëresa për nxitjen e ushqimit lokal në provincën Jeollabuk-do

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 6 (Përcaktimi i tregut të fermerëve)</p> <p>① Pas pranimit të kërkesave nga kryetarët e komunave për të caktuar një treg të fermerëve, guvernatori duhet të organizojë një komision vlerësimi të përbërë nga deri në 5 ekspertë lokalë të ushqimit për të kryer vlerësimin.</p> <p>② Pas përfundimit të vlerësimit, guvernatori duhet të përcaktojë tregun e pranueshëm si treg i fermerëve dhe të sigurojë certifikimin dhe një plakë të emrit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Kriteret e qartësisë në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ dhe të rrezikut të konfliktit të interesit mund të shfrytëzohen për të zbuluar rreziqet e korrupsionit. ▫ Është e vështirë të parashikohet kur të bëhet vlerësimi dhe kur do të njoftohen rezultatet e vlerësimit. ▫ Neni aktual nuk ka dispozita që sigurojnë masa për parandalimin e konfliktit të interesit. 	<p>Neni 6 (Përcaktimi i tregut të fermerëve)</p> <p>① Pas pranimit të kërkesave nga kryetarët e komunave për të caktuar një treg të fermerëve, guvernatori duhet të organizojë një komision vlerësimi të përbërë nga deri në 5 ekspertë lokalë të ushqimit për të kryer vlerësimin. Vlerësimi do të bëhet brenda 00 ditëve nga marrja e kërkesave.</p> <p>Të shtohet dispozita</p> <p>② Për të siguruar drejtësi në procesin e vendimmarrjes, ata që bien nën nenin 2, nënparagrafi 1 i të njëjtit ligj, përjashtohen nga komisioni i vlerësimit.</p> <p>③ Pas përfundimit të vlerësimit, guvernatori duhet ta njoftojë kryetarin e komunës për rezultatet e vlerësimit brenda 00 ditësh.</p>

3. Nxjerrja e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së

Vlerësuesit zakonisht e përfundojnë procesin e VRRK-së përpara datës së mbylljes së shpalljes paraprake të legjislacionit për të siguruar që VRRK-ja nuk e ngadalëson procesin legjislativ. Pas përfundimit të procesit të VRRK-së, vlerësuesit përpilojnë menjëherë raportet e vlerësimit me shkrim dhe njoftojnë divizionin e hartimit për rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet.

4. Masat pas vlerësimit

Kur rezultatet e vlerësimit tregojnë një problem apo një hapësirë për përmirësim, vlerësuesit dërgojnë raporte vlerësimi me shkrim dhe rekomandime në divizionin e hartimit. Nëse drafti fillestar nuk ka faktorë që shkaktojnë korrupsion, vlerësuesit e aprovjnë draftin original. Pas marrjes së rezultateve të VRRK-së, divizioni i hartimit i përfshin rekomandimet e VRRK-së për të rishikuar më tej projekt-rregulloret komunale, dhe i paraqet propozimet legjislativ të rishikuara në divizionin e çështjeve gjyqësore për shqyrtimin e legjislacionit.

Kur vlerësuesit janë duke u ballafaquar me sfida në ofrimin e rekomandimeve, të tilla si opinione kontradiktore mes divizioneve përkatëse, vlerësuesit mund të kërkojnë këshilla dhe asistencë nga ACRC-ja. Në raste të tilla, qeveria përkatëse lokale mund të kërkojë nga ACRC-ja që ta kryejë VRRK-në në emër të organizatës, në përputhje me nenin 30 paragrafët 7-8 të Dekretit për Zbatimin e ACRC-së.

Vlerësimi i rregulloreve aktuale komunale

1. Procesi i vlerësimit

Vlerësuesit mund të kryejnë VRRK për rregulloret aktuale komunale për të hequr faktorët që shkaktojnë korrupsion. Gjatë kryerjes së VRRK-së, vlerësuesit mund t'u kërkojnë divizioneve përkatëse që të dorëzojnë materialet e vlerësimit.

Para nxjerrjes së rezultateve vlerësimit dhe rekomandimeve për institucionet qeveritare, vlerësuesit konsultohen me institucionet qeveritare në lidhje me rekomandimet e VRRK-së (që rrjedhin nga analizat e mënyrave si interpretohen rregulloret komunale, dhe nga rezultatet e VRRK-së). Për ofrimin e rekomandimeve që lidhen me çështje të rëndësishme, vlerësuesit mbajnë dëgjime publike ose debate për të mbledhur opinione nga agjencitë relevante, palët e interesit dhe ekspertët, për të siguruar që pikëpamjet e tyre janë përfshirë në rekomandimet.

2. Masat pas vlerësimit

Pas përfundimit të proceseve të konsultimit, vlerësuesit hartojnë raportet e detajuara të vlerësimit dhe i ndajnë me divizionet përkatëse për t'i informuar për rekomandimet e VRRK-së dhe afatet e zbatimit. Pas marrjes së raporteve të vlerësimit, divizionet përkatëse duhet t'i përfshijnë rekomandimet e VRRK-së dhe të hartojnë propozime legjislativ për rishikimin e rregulloreve aktuale. Para paraqitjes së propozimit legjislativ në komisionin e shqyrtimit të urdhëresave dhe rregullave për shqyrtimin e legjislacionit, divizionet përkatëse duhet të dorëzojnë raporte të gjendjes pas vlerësimit në divizionin e vlerësimit, për të informuar si janë përfshirë rekomandimet e VRRK-së.

Nëse divizionet përkatëse e kryejnë drejtpërdrejt vlerësimin autonom dhe zbatojnë masa përmirësuese, ata duhet të hartojnë dhe dorëzojnë një raport vlerësimi të detajuar në divizionin e vlerësimit dhe të marrin miratimin e tij para se t'i rishikojnë rregulloret aktuale.

Kur qeveritë lokale kryejnë VRRK për të hequr faktorët që shkaktojnë korrupsion në kuadër të fushave specifike të ligjeve aktuale, ata mund të kërkojnë nga ACRC-ja të ofrojë trajnime dhe konsultime për ta kryer VRRK-në në mënyrë efektive.

Vlerësimi nga ACRC-ja i rregulloreve komunale

1. Procesi i vlerësimit

Kur kërkohet nga kryetari i qeverisjes lokale, vlerësuesit e divizionit të VRRK-së mund të kryejnë VRRK për projekt-rregulloret komunale. Vlerësuesit gjithashtu mund të zgjedhin rregullore të caktuara komunale (p.sh. rregulloret në të cilat vërehen aktivitete të vazhdueshme të korrupsionit, ose kur disa rregullore konsiderohet se kanë rreziqe të qenësishme të korrupsionit) si objekte vlerësimi dhe të kryejnë VRRK për rregulloret aktuale komunale për të parandaluar korrupsionin.

Pas finalizimit të objekteve të vlerësimit, agjencitë në fjalë të qeverisjes lokale përgatisin dhe dorëzojnë materialet e vlerësimit tek ACRC-ja. Vlerësuesit mund të kryejnë hetime paraprake dhe anketa për vlerësimin e materialeve shtesë (p.sh. raportet e veprimit disiplinor, rezultatet e auditimeve/hetimeve dhe trajtimi e ankesave etj.) Agjencitë përkatëse të qeverisjes lokale gjithashtu paraqesin materiale të vlerësimit shtesë (p.sh. dokumentet e statusit operacional, statistikat, planet, dokumentet përkatëse të ankesave, rezultatet e auditimit dhe hetimit, etj.) kur kërkohet nga vlerësuesit.

Gjatë gjithë VRRK-së, vlerësuesit grumbullojnë opinione të ndryshme përmes konsultimeve të jashtme, siç janë diskutimet dhe mbledhjet, dhe nëse është e nevojshme, bashkëpunojnë me qeverinë lokale dhe ekspertët e jashtëm për të kryer anketa për të analizuar statusin e qeverisjes lokale në përputhje me nenin 29 të Ligjit të ACRC-së.

2. Masat pas vlerësimit

Pas përfundimit të VRRK-së, vlerësuesit njoftojnë krerët e qeverisjes lokale për rezultatet e vlerësimit, rekomandimet e VRRK-së dhe afatin e zbatimit. Pas marrjes së rekomandimeve të VRRK-së, krerët e qeverisjes lokale duhet t' i zbatojnë masat e nevojshme brenda afatit të caktuar, si dhe të raportojnë rezultatet e zbatimit në ACRC.

ACRC-ja monitoron rregullisht statusin e rekomandimeve të zbatuara nga qeverisja lokale dhe nivelin e bashkëpunimit të institucionit, të cilat më vonë vlerësohen në VIKK.

VI.

VRRK I KRYER PËR RREGULLAT DHE
AKTET NËNLIGJORE TË ORGANIZATAVE TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE

VI VRRK I KRYER PËR RREGULLAT DHE AKTET NËNLIGJORE TË ORGANIZATAVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Vlerësimi i rregullave dhe akteve nënligjore

1. Vlerësimi autonom i rregullave dhe akteve nënligjore

VRRK-ja kryhet për projekt-rregullat dhe rregullat e brendshme dhe aktet nënligjore aktuale të organizatave të shërbimeve publike për të siguruar një proces transparent të hartimit dhe zbatimit të politikave, duke eliminuar rreziqet e mundshme të korrupsionit. Rregullat dhe aktet nënligjore të organizatave të shërbimeve publike janë vlerësuar nga VRRK-ja që nga 28 dhjetori 2007, në përputhje me nenin 30, paragrafi 9 të Dekretit për Zbatimin e ACRC-së.

Ngjashëm me VRRK-në e kryer për rregulloret komunale, divizionet e vlerësimin të organizatave të shërbimeve publike vullnetarisht kryejnë VRRK autonome, të cilat përshtaten sipas karakteristikave të secilës organizatë. Organizatat e shërbimeve publike kryejnë VRRK për projekt-rregullat dhe aktet nënligjore si dhe për ligjet dhe rregulloret ekzistuese që janë kthyer në çështje sociale. Tabela në vijim paraqet një shembull të rastit të VRRK-së të kryer për aktet nënligjore të organizatave të shërbimeve publike.

Shembull i VRRK-së: “Aktet nënligjore për Menaxhimin e Shpenzimeve të Promovimit të Punës”

Neni relevant	Rreziqet potenciale të korrupsionit	Rekomandimi i VRRK-së
<p>Neni 8 (Dëshmia e shpenzimeve)</p> <p>③ Shpenzimet e promovimit të punës së Kryesuesit, Presidentit të degës, kreut të zyrës, dhe udhëheqësve të ekipeve do të shpalosen në faqen e internetit çdo muaj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Kriteri i hapjes mund të përdoret për të zbuluar rreziqet e korrupsionit. ▫ Neni aktual nuk kërkon shpalosjen e informacionit mbi mënyrën si i shpenzojnë divizionet ose byrotë shpenzimet e promovimit të punës (që përbëjnë 58% të shpenzimeve totale të promovimit të punës). 	<p>Neni 8 (Dëshmia e shpenzimeve)</p> <p>③ Shpenzimet e promovimit të punës së secilit divizion në kuadër të organizatës do të shpalosen në faqen e internetit çdo muaj.</p>

Rregullat e brendshme dhe aktet nënligjore të miratuara dhe të administruara nga organizatat e shërbimeve publike sipas nenit 3-2 të Ligjit për Etikën e Shërbimit Publik i nënshtrohen VRRK-së. VRRK-ja shqyrton rregullat dhe aktet nënligjore të mëposhtme: a) rregullat dhe aktet nënligjore që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe aktivitetet e korporatave (p.sh. rregullat që lidhen me kontabilitetin, kontratat, shitjet, ndërtimet dhe arkitekturën, menaxhimin e aseteve); b) rregullat dhe aktet nënligjore që kanë rreziqe të mundshme të korrupsionit (p.sh. dhënia në besim, çështjet e personelit, auditimi, hetimi, komisionimi etj.); dhe c) rregullat dhe aktet nënligjore ku janë identifikuar probleme ose hapësirë për përmirësim nëpërmjet veprimtarive korruptive, inspektimeve, auditimeve dhe kërkesave të parlamentit.

Rregullat e brendshme dhe aktet nënligjore në lidhje me çështje të thjeshta ose teknike (p.sh. rregullat mbi themelimin e agjencive, menaxhimin administrativ, përkrahjen administrative, operimin organizativ, ndarjen e punës dhe menaxhimin e dokumenteve etj.) përjashtohen nga VRRK-ja. Rregullat e brendshme dhe aktet nënligjore në lidhje me shfrytëzimin e rezortëve, ndihmës sociale dhe objekteve kulturore janë gjithashtu të përjashtuara nga vlerësimi. Sidoqoftë, divizioni i vlerësimin mund të vazhdojë të kryejë VRRK për rregulla dhe aktet nënligjore të tilla nën diskrecionin e vet. Tabelat e mëposhtme përshkruajnë procedurën e përgjithshme të VRRK-së të kryer për projekt-rregullat/rregullat dhe aktet nënligjore aktuale.

Procedura e VRRK-së për shqyrtimin e projekt rregullave dhe akteve nënligjore

Procedura e VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga divizioni hartues që i nënshtrohet VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga divizioni i vlerësimit
1. Kërkesa për VRRK	<ul style="list-style-type: none"> Dorëzon materialet e vlerësimit (duke përfshirë projektligjin) në divizionin e vlerësimit 	<ul style="list-style-type: none"> Merr dhe menaxhon materialet e vlerësimit dhe përgatitet për VRRK-në
2. Kryerja e VRRK-së	<ul style="list-style-type: none"> Pret rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit në kuadër të divizionit të vlerësimit e kryejnë VRRK-në për materialet e vlerësimit të dorëzuara brenda afatit të caktuar
3. Nxjerrja e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së		<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit njoftojnë divizionin e hartimit për rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së
4. Masat pas vlerësimit	<ul style="list-style-type: none"> Përfshin rekomandimet e VRRK-së në projektligj, dhe njofton divizionin e vlerësimit si janë përfshirë rekomandimet 	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë përbaljes me sfidat e përmirësimit vullnetar të rregullave dhe akteve nënligjore, kërkon nga ACRC-ja të kryejë VRRK-në

Procedura e VRRK-së për shqyrtimin e rregullave dhe akteve nënligjore aktuale

Procedura e VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga divizioni hartues që i nënshtrohet VRRK-së	Veprimet e ndërmarra nga divizioni i vlerësimit
1. Kërkesa për VRRK	<ul style="list-style-type: none"> Dorëzon kërkesën me shkrim të VRRK-së (duke përfshirë shpjegimin e domosdoshmërisë për kryerjen e VRRK-së) në divizionin e vlerësimit 	<ul style="list-style-type: none"> Shqyrton rregullat dhe aktet nënligjore në fjalë dhe zgjedh objektet e vlerësimit për VRRK-në <p>Shënim Divizioni i vlerësimit mund t'i zgjedhë objektet e vlerësimit edhe në diskrecionin e vet dhe të kryejë VRRK-në.</p>
2. Kryerja e VRRK-së	<ul style="list-style-type: none"> Pret rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit në kuadër të divizionit të vlerësimit kryejnë VRRK-në për objektet e vlerësimit <p>Shënim vlerësuesit mund të kryejnë konsultime të jashtme me ACRC-në dhe ekspertët përkatës kur është e nevojshme.</p>
3. Nxjerrja e rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së		<ul style="list-style-type: none"> Vlerësuesit njoftojnë divizionin e hartimit për rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së
4. Masat pas vlerësimit	<ul style="list-style-type: none"> Përfshin rekomandimet e VRRK-së dhe informon divizionin e vlerësimit si janë përfshirë rekomandimet 	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë përbaljes me sfidat e përmirësimit vullnetar të rregullave dhe akteve nënligjore, kërkon nga ACRC-ja të kryejë VRRK-në

2. VRRK e kryer nga ACRC-ja

Kreu i organizatës publike mund të kërkojë nga ACRC-ja të kryejë VRRK-në kur përmirësimet mund të mos jenë të arritshme përmes vlerësimeve vullnetare.

Rreziqet e korrupsionit të vështira për t'u adresuar nga vlerësimet vullnetare

1. Nëse një organizatë publike nuk mund të bëjë përmirësime vullnetare për shkak të konflikteve të interesit mes agjencive dhe divizioneve përkatëse
2. Nëse kërkohet shqyrtim statutor për të eliminuar faktorët që shkaktojnë korrupsion që gjenden në rregullat dhe aktet nënligjore të brendshme
3. Raste të tjera kur një organizatë publike e konsideron të vështirë të marrë një vendim autonom

Kur kërkon nga ACRC-ja që të kryejë VRRK-në, organizata publike dorëzon në ACRC shpjegimin e domosdoshmërisë për kryerjen e vlerësimit me opinionet e veta për VRRK-në. Vlerësuesit në kuadër të divizionit të VRRK-së kryejnë VRRK-në dhe kryejnë konsultime me organizatën publike në lidhje me rezultatet e vlerësimit dhe dërgojnë njoftimin me shkrim të rezultateve dhe rekomandimeve. Pas marrjes së rezultateve të vlerësimit, organizata e shërbimit publik dërgon një raport pas vlerësimit tek ACRC-ja për ta informuar nëse rekomandimet janë përfshirë në projekt-rregullat/rregullat aktuale dhe aktet nënligjore.

VII.

QASJET STRATEGJIKE PËR
VENDOSJEN E VRRK-SË: DYMBËDHJETË
ÇËSHTJE DHE SUGJERIME KRYESORE

VII QASJET STRATEGJIKE PËR VENDOSJEN E VRRK-SË: DYMBËDHJETË ÇËSHTJE DHE SUGJERIME KRYESORE

Deri më tani, ky libër i burimeve është fokusuar në përshkrimin e mënyrës si ACRC-ja kryen VRRK-në për projektligje dhe ligje. Në kuadrin e lehtësimit të shkëmbimit të njohurive mes Koresë dhe vendeve të tjera, ky kapitull synon të përshkruajë disa faktorë kyç që duhen konsideruar, si dhe të ofrojë sugjerime për politikën për vendet që janë të interesuara në krahasimin e standardeve dhe zbatimin e metodologjisë së VRRK-së. Ndërkohë që sa më poshtë mund të konsiderohet si shënim udhëzues, secili vend këshillohet që të vendosë qasjen e vet strategjike për të siguruar që ky mekanizëm të përshtatet dhe institucionalizohet në kontekste të veçanta kombëtare.

1. Si të krijohen bazat ligjore për zbatimin e VRRK-së

Është e rëndësishme të krijohet një bazë e qartë ligjore me fushëveprim mjaftueshëm të gjerë për VRRK-në për të autorizuar agjencinë kundër korrupsionit (ose institucione të tjera relevante) për futjen e VRRK-së, dhe fushëveprimi të zgjerohet gradualisht në vitet e mëvonshme. Kur të vendoset së pari VRRK-ja, mund të filloni në përmasa të vogla duke e kryer VRRK-në për çështjet e korrupsionit që janë prioriteti më i lartë për qeverinë dhe publikun. Fushëveprimi i VRRK-së mund të zgjerohet pasi VRRK-ja të njihet mirë në kuadër të institucioneve qeveritare si dhe nga publiku. Në të njëjtën kohë, baza ligjore duhet të krijohet mjaft e mirë për të mbuluar fushëveprimin e ardhshëm të VRRK-së. Përndryshe, institucionet qeveritare mund ta refuzojnë procesin e VRRK-së; dhe VRRK-ja mund të mos jetë në gjendje të evoluojë në përputhje me kapacitetin në rritje të zbatimit të vendit.

Për shembull, baza ligjore për VRRK-në duhet të mbulojë:

- a) Instrumentet për zbatimin e VRRK-së (p.sh. projektligjet, aktet dhe dekretet);
- b) Funksionet, autoritetet dhe/ose mandatet e agjencisë kundër korrupsionit (d.m.th. e drejta e agjencisë kundër korrupsionit për të kryer VRRK, për të dhënë rezultate vlerësimi dhe rekomandime në një pikë të caktuar të procesit legjislativ); dhe
- c) Metoda e zbatimit të VRRK-së (p.sh. periudha e vlerësimit, procesi i shqyrtimit dhe konsultimit, llojet e dokumenteve ose materialeve të vlerësimit për parashtrimin, dhe veprimet pas vlerësimit).

Duke krijuar që nga fillimi një bazë gjithëpërfshirëse dhe të qartë për zbatimin e VRRK-së, agjencia për zbatimin e VRRK-së mund të kursejë kohë dhe përpjekje për të bindur agjencitë qeveritare që t'i pranojnë rekomandimet e VRRK-së më vonë.

2. Kush duhet ta zbatojë VRRK-në?

Në teori, tri lloje të institucioneve mund ta zbatojnë VRRK: a) organi legjislativ si parlamenti; b) organi ekzekutiv (si ACRC-ja e Koresë nën Zyrën e Kryeministrit); ose c) një agjenci e pavarur kundër korrupsionit. Zgjedhja e organit zbatues të VRRK-së varet nga konteksti i veçantë ligjor i vendit dhe mjedisi i administratës publike.

Në Kore, mandati i qeverisë dhe veprimet administrative zakonisht përcaktohen në statute të varura, siç janë rregullat dhe procedurat administrative. Përndryshe parlamenti korean nuk i shqyrton statuten e varura kur kryen shqyrtime legjislative, VRRK-ja e kryer nga parlamenti mund të mos arrijnë të trajtojnë dinamikën aktuale të veprimtarisë së agjencive qeveritare sipas rregullave administrative. Prandaj, ACRC-ja nën Zyrën e Kryeministrit (si pjesë e degës ekzekutive) ishte përshtatja më e mirë.

Jashtë Koresë, kur një njësi në kuadër të organit ekzekutiv kryen VRRK, ka të ngjarë të jetë e pozicionuar mirë për të analizuar rreziqet e korrupsionit në statuten e varura (d.m.th. dekretet e përmbartimit dhe rregullat administrative) dhe për këtë arsye mund të prodhojnë rezultate praktike dhe rekomandime të VRRK-së, duke reflektuar kontekstin e veçantë të organit ekzekutiv.

Teksa vendimi se cila duhet të jetë organizata kryesore që duhet të jetë e ngarkuar me zbatimin e VRRK-së duhet të bëhet në bazë të kontekstit të vendit, është e domosdoshme që përgjegjëse të jetë një organizatë që ka ekspertizë kundër korrupsionit dhe është mjaft e pavarur për ta aplikuar VRRK-në pa ndërhyrje politike. Më e rëndësishmja, shteti duhet të sigurojë që VRRK-ja të përfshihet në procesin legjislativ, dhe që organizata përgjegjëse të jetë e përcaktuar në bazën ligjore të VRRK-së.

3. Si të përcaktohet fushëveprimi fillestar i VRRK-së: për ligjet aktuale ose projektligjet - apo të dyja?

Qëllimi fillestar i VRRK-së do të duhej të përcaktohej në mënyrë strategjike në përputhje me mandatet dhe kapacitetet e agjencisë kundër korrupsionit, si dhe me sfidat mbizotëruese të korrupsionit dhe kapacitetet institucionale të vendit.

Në mënyrë ideale, VRRK-ja mund të kryhet për projektligje, si dhe ligjet ekzistuese. Që nga zbatimi fillestar në vitin 2006, ACRC-ja ka kryer VRRK për ligjet ekzistuese si dhe për projektligjet. Udhëzuesi Operacional i VRRK-së Neni 13 (1) thotë se "ACRC-ja mund të krijojë plane afatmesme dhe afatgjata për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit të akteve ligjore aktuale, dekreteve presidenciale, dekreteve të kryeministrit dhe urdhëresave ministrorë; dhe direktivave, rregulloreve, lajmërimeve dhe njoftimeve të deleguara prej tyre; dhe të rregullave administrative (në tekstin e mëtejshëm: aktet ligjore aktuale dhe statutet e varura)".

ACRC-ja zakonisht kryen VRRK për ligjet ekzistuese kur: a) faktorët që shkaktojnë korrupsionin ose parregullsi të tjera në lidhje me ligjin përkatës janë njohur si çështje sociale ose pritet të rrisin shqetësimet sociale; b) VRRK-ja është e nevojshme për shqyrtimin e fushave në kuadër të ligjeve që janë strukturalisht të prirur për korrupsion; c) politika relevante për ligjin përkatës zbatohet si një politikë kombëtare ose kur rritet shpenzimi i saj buxhetor, duke kërkuar heqjen urgjente ose uljen e faktorëve që shkaktojnë korrupsion; dhe d) VRRK-ja e kryer për projektligje të miratuara/ndryshuara nxjerr në pah faktorët që shkaktojnë korrupsion në ligjet përkatëse aktuale.

Nga përvojat e ACRC-së, megjithatë, vendet mund të përballen me sfida gjatë kryerjes së VRRK-së për ligjet ekzistuese. Kur agjencia që kryen VRRK-në ka burime të kufizuara njerëzore dhe financiare, kryerja e VRRK-së në të gjitha ligjet ekzistuese thjesht nuk është e mundshme. Do të duhej të përzgjidheshin faktorë të veçantë të rrezikut të korrupsionit ose të identifikohen çështje të caktuara (p.sh. rastet e korrupsionit që mbulohej gjerësisht nga media), nga shumë kandidatë të tjerë të mundshëm. Megjithatë, një përzgjedhje e tillë mund të shihet si arbitrare dhe e padrejtë nga organet qeveritare të synuara (të cilët do të preken nga rezultatet e VRRK-së). Agjencia kundër korrupsionit do të duhet ta mbrojë vendimin e vet me një arsyetim të fortë.

Çka është më e rëndësishme në fazën fillestare të zbatimit të VRRK-së është krijimi i kritereve të qarta dhe racionale të VRRK-së. Racionaliteti, qartësia dhe koherenca logjike e kritereve ndihmojnë në ruajtjen e institucioneve zbatuese të VRRK-së nga rezistenca e mundshme nga institucionet e synuara, duke rritur normat e pranimit të rezultateve dhe rekomandimeve të VRRK-së. Pasi sistemi të jetë i institucionalizuar mirë, agjencia zbatuese mundet gjithmonë t'i përmirësojë treguesit e VRRK-së dhe gradualisht ta zgjerojë fushëveprimin e VRRK-së në lloje të ndryshme ligjesh (siç janë ligjet e rishikuara, ligjet aktuale, rregulloret komunale dhe rregullat e brendshme të organizatave të shërbimit publik).

Bazuar në përvojën e ACRC-së, pra, do të ishte e vlefshme që të merret parasysh vendosja e VRRK-së fillimisht për projektligje, duke e mbajtur kornizën ligjore për VRRK të hapur për zgjerim në ligjet ekzistuese.

4. Si të zgjidhni temat/fushat prioritare për zbatimin fillestar të VRRK-së

Në fazën fillestare, agjencia e zbatimit të VRRK-së mund të vuajë nga mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare, dhe kështu duhet të zgjedhë çështje të veçanta për VRRK, pavarësisht nga vendimi për llojin e legjislativitetit në të cilin duhet të përqendrohet. Nëse vendosni të zgjidhni çështje që janë me interes të lartë publik, kjo mund të ndihmojë në gjenerimin e përkrahjes publike për VRRK-në, çka mund të krijojë një momentum për ta vendosur VRRK-në në mënyrë solide. Megjithatë, nëse prioriteti i publikut nuk është në përputhje me interesin e organit ekzekutiv, agjencia kundër korrupsionit mund të përballë me rezistencë më të fortë nga organet qeveritare. Nga ana tjetër, agjencia zbatuese e vendos VRRK-në në fushat që organet ekzekutive i konsiderojnë me prioritet të lartë; kjo do të ndihmojë në minimizimin e rezistencës nga qeveria dhe do ta bëjë institucionalizimin e VRRK-së më të lehtë për agjencinë.

Sidoqoftë, është gjithmonë e vlefshme të kryhet VRRK-ja për projektligje ose ligje që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Në rastin e ACRC-së, komisioni vendosi të kryejë VRRK-në për ligjet e varura të tilla si rregullat administrative që ndikojnë nga afër në ofrimin e shërbimeve publike në jetën e përditshme të qytetarëve. Me kalimin e kohës, një fokus i tillë mund të ndihmojë në rritjen jo vetëm të legjitimitetit të vetë mjetit VRRK, por edhe të përkrahjes politike për agjencinë kundër korrupsionit dhe për punën parandaluese të korrupsionit në përgjithësi.

Projektligji për autorizimin e ACRC-së për të shqyrtuar dhe kryer VRRK-në për rregullat e brendshme të organizatave të shërbimeve publike

ACRC-ja aktualisht po kërkon të miratojë legjislaicionin, i cili do të zgjeronte autoritetin e tij për të rishikuar rregullat e brendshme të organizatave të shërbimeve publike. Kjo bëhet duke pranuar faktin se qeveria gjithnjë e më shumë ua jep në besim ose ua komisionon përgjegjësitë dhe detyrat e vet organizatave të shërbimeve publike, duke përfshirë kompanitë publike, çka sjell një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Pasi të miratohet, projektligji do t'i lejojë ACRC-së: a) të kërkojë nga institucionet publike të paraqesin informacion për rregullat dhe rregulloret e tyre të brendshme; dhe b) ta kryejë drejtpërdrejt VRRK-në për rregullat dhe rregulloret e brendshme të organizatave të shërbimeve publike.

5. Si të kontekstualizohen kriteret e VRRK-së

ACRC-ja e Koresë aktualisht përdor 11 kriteret e VRRK-së për të identifikuar rreziqet kryesore të korrupsionit. Meqenëse këto kriteret pasqyrojnë kontekstin specifik ligjor të Koresë dhe kapacitetin e ACRC-së, vendet që kërkojnë të miratojnë metodologjinë e VRRK-së do të duhet të zhvillojnë kriteret e tyre të VRRK-së, bazuar në strukturën e tyre ligjore, si dhe në prioritetet dhe kapacitetet kundër korrupsionit.

Në fazën fillestare, këshillohet që të prezantohen kriteret të thjeshtuara, të cilat mbulojnë vetëm disa prej rreziqeve madhore të korrupsionit të përzgjedhura, që agjencia kundër korrupsionit dëshiron t' i trajtojë si prioritet. Pasi procesi i VRRK-së të jetë i institucionalizuar mirë, agjencia kundër korrupsionit mund të prezantojë kriteret më të sofistikuar për të trajtuar një gamë më të gjerë të rreziqeve të korrupsionit.

Për shembull, kriteret ekzistuese të VRRK-së të ACRC-së mund të thjeshtohen duke:

- Bashkuar "Racionalitetin e kostove të pajtueshmërisë" dhe "Përshtatshmëria e rregullores disiplinore" në "Racionaliteti i sanksioneve dhe koston së pajtueshmërisë";
- Kombinuar "Qasshmërinë" dhe "Hapjen" në "Pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e politikave"; dhe/ose
- Fshirë "nevojën për përmirësimet e mekanizmave kundër korrupsionit".

Nga ana tjetër, mund të jetë relativisht më e lehtë që në procesin fillestar të VRRK-së të zbatohen kriteret si "Rreziku i dhënies së trajtimit preferencial", "Konkretësia dhe objektiviteti i bazës së vendimmarrjes", "Hapja" dhe "Qartësia në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ".

6. Si të rritet kapaciteti i zbatimit të VRRK-së i qeverive komunale dhe organizatave të shërbimeve publike

Në parim, zyrat e inspektimit dhe auditimit janë përgjegjëse për kryerjen e VRRK-së vullnetare për rregulloret komunale dhe rregullat e brendshme. ACRC-ja nuk ka mandat për të detyruar administrimin e VRRK-së për qeveritë komunale dhe organizatat e shërbimeve publike. Në të njëjtën kohë, ka konstatuar se të qenit i vetëdijshëm për mundësinë që rregulloret e tilla të brendshme mund t'i nënshtrohen VRRK-së krijon presion konstruktiv dhe çon në ndryshimet e sjelljes së organizatave publike; ata inkurajohen të investojnë më shumë përpjekje në aktivitetet kundër korrupsionit dhe të marrin në konsideratë masat për të parandaluar korrupsionin gjatë miratimit ose rishikimit të rregulloreve dhe rregullave.

Prandaj, mund të jetë e dobishme të zhvillohen mënyra për të përmirësuar kapacitetet e zbatimit të VRRK-së nga qeveritë komunale dhe organizatat e shërbimit publik, edhe nëse vendoset që të mos përfshihen në fushëveprimin e zbatimit të detyrueshëm të VRRK-së. Për shembull, Instituti i Trajnimit Kundër Korrupsionit i ACRC-së () ka krijuar një program trajnimi online, "Mësoni rreth zbatimit të VRRK-së përmes rasteve të VRRK-së." Gjithashtu, mbledh dhe ndan rastet shembullore të zbatimit vullnetar të VRRK-së, me qëllim që të frymëzojë dhe të udhëheqë iniciativat e ngjashme.

Gjithashtu, ACRC-ja ofron stimuj për të inkurajuar institucionalizimin e procesit të VRRK-së në institucionet publike që u nënshtrohen vlerësimeve të tjera kundër korrupsionit të ACRC-së. ACRC-ja, për shembull, shtoi kriterin, "zbatimi i rekomandimeve të nxjerra nga VRRK-ja" në Vlerësimin e vet vjetor të Iniciativës Kundër Korrupsionit (VIKK). Meqenëse rezultatet e VIKK-ut publikohen, ACRC-ja kërkon të motivojë krerët e institucioneve publike për ndërmarrjen e VRRK-së, në mënyrë që të arrihen rezultate më të larta në VIKK.

7. Si të ndërtohet përkrahja nga institucionet qeveritare

Në përvojën e Koresë, praktika sistematike e shqyrtimit të rrezeve të korrupsionit nëpërmjet VRRK-së, me kalimin e kohës, ka inkurajuar organet qeveritare që të bëjnë përpjekje proaktive për reduktimin e faktorëve të rrezikut në kuadër të projektligjeve të tyre të propozuara, madje edhe përpara dorëzimit të projektligjit për VRRK. Që të ndodhë kjo, është e rëndësishme të ndërtohet përkrahja politike dhe institucionale nga institucionet e synuara, duke krijuar një bazë të qartë ligjore për VRRK-në.

Siç është përshkruar në kapitujt e mëparshëm, VRRK-ja është institucionalizuar në Kore si pjesë integrale e procesit legjislativ formal; dhe rezultatet e VRRK-së paraqiten si material referues për mbledhjet e zëvendësministrave dhe shqyrtimet e legjislacionit të MOLEG-ut. Andaj, është bërë mjaft e vështirë për institucionet qeveritare që t' i lënë pas dore rekomandimet e ACRC-së për projektligjet e tyre të propozuara.

Kur kërkohet të vendoset VRRK-ja në kontekste të tjera, mund të jetë efektive të ndërmerret një qasje hap pas hapi që përfshin palët e interesit. Së pari, agjencia kundër korrupsionit mund të mbledhë një task force për të kristalizuar kriteret e VRRK-së dhe listën kontrolluese, si dhe për të zhvilluar një model të VRRK-së që është i zbatueshëm, i qasshëm dhe lehtësisht i zbatueshëm. Pastaj, agjencia mund të mbajë punëtori duke ftuar palët e interesit për të prezantuar VRRK-në dhe për të marrë reagime për të përmirësuar më tej procesin e VRRK-së. Pastaj, agjencia kundër korrupsionit mund të kryejë një zbatim pilot dhe të adresojë çdo problem që mund të lindë, duke marrë reagime nga institucionet e synuara. Së fundi, mjet final i VRRK-së mund të qarkullohet për konsultim përfundimtar dhe pastaj të paraqitet për miratimin zyrtar nga nivelet më të larta të autoritetit.

8. Si të rrisim kapacitetin e personelit që kryen VRRK-në

Për një zbatim efektiv dhe të qëndrueshëm të VRRK-së, agjencia administruese duhet të sigurojë që: 1) personeli është i pajisur me ekspertizën e duhur; dhe 2) puna është shpërndarë në mënyrë të përshtatshme. Teksa VRRK-ja kërkon ekspertizë ligjore, jo të gjithë anëtarët e VRRK-së duhet të jenë specialistë ligjorë. Në rastin e ACRC-së, ekipi i VRRK-së përbëhet nga zyrtarë të përgjithshëm të administratës publike, si dhe ekspertë ligjorë. Kjo lejon që VRRK të kryhet jo thjesht nga një perspektivë teknike dhe ligjore, por edhe me një kuptim të punës së përgjithshme të administratës publike, të cilës projektligjet dhe ligjet përfundimisht janë projektuar t'i shërbejnë.

Sa i përket shpërndarjes së punës në kuadër të një ekipi të VRRK-së, agjencia kundër korrupsionit ka dy opsione- ose caktojë anëtarët që të specializohen vetëm në një kriter të VRRK-së, ose të punojnë në të gjitha kriteret e VRRK-së. Bazuar në mbi 10 vjet përvojë të VRRK-së, ACRC-ja rekomandon ndërtimin e kapacitetit të personelit të VRRK-së për të qenë në gjendje të punojnë në të gjitha kriteret e VRRK-së, për arsye të mëposhtme.

- Rreziku i gjenerimit të shpërndarjes së pabarabartë të ngarkesës së punës mes personelit. Në rastin e Koresë, shumica e rrezeve të korrupsionit janë zbuluar nga katër kriteret prej të njëmbëdhjetëve: 'përshtatshmëria e rregulloreve disiplinore'; 'konkretësia dhe objektiviteti i bazës së vendimmarrjes'; 'qartësi në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ'; dhe 'rreziku i konfliktit të interesit'. Prandaj, nëse secili anëtar i personelit është i ngarkuar vetëm me një kriter, ngarkesa e punës nuk do të shpërndahej në mënyrë të barabartë.
- Nevoja për një këndvështrim që i përfshin të gjitha kriteret. Kriteret e VRRK-së janë të ndërlidhura. Nëse secili anëtar është i specializuar vetëm për një kriter, do të ishte e vështirë të adresoheshin ndërlidhjet që ekzistojnë mes kriterëve- për shembull kur dy ose më shumë kriteret krijojnë një sinergji për të gjeneruar një rrezik të përbërë të korrupsionit.

- Nevoja për një perspektivë ligjore holistike. Në përvojën e ACRC-së, pjesët e legjislacionit shpesh janë të lidhura me njëra tjetrën, vertikalisht dhe horizontalisht; dikush mund të jetë në gjendje ta kuptojë kuptimin e saktë të dispozitave të caktuara vetëm duke kuptuar dispozitat përkatëse në ligjet eplore ose në aktet nënligjore. Në raste të tilla, ekipi i VRRK-së do të duhet të identifikojë nëse rreziqet e korrupsionit zbuten/keqësohen nga marrëdhënia me ligjet e tjera përkatëse. Prandaj, do të ishte më efektive nëse çdo administrator i VRRK-së është i aftë të merret me të gjitha kriteret dhe të mbajë një perspektivë ligjore holistike.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve të ekipit, ACRC-ja ka krijuar një bazë të dhënash me precedentët dhe rekomandimet e përpiluara të VRRK-së, që zgjerohet nga çdo gjeneratë e ekipit të VRRK-së. Duke shqyrtuar rastet reale të VRRK-së dhe rekomandimet shembullore në këtë bazë të dhënash, personeli i emëruar rishtazi ndihmohet që të mësojë me shpejtësi për zbatimin praktik të kriterëve të VRRK-së. Në përvojën e ACRC-së, shembujt praktikë mund të jenë ndihma më e mirë përtej teorisë.

9. Si të koordinohet me proceset e tjera të shqyrtimit legjislativ

Ministria koreane e legjislacionit (MOLEG) ka një mandat për të shqyrtuar të gjitha aktet e legjislacionit. Andaj, edhe ACRC-ja edhe MOLEG kanë autoritetin ligjor për të kryer vlerësime për projektligjet. Në Kore, megjithatë, VRRK-ja e ACRC-së është institucionalizuar si një proces i ndarë nga shqyrtimi i legjislacionit të MOLEG-ut, duke bërë që MOLEG të kryejë shqyrtimet e veta vetëm pasi projektligji i nënshtrohet procesit të VRRK-së. Prandaj, nuk ka konflikt mes dy proceseve.

Për më tepër, VRRK-ja është legalizuar në mënyra që mbajnë potencialin e nxitjes së bashkëpunimit mes ACRC-së dhe MOLEG-ut. Sipas nenit 9 (2) të Udhëzimeve Operacionale për VRRK-në, ACRC-ja mund të konsultohet me MOLEG-un për zbatimin efektiv të rekomandimeve të VRRK-së. Neni 10 (7) i Udhëzimeve Operacionale thekson se ACRC-ja mund t'i ndajë me MOLEG-un rezultatet e VRRK-së dhe rekomandimet e ACRC-së, nëse mund të shërbejnë si pikë referimi për shqyrtimin e projektligjeve dhe ndryshimin e ligjeve (sipas nenit 21 dhe nenit 24 të Rregullit Operacional për Detyrën Ligjore, respektivisht).

Vendet që kërkojnë bashkëpunim ndërmjet agjencisë kundër korrupsionit dhe organeve të tjera të shqyrtimit të legjislacionit, këshillohen që të marrin në konsideratë përvojën e ACRC-së dhe të formulojnë mënyrat e tyre për të shmangur konfliktet ose mbivendosjen mes VRRK-së dhe proceseve të tjera.

10. Si të zvogëlohet mundësia e refuzimit të rezultateve të VRRK-së

Pas kryerjes së VRRK, ACRC-ja ose: a) miraton propozimin legjislativ të paraqitur kur nuk ka faktorë të rrezikut të korrupsionit të identifikuar gjatë procesit të VRRK-së; ose b) e miraton pjesërisht propozimin duke rekomanduar ndryshime specifike për të eliminuar rreziqet e korrupsionit të zbuluara nga VRRK-ja. Megjithatë kundërshtim i plotë i të gjithë propozimit legjislativ është i mundshëm në teori, ACRC-ja në vend të kësaj synon të ofrojë rekomandime konstruktive, në mënyrë që projektligjet e propozuara nga organi ekzekutiv të përmirësohen dhe pastaj të miratohen. Para dorëzimit zyrtar të rezultateve të VRRK-së, ACRC-ja konsultohet edhe me organet përkatëse qeveritare për të ndërtuar një kuptim të përbashkët mbi rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së.

Për më tepër, ligji VRRK-së në Kore u ka lejuar organeve qeveritare të vendosin nëse do të pranojnë ose refuzojnë rezultatet e vlerësimit të VRRK-së dhe rekomandimet e ACRC-së. Ata gjithashtu mund të kërkojnë një rivlerësim të VRRK-së, nëse kjo konsiderohet e nevojshme. Kjo qasje e krijimit të "opsioneve" dhe "autonomisë" për institucionet e synuara ka ndihmuar në uljen e rezistencës ndaj mekanizmit të VRRK-së. Në të njëjtën kohë, metodologjia e mirënjohur dhe rigoroz e VRRK-së, së bashku me konsultimet intensive me organet qeveritare para dorëzimit zyrtar të VRRK-së, kanë rritur pranimin nga institucionet e synuara. Në ditët e sotme në Kore, ministrinë e qeverisë zakonisht e pranojnë rezultatit të VRRK-së, dhe rrallë ndodhin kërkesat e rivlerësimit. Norma e pranimit të rekomandimeve të VRRK-së është rritur në mënyrë të qëndrueshme me kalimin e kohës, duke arritur një normë mbësëllënëse të pranimit prej 96.8% në vitin 2017.

11. Si të sigurojmë përkrahje të fuqishme politike për të kapërcyer rezistencën fillestare

Edhe me masat 'inkurajuese' të përshkuara më lart, një institucion kundër korrupsionit fillimisht mund të përballet me rezistencë kur paraqet mekanizmin e VRRK-së. Për ta kapërcyer këtë sfidë, duhen gjetur mënyra për të ndërtuar një përkrahje të fortë politike derisa VRRK-ja të kthehet në praktikë të rregullt të administratës publike. Për shembull, shpalosja publike e informacionit të VRRK-së mund të ndihmojë në gjenerimin e përkrahjes për miratimin e VRRK-së si një mjet për të parandaluar korrupsionin. Në rastin e Koresë, ACRC-ja publikon çdo vit Raportin e Rasteve Studimore të VRRK-së në faqen e vet të internetit, për të ndarë praktikën më të mira të VRRK-së. Ky raport ofron shembuj të vërtetë se si mund të shfrytëzohen kriteret e VRRK-së për të identifikuar faktorët që shkaktojnë korrupsionin, dhe çfarë lloj ndryshimesh janë bërë për të parandaluar rreziqet e korrupsionit. Një shpalosje e tillë e informacionit të VRRK-së për publikun mund të rrisë njohjen publike të dobisë së VRRK-së dhe të krijojë përkrahje politike që mund të lehtësojë zbatimin e VRRK-së. Vendet që kërkojnë të zhvillojnë VRRK-në, gjithashtu mund të marrin në konsideratë se si të shfrytëzojnë vlerësimet e tjera të performancës qeveritare ose shqyrtimet vjetore (për shembull, të kryera nga parlamenti ose Zyra e Kryeministrit), për siguruar stimuj dhe sanksione shtesë institucionet e synuara - për shembull, duke përfshirë dispozita për vlerësimin nëse rezultatet dhe rekomandimet e VRRK-së pranohen nga institucionet e synuara.

12. Si të përditësohen dhe të përmirësohen kriteret e VRRK-së

VRRK-ja, në mënyrë ideale, duhet të jetë një mjet i gjallë, i cili përditësohet dhe përmirësohet gjatë viteve. Kërkohen përpjekje të forta për t'i përditësuar kriteret e VRRK-së, për të qenë në gjendje që t'i jepet përgjigje efektive rreziqeve të korrupsionit dhe dinamikave në ndryshim në administratën publike.

Në rastin e Koresë, VRRK-ja ka kaluar disa rishikime nga ACRC-ja që nga prezantimi në vitin 2006, për të rritur fuqinë e metodologjisë dhe për të adresuar sfidat e reja të korrupsionit, të cilat nuk mund të adresoheshin me treguesit e vjetruar. Në janar 2016, për shembull, ACRC-ja i përditësoi kriteret e VRRK-së siç përshkruhet në kutinë e mëposhtme.

Arsyetimi për ndryshimet kyçe të bëra në kriteret e VRRK-së në vitin 2016

1. Institucionet qeveritare ua besojnë gjithnjë e më shumë çështjet e tyre administrative institucioneve të sektorit privat, dhe aktivitetet e korrupsionit të lidhura me procesin e dhënies në besimit kanë qenë një shqetësim serioz në Kore. Në përgjigje, ACRC-ja përforcoi kriterin e VRRK-së për dhënien në besimin, duke zëvendësuar atë që dikur ishte "përshtatshmëria e standardeve të dhënies në besim/komisionit" me "transparencën dhe llogaridhënien e dhënies në besim/komisionit".
2. Gjithashtu, ACRC-ja zëvendësoi "qartësinë e standardeve të përkrahjes financiare" me kriterin më të gjerë dhe më rigoroz, "potenciali për keqalokim ose keqpërdorim të përkrahjes së qeverisë". Ky ndryshim ishte në përgjigje të rritjes së investimeve financiare nga qeveria koreane për shërbimet e ndihmës sociale dhe subvencione në vitet e fundit, çka gjithashtu kishte krijuar potencial më të madh për korrupsion dhe shpërdorime buxhetore.
3. Në përputhje me rritjen e kapaciteteve institucionale për parandalimin e korrupsionit në Kore, ACRC-ja sapo shtoi kriterin "nevoja për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit", për të vlerësuar nëse institucionet relevante duhet të krijojnë mekanizma kundër korrupsionit për parandalimin e korrupsionit për zbatimin efektiv të ligjit.
4. Për të pasur një vlerësim më të qartë, ACRC-ja gjithashtu ndryshoi termin "përshtatshmëri" me "racionaliteti" për kriterin e "racionalitetit të kostove të pajtueshmërisë", ndërkohë që ndau kriterin e "qasshmërisë/hapjes" në dy kritere të veçanta të "qasshmërisë" dhe "hapjes".

Sipas përvijës së ACRC-së, atyre që kërkojnë të vendosin qasjen e VRRK-se u rekomandohet ta përdorin VRRK-në si një mjet dinamik për parandalimin e korrupsionit, për të identifikuar dhe trajtuar rreziqet e reja të korrupsionit. Korrupsioni nuk është një fenomen statik, por një produkt i ndryshimit të konteksteve sociale dhe zbrazëti në sistemin ligjor dhe të administratës publike.

SHTOJCA

Shtojca 1. Shabllonet dhe udhëzimet e vlerësimit të VRRK-së për ligje dhe statute të varura

- Institucionet qeveritare që bëjnë rishikime të pjesshme të ligjeve duhet të dorëzojnë materialet e vlerësimit bazë tek ACRC-ja.
- Institucionet qeveritare që miratojnë ose rishikojnë të gjitha dispozitat e ligjeve, duhet të dorëzojnë materialet e vlerësimit bazë dhe të hollësishtëm tek ACRC-ja.

Shënim

Edhe në rastin e rishikimeve të pjesshme, institucionet qeveritare duhet gjithashtu të dorëzojnë materialet e hollësishtëm të vlerësimit kur kërkohet nga ACRC-ja.

Materialet e vlerësimit bazë për akte ligjore dhe statute të varura

Shablloni i vlerësimit me shembuj

Titulli i legjislacionit	Akti Kornizë për Informatizimin Kombëtar (Titulli i sistemit:)						
Kategoria	Hyrja në fuqi		Plotësim-ndryshimi			Ligji Aktual	
Lloji	Akt	Dekret presidencial	Dekret i kryeministrit	Urdhëresë e ministrisë	Rregullore administrative (përfshirë akte nënligjore, akte themelimi)	Urdhëresë	Rregullore
Rregullore të lidhura administrative. (shpallje, direktiva, rregullore, rregulla, udhëzues etj.)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Udhëzimet dhe kriteret e aplikimit për lejimin e transportuesve të zakonshëm 2. Udhëzime për trajtimin e regjistrimit të bizneseve të kategorive të posaçme të telekomunikimit 3. Rregullorja për H&ZH dhe menaxhimin e TIK-ut 4. Projekti për dizajnin dhe mbështetjen e teknologjive të reja të shkëlqyera 5. Udhëzime për menaxhimin e fondit për promovimin e informatizimit 						
Agjencia përkatëse	Emri	Ministria e Shkencës, TIK-ut dhe Planifikimit të Ardhshëm (MSIP)					
	Divizioni mbikëqyrës (shqyrtimi)	Divizioni (seksioni)			Divizioni i Reformës Rregullatore dhe i Çështjeve Ligjore		
		Personi i ngarkuar Rangu / Emri / Numri i telefonit			Rangu i 5-të/ OOO /02-2110-0000		
	Divizioni i Biznesit (Zbatimi)	Divizioni (seksioni)			OOOO		
Personi i ngarkuar Rangu / Emri / Numri i telefonit			Rangu i 4-t/ OOO/ 02-2110-0000				
Afat i legjislativ (i planifikuar) ※ Vetëm për akte në fuqi ose të rishikuara	Konsultimi me Agjencitë relevante	Homologu					
		Periudha	Nga . . . Në . . . (ditë)				
	Para-shpallja	Nga . . . Në . . . (ditë)					
Shtojca	Materiale esenciale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Propozimi statutor (përfshirë tabelën krahasuese para/pas dispozitave) 2. Shpjegimi i rishikimit të akteve 					
	Tjetër	<ol style="list-style-type: none"> 1. Deklarata vjetore e kontributeve për e transportuesit e zakonshëm 2. Statusi aktual i projekteve të H&ZH dhe raporti i vlerësimit i çdo projekti 					
Hartues	Agjencia	Divizioni	Rangu	Emri	Numri i telefonit		
	MSIP	OOOO	Zv. Drejtor i lartë	OOO	02-2110-0000		

Materialet e vlerësimit të detajuar për akte ligjore dhe statute të varura

Fusha e vlerësimit: Pajtueshmëria

Racionaliteti i kostove të pajtueshmërisë: A janë rationale shpenzimet e pajtueshmërisë që përballohen nga individët dhe bizneset për të qenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret?

- ① Të tepruara ② Racionale

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 1-1> Detajet e ligjeve dhe rregulloreve të lidhura me kostot e pajtueshmërisë

Nr. ^①	Baza ligjore ^②	Detajet e kostove të pajtueshmërisë ^③	Palët relevante të interesit ^④ (Informata të kontaktit)
1	▫ Neni 4 i Ligjit për Masat Sanitare të Ushqimit	▫ Ndalon shitjen, ruajtjen, transportimin dhe shfaqjen e ushqimeve të rrezikshme	▫ Shoqata Koreane e Industrisë së Shërbimit Ushqimor (1688-0000)
2	▫ Neni 8 i Ligjit për Masat Sanitare të Ushqimit	▫ Ndalon shitjen, shfrytëzimin e aparatit toksik, etj.	▫ Shoqata Koreane e Industrisë së Shërbimit Ushqimor (02-3470-0000) ▫ Shoqata Koreane e Arteve Qeramike (031-632-0000)
3	▫ Neni 41 i Ligjit për Masat Sanitare të Ushqimit	▫ Punonjësit e bizneseve të shërbimit ushqimor duhet të marrin trajnim vjetor të detyrueshëm për higjienën	▫ Shoqata Koreane e Industrisë së Shërbimit Ushqimor (1688-0000)

<Komente shtesë> Nevoja dhe vlefshmëria e vendosjes së kostove të pajtueshmërisë^⑤

3	▫ Zbatimi i trajnimit të detyrueshëm sanitar për punëtorët e industrisë ushqimore mund të parandalojë rreziqet shëndetësore të lidhura me ushqimin dhe të përmirësojë cilësinë ushqimore të ushqimeve
---	---

<Materiale referuese>^⑥

1	▫ Njoftime për shtyp në lidhje me ushqimet e rrezikshme
2	▫ Opinonet e palëve të interesit në lidhje me rishikimin e propozuar të Ligjit të Masave Sanitare të Ushqimit

① Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë kostot e pajtueshmërisë, duke përdorur numrat serikë

② Tregoni nenet e aktit që përcaktojnë kostot e pajtueshmërisë

③ Përshkruani kostot e pajtueshmërisë, duke përfshirë shpenzimet kapitale, si dhe sakrificat ligjore dhe faktike, dhe kostot e mundësive **Shembuj të kostove të pajtueshmërisë**: dokumente të ndryshme, deklarata paraprake, trajnime, raporte të rregullta, inspektime të rregullta, përdorimi i artikujve të caktuar, ndalimi i objekteve ose veprimeve specifike, largime, kufizime në punën e jashtme etj.

④ Vendosni emrin dhe informacionin e kontaktit të palëve relevante të interesit (d.m.th. individët ose organizatat që u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve) për të shqyrtuar vlefshmërinë e barrës së pajtueshmërisë

⑤ Jepni çdo informacion shtesë të lidhur me nevojën dhe vlefshmërinë e kostove të pajtueshmërisë (sipas numrave serikë të dhënë në Tabelën 1-1), kur shihet e nevojshme

⑥ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë, dhe bashkëngjitni çdo dokument veç e veç **Shembuj të materialeve referuese**: ligje relevante (statutet e varura dhe rregullat administrative), dokumentet hulumtuese, materialet e dëgjimit publik, rezultatet e anketës publike, njoftimet për shtyp etj.

Kriteri i “përshtatshmërisë së rregulloreve disiplinore”: A janë të përshtatshme përmbajtja dhe niveli i sanksioneve të vendosura për shkeljen e ligjeve?

- ① Të përshtatshme ② Të lehta ③ Strikte

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 1-2> Detajet e ligjeve dhe rregulloreve të lidhura me sanksionet

Nr. ^①	Baza ligjore ^②	Detajet e shkeljeve ^③	Detajet e sanksioneve ^④
1	▫ Neni 47 i Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit	▫ Një person që ka marrë një subvencion të paligjshëm nën pretendime të rreme ose duke përdorur metoda të tjera të padrejta	▫ Burgim për jo më shumë se 5 vjet ose gjobë që nuk tejkalon 20 milionë KRW
2	▫ Neni 47 i Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit	▫ Një person i cili ka shfrytëzuar një subvencion për qëllime të tjera nga mbrojtja apo përkrahja e viktimave të krimit	▫ Burgim për jo më shumë se 3 vjet ose gjobë që nuk tejkalon 10 milionë KRW

<Komente shtesë> Nevoja e vendosjes së sanksioneve dhe vlefshmëria e nivelit të sanksioneve^⑤

Nr.	Nevoja e vendosjes së sanksioneve dhe vlefshmëria e nivelit të sanksioneve
1	▫ Duke marrë parasysh ndikimin shoqëror dhe dëmin e shkaktuar nga marrja e një subvencioni ilegal, ose shfrytëzimi i tij për qëllime të paspecifikuara, personi i cili ka marrë një subvencion me pretendime të rreme ose duke shfrytëzuar metoda të tjera të padrejta dënohet me burgim për jo më shumë se pesë vjet ose me një gjobë që nuk tejkalon 20 milionë KRW. Personi i cili ka shfrytëzuar një subvencion për qëllime të paspecifikuara dënohet me burgim për jo më shumë se tre vjet ose me gjobë jo më të madhe se 10 milionë KRW

<Materiale referuese>

Nr.	Detajet e materialeve referuese
2	▫ Të dhënat statistikore të të lidhura, siç janë rastet e dokumentuara të individëve që marrin subvencione në mënyrë të paligjshme dhe të padrejtë, dhe i përdorin për qëllime të paspecifikuara ▫ Sanksione të ngjashme të vendosura me aktet e tjera ligjore dhe statutet e varura

① Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë sanksionet për shkeljen e ligjeve dhe rregulloreve (duke përfshirë shtojcën përkatëse), duke përdorur numrat serikë

② Tregoni nenet e aktit që përcaktojnë sanksionet

③ Përshkruani nivelin e sanksioneve (p.sh. lloji, ashpërsia, numri dhe serioziteti i shkeljeve, etj.)

④ Përshkruani shkurtimisht llojin dhe nivelin e sanksioneve të vendosura për shkeljen e ligjeve (Nëse detajet e sanksioneve janë deklaruar në një seksion të shtojcave, përmbledhe dhe bashkëngjite dokumentin veçmas)

Shembuj të sanksioneve:

- Anulimi, tërheqja dhe pezullimi i lejes për biznes.
- Ndëshkimi, gjobë për neglizhencë, taksa shtesë, para të fituara në mënyrë të paligjshme, pagesë shtesë, tarifë shtesë dhe detyrim.
- Njoftimi publik i shkeljeve, kufizimi i punësimit, refuzimi i furnizimit, kufizimi i kualifikimit për biznesin e licencuar nga qeveria ose për ofertim.

⑤ Jepni çdo informacion shtesë të lidhur me nevojën e vendosjes së sanksioneve dhe vlefshmërinë e nivelit të sanksioneve (sipas numrave serikë të dhënë në Tabelën 1-2), kur shihet e nevojshme

⑥ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë dhe bashkëngjisni çdo dokument veç e veç

Shembuj të materialeve referuese: dokumente hulumtuese, materiale të dëgjimit publik, rezultate të anketës publike, njoftime për shtyp etj.

“Kriteri i “rrezikut të dhënies së trajtimit preferencial””: A ekziston rreziku që disa klasa, biznese, grupe ose individë mund të marrin trajtime ose përfitime preferenciale gjatë zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve?

① Jo ② Po

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 1-3> Detajet e ligjeve dhe rregulloreve që japin përfitime

Nr. ^①	Baza ligjore ^②	Përfituesi ^③	Detajet e përfitimeve ^④
1	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Neni 33 i Ligjit të Arsimit Fillor dhe të Mesëm ▫ Neni 64 i Dekretit për Zbatimin e Ligjit 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Komisioni Drejtues i Shkollës 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Mbledhja dhe përdorimi i fondeve për zhvillimin e shkollave
2	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Neni 18-5 i Ligjit për Masat Speciale për Promovimin e Bizneseve Sipërmarrëse 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Qeveritë lokale dhe bizneset sipërmarrëse në rajonet e promovimit të biznesit 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Përkrahja preferenciale me fonde
3	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Neni 25 i Ligjit Special për Zhvillimin e Qyteteve të Ndërmarrjeve 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Operatorët e projektit zhvillimor 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Përrjashtimi nga taksa dhe pagesa

<Komente shtesë> Arsyetimi i dhënies së trajtimeve preferenciale dhe përshtatshmëria e tij^⑤

Nr.	Arsyetimi i dhënies së trajtimeve preferenciale dhe përshtatshmëria e tij
1	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të rritet autonomia dhe diversiteti i administratës shkollore
2	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të zvogëlohet hendeku ekonomik mes rajoneve të ndryshme dhe të rigjallërohen industritë rajonale strategjike, duke nxitur dhe mbështetur bizneset sipërmarrëse që u përshtaten karakteristikave rajonale
3	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Të sigurohet mbarëvajtja e zhvillimit të qyteteve të ndërmarrjeve

<Materiale referuese>^⑥

Nr.	Detajet e materialeve referuese
2	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Raporti i hulumtimit që ofron masa për të rritur transparencën në menaxhimin e fondeve për zhvillimin e shkollave

- ① Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara të cilat sigurojnë/mund të ofrojnë përfitime ose përfitime dytësore për dikë, duke përdorur numrat serikë
- ② Tregoni nenet e aktit që japin trajtim preferencial të përfitimeve dytësore
- ③ Tregoni përfituesin që merr/mund të marrë përfitime
- ④ Përkrahuri shkurtimisht detajet e përfitimeve të deklaruara në projektligjet, ligjet dhe rregulloret
- ⑤ Jepni çdo informacion shtesë që lidhet me arsyetimin e dhënies së trajtimit preferencial dhe përshtatshmërinë e tij (sipas numrave serikë të dhënë në Tabelën 1-3), kur shihet e nevojshme
- ⑥ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë dhe bashkëngjisni çdo dokument veç e veç

Fusha e vlerësimit: Ekzekutimi

Kriteri i “konkretësisë dhe objektivitetit të themelit të vendimmarrjes: A janë të përcaktuara në mënyrë konkrete dhe objektive detajet e kompetencave diskrecionare (p.sh. objekti, fushëveprimi dhe niveli i diskrecionit dhe procesi i ushtrimit të diskrecionit)? A ekziston një mekanizëm për të parandaluar ushtrimin e tepruar të kompetencave diskrecionare?

① Konkret/objektiv (duke përfshirë një mekanizëm kontrolli) ② Abstrakt/subjektiv

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 2-1> Detajet e ligjeve dhe rregulloreve të lidhura me kompetenca diskrecionare

Nr.①	Baza ligjore②	Detajet e kompetencave diskrecionare③
1	◦ Neni 33-37 i Ligjit të Lumenjve	◦ Dhënia e lejes për shfrytëzimin e zonave të lumenjve dhe mbledhja e tarifave të profesionit
2	◦ Neni 9, paragrafi 4 i Ligjit të Peshkimit	◦ Në kushte të caktuara, kryetari i komunës, guvernatori i qarkut ose kreu i zyrës së qarkut lëshon licencë (d.m.th. licencë për peshkimin e fshatit, peshkimin e kooperativës ose peshkimin tjetër përveç peshkimit të kryer në det të hapur) për shoqëritë e peshkimit të fshatit, korporatat e peshkimit dhe kooperativat e peshkimit
3	◦ Neni 25, 27, 28 i Ligjit të Kontrollit të Mbeturinave ◦ Neni 11 i Dekretit për Zbatimin e Ligjit (Shtojca 6)	◦ Dhënia e lejes për grumbullimin, transportimin dhe përpunimin e mbeturinave ◦ Anulimi/pezullimi i një lejeje ose licence, ose vendosja e një pagese penaliteti në kushte të caktuara
4	◦ Neni 132 i Ligjit për Menaxhimin e Mjedisit Detar ◦ Neni 98 i Dekretit për Zbatimin e Ligjit (Shtojca 19)	◦ Vendosja e gjobave të rënda ose të zbutura në bazë të rezultateve të vlerësimit të ndikimit të ndotjes detare rezultojnë se penalizon raportuesit e rremë, emetuesit e ndotësve dhe ata që nuk i kryejnë detyrat e tyre, të tilla si mbajtja, dorëzimi dhe raportimi i dokumenteve në pajtim me Ligjin

Standardet për përcaktimin e ekzistencës së kompetencave diskrecionare

- Nëse ligjet dhe rregulloret që përcaktojnë kërkesat dhe standardet për disponimin administrativ përbajnë koncepte ose shtigje të papërcaktuara, kompetencat diskrecionare në kuadër të këtyre projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve duhet të analizohen nga VRRK-ja
 - Kur interpretoni dhe zbatoni rregulloret me mungesa ose koncepte të papërcaktuara që janë abstrakte dhe me shumë kuptime, kjo mund t'u lejojë zyrtarët qeveritarë të ushtrorjnë kompetenca diskrecionare de facto, ose të marrin vendime arbitrare
 - Në qoftë se një dispozitë ligjore përcakton cilat veprime specifike mund të ndërmerren ose cilat veprime të caktuara mund të ndërmerren mes opsioneve të shumëfishta, dispozita siguron kompetenca diskrecionare
 - Kur një dispozitë ligjore jep kompetenca diskrecionare që një veprim i caktuar mund të ndërmerret apo jo (p.sh. "Kur..., dikush mund...", dhe "Kur..., askush nuk mund të...")
 - Kur një dispozitë ligjore lejon që një veprim i caktuar të nxirret nga veprime të shumëfishta (p.sh. "Kur..., mundet të... ose...")

Shënim

Nëse nuk është e qartë nëse dispozitat janë duke dhënë kompetenca diskrecionare (p.sh. dispozita të tilla si: “Kush synon të bëjë... duhet të marrë miratimin nga Ministri oo), tregojini këto dispozita të tilla në Tabelën 2-1.

<Tabela 2-2> Konkretësia/objektiviteti i rregullave diskrecionare

Nr. ^④	Kompetenca diskrecionare (Baza ligjore) ^⑤	Individët ose subjektet që ushtrojnë kompetenca diskrecionare ^⑥	Procesi/Kërkesa për Ushtrimin e Kompetencave Diskrecionare ^⑦	Fushëveprimi/Shkalla e kompetencave diskrecionare ^⑧	Mekanizëm Kontrolli ^⑨
1	▫ Llogaritja e një pagese penaliteti (Shtojca 1 e Dekretit për Zbatimin e Ligjit për etiketimin dhe reklamimin e drejtë)	▫ Komisioni i Tregtisë së Drejtë	▫ Neni 15 i Ligjit ▫ Shtojca 1 e Ligjit	▫ Vendosja e pagesës së penaltetit të reduktuar (deri në 50%) ▫ Përfshirja nga pagesa e penaltetit	▫ Arsyet për vendosjen e pagesës së penaltetit të zvogëluar janë përcaktuar në shkresën e rezolutës

<Komente shtesë> Arsyetimi i rregullave abstrakte/rregulloreve subjektive diskrecionare^⑩

Nr.	Arsyetimi i rregullave abstrakte/rregulloreve subjektive diskrecionare
1	▫ Të vendosen pagesa penaliteti në mënyrë fleksibile, duke pasur parasysh rrethanat e pashmangshme (p.sh. pamundësia e subjektit shkelës për të paguar gjokat, ndryshimet ose përkeqësimi i kushteve të tregut/industrisë, shfaqja e krizave ekonomike etj.)

<Materiale referuese>^⑪

Nr.	Detajet e materialeve referuese
2	▫ Njoftimi publik në lidhje me standardet specifike për vendosjen e pagesave të penaltetit për bizneset që shkelin Ligjin për etiketimin dhe reklamimin e drejtë (Komisioni Korean i Tregtisë së Drejtë, njoftimi nr. 2014-12)

- ① Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë kompetencat diskrecionare, duke përdorur numrat serikë
- ② Vendosni nenet e aktit që përcaktojnë kompetencat diskrecionare
- ③ Përkrahuri shkurtimisht detajet e kompetencave diskrecionare (lënda, fushëveprimi, standardet dhe procedurat për ushtrimin e kompetencave diskrecionare)

Shënim Edhe nëse kompetenca diskrecionare nuk është e përcaktuar drejtpërdrejtë, ju lutemi shënoni detajet e dispozitave që kërkojnë që zyrtarët publikë ose agjencitë e lidhura me ta të marrin vendime diskrecionare (p.sh. interpretimi dhe zbatimi i koncepteve të papërcaktuara ose përzgjedhja e efekteve etj.), të cilat konsiderohen statute diskrecionare de facto.
- ④ Listoni e dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë kompetencat diskrecionare (sipas numrave serikë të dhënë në Tabelën 2-1)
- ⑤ Vendosni nenet që përcaktojnë kompetencat diskrecionare (duke përfshirë detajet kryesore të kompetencave diskrecionare të parashikuara në projektligjet, ligjet dhe rregulloret përkatëse ose kompetencat e tjera diskrecionare që mund të nxiten nga interpretimi i dispozitave)
- ⑥ Vendosni individët dhe/ose subjektet që ushtrojnë kompetenca diskrecionare
- ⑦ Vendosni nenet e aktit që përcaktojnë proceset dhe kërkesat për ushtrimin e kompetencave diskrecionare (Nëse detajet përkatëse janë paraqitur në një seksion të shtojcave ose në statutet e varura, përmbledhni dhe bashkëngjitni dokumentin veçmas)
- ⑧ Përkrahuri në detaje veprimet ose efektet që mund të zbatohen duke ushtruar kompetenca diskrecionare

Shembuj të veprimeve ose efekteve:

 - dhënia e lejeve, dhënia e licencave, anulimi ose pezullimi i lejeve ose licencave, interpretimi ose zbatimi i koncepteve të papërcaktuara.
 - kohëzgjatja e periudhës (periudha e anulimit ose pezullimit, etj.)
 - kufijtë e sipërm ose të poshtëm të shumës (standardet për gjobën rënduese ose zbutëse ose pagesën e penaltetit).
- ⑨ Përkrahuri në detaje llojet dhe përmbajtjen e mekanizmit të kontrollit të parashikuar në projektligje, ligje dhe rregullore për të parandaluar ushtrimin e tepruar të kompetencave diskrecionare
- ⑩ Tregoni arsyet e rregullave abstrakte/rregulloreve subjektive diskrecionare (në bazë të numrave serikë të dhënë në Tabelën 2-2)
- ⑪ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë, dhe bashkëngjitni çdo dokument veç e veç

Shembuj të materialeve referuese : statutet e varura që përcaktojnë në mënyrë të hollësishme diskrecionin përkatës, etj.

Kriteri i "transparencës dhe llogaridhënies së dhënies në besim/komisionimit": A janë të përcaktuara qartë kërkesat, fushëveprimi, kufizimi dhe procedura e përzgjedhjes së dhënies në besim dhe komisionimit kur autorizimet dhe detyrat u janë besuar organizatave të shërbimeve publike apo organizatave të ndryshme private?

① Po ② Jo

A ekziston një mekanizëm menaxhimi dhe monitorimi për të siguruar llogaridhënien e dhënies në besim/komisionimit?

① Po ② Jo

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 2-3> Detajet e ligjeve dhe rregulloreve të lidhura me dhënien në besim/komisionimin

Nr. ^①	Emri i çështjeve në fjalë ^②	Baza ligjore ^③	Kërkesat ^④	Fushëveprimi/ Kufizimi ^⑤	Procedura e përzgjedhjes ^⑥	Mekanizmat e Menaxhimit/ Monitorimit ^⑦
	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Aprovimi zyrtar i kualifikimeve teknike kombëtare 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Neni 23, paragrafi 2 i Ligjit Kombëtar të Kualifikimeve Teknike ▫ Neni 29, paragrafi 4 i Dekretit për Zbatimin e Ligjit 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Korporata jofitimprurëse e pajisur me organizim, fuqi punëtore dhe pajisje të nevojshme për aprovim zyrtar, e cili ka ekspertizë dhe përfaqësim në secilën fushë të kualifikimit (neni 29 (4) i Dekretit të Zbatimit) 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Neni 29, paragrafi 4-6 i Dekretit të Zbatimit 	<p>Paraqitja e kërkesës për dhënie në besim → lajmërimi i njoftimit zyrtar → dorëzimi i kërkesës për dhënie në besim → shqyrtimi, përcaktimi dhe njoftimi (neni 41 i Rregullores së Zbatimit të Ligjit)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Vlerësimi i agjencisë së mirëbesimit, anulimi i mirëbesimit, funksioni ligjor si zyrtarë publikë (Neni 24, 24-2, 25 i Ligjit)
	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Operimi i kurseve të caktuara të arsimit dhe trajnimit 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Neni 10, Paragrafi 2 i Ligjit Kombëtar të Kualifikimeve Teknike 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Çdo palë që plotëson standardet (p.sh. fakulteti, objekti dhe pajisjet për eksperiment dhe trajnim dhe kurrikulë) të përshkuara me Dekretin Presidential (neni 10 paragrafi 2 i ligjit) 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Neni 10, paragrafi 2 i Ligjit 	<p>Aplikimi për caktimin → konsultim me Ministrin e Punësimit dhe Punës → shqyrtimi, caktimi dhe njoftimi (neni 14-2 i Dekretit të Zbatimit)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Hetimi për agjencitë e caktuara, anulimi i caktimit (Neni 24-4, 24-5 i Ligjit)

<Komente shtesë> Arsyetimi i rregullores së errët mbi dhënien në besim dhe komisionimin^⑧

Nr.	Arsyetimi i rregullores së errët mbi dhënien në besim dhe komisionimin

<Komente shtesë> Arsyetimi i mungesës së mekanizmave të menaxhimit dhe monitorimit^⑨

Nr.	Arsyetimi i mungesës së mekanizmave të menaxhimit dhe monitorimit

<Materiale referuese>^⑩

Nr.	Detajet e materialeve referuese

- ① Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë çështjet që kanë të bëjnë me dhënien në besim dhe komisionimin (duke përfshirë edhe ri-dhënien në besim), duke përdorur numrat serikë

Shënim

Ju lutemi gjithashtu, të tregoni dispozitat që përcaktojnë caktimet për dhënien e punëve administrative.

- ② Përshkruani çështjet kyçe të dhënies në besim dhe komisionimit
- ③ Vendosni nenet e aktit që përcaktojnë dhënien në besim dhe komisionimin
- ④ Përshkruani shkurtimisht standardet për zgjedhjen e subjektit të dhënies në besim dhe komisionimit (duke përfshirë nenet përkatëse të aktit)
- ⑤ Përshkruani shkurtimisht qëllimin dhe kufizimet e çështjeve të dhënies në besim dhe komisionimit (duke përfshirë edhe nenet përkatëse të aktit)
- ⑥ Përshkruani shkurtimisht procedurën për zgjedhjen e një subjekti të dhënies në besim dhe komisionimit (duke përfshirë nenet përkatëse të aktit)
- ⑦ Përshkruani shkurtimisht detajet e mekanizmit të menaxhimit/monitorimit për dhënien në besim dhe komisionimin (duke përfshirë nenet përkatëse të aktit)
- ⑧ Tregoni arsyetimin e rregullave të errëta mbi dhënien në besim dhe komisionimin (në bazë të numrave serikë të dhënë në Tabelën 2-3)
- ⑨ Tregoni arsyet e mungesës së një mekanizmi të menaxhimit dhe monitorimit (në përputhje me numrat serikë të dhënë në Tabelën 2-3)
- ⑩ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë, dhe bashkëngjitni çdo dokument veç e veç
- Shembuj të materialeve referuese:** hulumtime, materiale dëgjimi publik etj.

“Potential for misallocation or misuse of government support” criterion: Do financial support programmes (including government subsidies) overlap with each other? Are there any risk of budget waste resulting from unclear standards for government support?

① Po ② Jo

A ka mekanizma menaxhimi dhe monitorimi të dizajnuara për të parandaluar shpërdorimet buxhetore?

① Po ② Jo

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 2-4> Detajet e ligjeve dhe rregulloreve të lidhura me përkrahjen financiare

Nr. ^①	Baza ligjore ^②	Lloji i përkrahjes ^③	Përfituesi ^④	Standardet/ Procedura ^⑤	Programe të ngjashme ^⑥	Mekanizmat e Menaxhimit/ Monitorimit (përfshirë sanksionet) ^⑦
1	<ul style="list-style-type: none"> Neni 10 i Ligjit për Promovimin e Punonjësve të Kualifikuar 	<ul style="list-style-type: none"> Grant 	<ul style="list-style-type: none"> Punëtorë të kualifikuar të shkëlqyer të përkrahur nga Dekreti i Presidentit 	<ul style="list-style-type: none"> Përfituesit do të zgjidhen mes punëtorëve të kualifikuar me 7 ose më shumë vite përvojë në fusha prodhimi specifike të përcaktuara nga Ministri i Punësimit dhe Punës. Aplikimi bëhet me rekomandimin e pronarëve të biznesit. Detajet për aplikimin, duke përfshirë procedurën, kriteret e përzgjedhjes dhe numrin e përfituesve përfundimtarë, duhet të njoftohen deri më 30 prill (neni 9 i Dekretit të Zbatimit). Komisioni i Shqyrtimit për Promovimin e Punonjësve të Kualifikuar do t'i zgjedhë përfituesit (neni 22 i Dekretit të Zbatimit) 	<ul style="list-style-type: none"> Përzgjedhja dhe ndarja e çmimeve për punonjësit e shkëlqyer të kualifikuar (Neni 12 i Ligjit të Posaçëm për Mbështetjen e Prodhuesve të Vegjël Urbanë) 	<ul style="list-style-type: none"> Kushdo që ka marrë ose synon të marrë përkrahje financiare duke përdorur metoda mashtruese ose të padrejta, mund të kufizohet nga marrja e ndihmës ose të jetë subjekt i shpengimit (Neni 19 i Ligjit)

<Komente shtesë> Veçantia e përkrahjes financiare ose arsyetimi i rregullave të paqarta mbi përkrahjen financiare^⑥

Nr.	Veçantia e përkrahjes financiare ose arsyetimi i rregullave të paqarta mbi përkrahjen financiare
1	▫ Considering the diversity of fields subject to financial support (96 fields) and the disparity of technological levels and deliberation standards between different fields, it is somewhat inevitable that recipients be selected by means of public notice (fairness shall be ensured by establishing the Deliberation Commission for Promoting Skilled Workers)

<Komente shtesë> Arsyetimi i mungesës së mekanizmave të menaxhimit dhe monitorimit^⑥

Nr.	Arsyetimi i mungesës së mekanizmave të menaxhimit dhe monitorimit

<Materiale referuese>^⑩

Nr.	Detajet e materialeve referuese
1	▫ Rregulloret për përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar të shkëlqyer dhe dhënia e trajtimit preferencial (aktet nënligjore të Shërbimit Korean për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore)

Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë përkrahjen financiare, duke përdorur numrat serikë

- ① Vendosni nenet e aktit që përcaktojnë përkrahjen financiare
- ② Tregoni llojet e përkrahjes financiare në detaje
- ③ **Shembuj të përkrahjes financiare:** subvencioni, granti, kontributi, shfrytëzimi i pronës shtetërore dhe publike, huaja, zvogëlimi dhe përjashtimi i rentave ose tarifave të kredisë etj.
- Tregoni përfituesin e ndihmës financiare siç parashihet me projektligje, ligje dhe rregullore
- ④ Tregoni standardet dhe procedurat për sigurimin e përkrahjes financiare (Nëse detajet e standardeve dhe procedurave janë paraqitur në një shtojcë shtesë ose në statutet e varura, ju lutemi t'i përmbliidhni dhe bashkëngjitni dokumentet veç e veç)
- ⑤ Përkrahësi nenet e akteve të tjera që ofrojnë përkrahje të ngjashme financiare për përfituesit
- ⑥ Përkrahësi në detaje përmbajtjen e mekanizmit të dizajnuar për të parandaluar çdo përkrahje financiare të paligjshme ose të padrejtë
- ⑦ (duke përfshirë nenet përkatëse të aktit)
- Përkrahësi veçantinë e përkrahjes financiare (në krahasim me programet e ngjashme të përkrahjes) ose arsyet për rregullat e paqarta
- ⑧ mbi përkrahjen financiare (sipas numrave serikë të dhënë në Tabelën 2-4), kur shihet e nevojshme
- Tregoni arsyet për mungesën e një mekanizmi të menaxhimit dhe monitorimit (sipas numrave serikë të dhënë në Tabelën 2-4)
- ⑨ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë, dhe bashkëngjitni çdo dokument veç e veç
- ⑩ **Shembuj të materialeve referuese:** statute të varura që përcaktojnë në detaje standardet e përkrahjes financiare, etj.

Fusha e vlerësimit: Procedurat administrative

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Figura 3-1> Rrjedha e punës e financimit të projekteve të TIK-ut^①



<Tabela 3-2> Detajet e ligjeve dhe rregulloreve të lidhura me mbledhjen e opinionëve dhe

Nr. ^②	Baza ligjore ^③	Detajet e Mekanizmit Pjesëmarrës ^④
1	▫ Neni 14 i Ligjit për Planifikimin dhe Përdorimin e Territorit Kombëtar	▫ Mbajtja e dëgjimit publik dhe mbledhja e opinionëve nga banorët dhe ekspertët gjatë formulimit ose rishikimit të një plani metropolitan
2	▫ Neni 26 i Ligjit për Planifikimin dhe Përdorimin e Territorit Kombëtar	▫ Lejimi i banorëve (duke përfshirë palët e interesit) që të hartojnë plane të menaxhimit të zonave urbane dhe të qarkut

<Komente shtesë> Arsyetimi për mungesën e mekanizmave pjesëmarrës⁵

Nr.	Arsyetimi për mungesën e mekanizmave pjesëmarrës

<Materiale referuese>⁶

Nr.	Detajet e materialeve referuese

① Ilustroni një rrjedhë pune të procesit administrativ që mund të kuptohet lehtë nga ana e kërkuarëve civilë

Shënim

Ju lutemi gjithashtu, të deklaroni bazën ligjore për secilën detyrë të përshkruar në rrjedhën e punës. Baza ligjore duhet të përfshijë projektligjet, ligjet dhe rregulloret përkatëse, si dhe ligjet dhe rregulloret përkatëse (p.sh. statutet eprore/të varura, rregullat administrative, rregulloret komunale, etj.).

② Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë mundësitë e pjesëmarrjes qytetare, duke përdorur numrat serikë

③ Tregoni nenet e aktit që përcaktojnë mundësitë e pjesëmarrjes qytetare

④ Përshkruani përmbajtjen e mekanizmave pjesëmarrës që u mundësojnë palëve të interesit (p.sh. qytetarëve, kompanive, organizatave etj.) që të shprehin opinionet e tyre

Shembuj të mekanizmave pjesëmarrës: dëgjime publike, grumbullimi i opinionëve të banorëve, parashtrimi e opinionëve etj.

⑤ Tregoni arsyet për mungesën e mekanizmave pjesëmarrës

⑥ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë dhe bashkëngjisni çdo dokument veç e veç

Shembuj të materialeve referuese: statute të varura që përcaktojnë metodat e pjesëmarrjes, dokumentet hulumtuese, materialet e dëgjimit publik etj.

Checklist for evaluating the “adequacy of disciplinary regulations” criterion

Ⓐ Kur Ligji i Procedurave Administrative ofron tashmë mundësi të mjaftueshme për pjesëmarrje

Shënim

Në raste të tilla, ju lutemi shpjegoni si mund të sigurojnë mundësitë e pjesëmarrjes të parashikuara në Ligj transparencë të mjaftueshme procedurale.

Ⓑ Kur pjesëmarrja qytetare duhet të minimizohet për të parandaluar ndikimet e mundshme negative, si rrjedhja e informacionit

Shënim

Në raste të tilla, ju lutemi shpjegoni rreziqet e zgjerimit të pjesëmarrjes qytetare dhe ndikimet e saj të mundshme.

Ⓒ Kur nevojiten vendime të shpejta dhe veprime të menjëhershme

Shënim

Në raste të tilla, ju lutemi shpjegoni pse janë të nevojshme vendimmarrja e shpejtë dhe ndërmarrja e veprimeve të menjëhershme, dhe si mund të ngadalësojë procesin administrativ pjesëmarrja qytetare.

Ⓓ Kur pjesëmarrja e zgjeruar qytetare pritet të dëmtojë profesionalizmin dhe efikasitetin e procedurave administrative

Shënim

Në raste të tilla, ju lutemi shpjegoni si mund ta dëmtojë efikasitetin e procedurave administrative pjesëmarrja qytetare.

Kriteri i "hapjes": A janë shpalosur mjaftueshëm informacionet e lidhura me procesin administrativ (p.sh. përmbajtja, procedura e trajtimit, etj.) për palët e interesit dhe publikun?

① Po ② Jo

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 3-3> Mekanizmat e shpalosjes së informacionit

Nr. ^①	Baza ligjore ^②	Detajet e shpalosjes së informacionit ^③
1	▫ Neni 4-3, paragrafi 5 i Ligjit për Zyrtarët e Arsimit Publik	▫ Shpalosja paraprake e informacionit të lidhur me rekrutimin e personelit universitar (duke përfshirë pozitat e punës, numrin e vendeve të punës, kualifikimet për aplikim dhe kriteret e vlerësimit)
2	▫ Neni 14 i Rregullores së Zbatimit të Ligjit për Rrugë	▫ Shpallja publike e llojeve të rrugëve, numri dhe emri i një rruge, seksioni, data e hapjes ose data e mbylljes kur përdoret ose shfuqizohet zona e pjesshme ose e tërë e rrugës
3	▫ Neni 9-2 i Ligjit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë ▫ Neni 8-4 i Dekretit për Zbatimin e Ligjit	▫ Njoftimi publik i të dhënave relevante, duke përfshirë numrin e aksidenteve industriale në vendet e punës, shkallën e aksidenteve, renditjen

<Komente shtesë> Arsyetimi për mungesën e mekanizmave të shpalosjes së informacionit^④

Nr.	Arsyetimi për mungesën e mekanizmave të shpalosjes së informacionit

<Materiale referuese>^⑤

Nr.	Details of Reference Materials

① Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë shpalosjen e informacionit dhe ndarjen e detyrueshme të informacionit me palët e interesit, duke përdorur numrat serikë

② Tregoni nenet e aktit që përcaktojnë shpalosjen e informacionit

③ Përshkruani në detaje përmbajtjen e informacionit të shpalosur, periudhën dhe metodat e shpalosjes së informacionit

④ Tregoni sfondin dhe arsyetimin për mos shpalosjen e informacionit

⑤ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë, dhe bashkëngjitni çdo dokument veç e veç

Shembuj të materialeve referuese: statute të varura që përcaktojnë shpalosjen e informacionit në detaje, dokumente hulumtuese, materiale të dëgjimit publik etj.

Kriteri i “qartësisë në ofrimin e shërbimeve publike dhe në procesin administrativ”: A munden qytetarët t’i kuptojnë qartë dhe t’i parashikojnë procedurat administrative, siç janë dokumentet e kërkuara, procedurat administrative, periudhat e trajtimit dhe rezultatet?

① Po ② Jo

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 3-4> Qartësia e procedurave administrative

Kategoria	Baza ligjore	Detajet e procesit administrativ
Materialet përgatitore ^①	▫ Neni 9 i Rregullores mbi Sigurinë e Barnave, etj.	▫ Materialet në lidhje me detajet e origjinës, zbulimit ose zhvillimit të produktit, strukturës kimike, vetive kimike, toksicitetit dhe sigurisë
Procedurat ^②	▫ Nuk është përcaktuar	
Rezultatet ^③	▫ Nuk është përcaktuar	
Periudha ^④	▫ Nuk është përcaktuar	

<Komente shtesë> Arsyetimi për qartësinë e ulët të procesit administrativ^⑤

Nr.	Arsyetimi për qartësinë e ulët të procesit administrativ
1	▫ Përcaktimi nëse një bar specifik është i sigurt dhe efektiv kërkon një nivel të lartë të ekspertizës dhe një proces verifikimi shkencor. Prandaj, është e vështirë të parashikohet periudha e vlerësimit dhe kur do të prodhohen rezultatet

<Materiale referuese>^⑥

Nr.	Details of Reference Materials
1	▫ Standardi për testimin e toksicitetit të barnave (Ministria e Ushqimit dhe Sigurisë së Barnave, njoftimi Nr. 2014-136)
2	▫ Standardi për testimin e sigurisë së barnave (Ministria e Ushqimit dhe Sigurisë së Barnave, Njoftimi Nr. 2014-59)
3	▫ Rregulloret për miratimin dhe shqyrtimin e produkteve biologjike (Ministria e Ushqimit dhe Sigurisë së Barnave, Njoftimi Nr. 2015-41)

- ① Përshkruani materialet që u kërkojnë qytetarëve për të marrë shërbime publike ose për të parashtruar ankesa (duke përfshirë nenet përkatëse të aktit)
 - ② Përshkruani procedurat administrative të parashikuara në dispozitat e miratuara ose të rishikuara (duke përfshirë nenet përkatëse të aktit)
 - ③ Përshkruani si mund të kenë qasje qytetarët në trajtimin e rezultateve (duke përfshirë nenet përkatëse të aktit)
 - ④ Përshkruani periudhën e trajtimit të procesit administrativ (duke përfshirë nenet përkatëse të aktit)
 - ⑤ Tregoni arsyetimin për qartësinë e ulët të procesit administrativ
 - ⑥ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë dhe bashkëngjisni çdo dokument veç e veç
- Shembuj të materialeve referuese:** statute të varura që përcaktojnë procedurën dhe periudhën për trajtimin e çështjeve administrative, si dhe dokumentet e lidhura me hulumtimin etj.

Fusha e vlerësimit: Kontrolli i korrupsionit

Kriteri i “Rrezikut të konfliktit të interesit”: A ka standarde, procedura apo mekanizma për të parandaluar interesat private që ndërhyjnë në proceset administrative?

① Po ② Jo

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 4-1> Mekanizmat për parandalimin e konfliktit të interesit

Nr. ^①	Baza ligjore ^②	Detajet e mekanizmave ^③
1	▫ Neni 41 dhe 41-2 i Ligjit të Promovimit të Shpikjeve	▫ Rregulloret mbi kualifikimet dhe qëndrimin në detyrë të anëtarëve civilë të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve të Pronësisë Industriale, si dhe mekanizmat e përjashtimit automatik, kërkesës/peticionit për përjashtim, dhe vetë-përjashtimit (abstenimi vullnetar) në lidhje me anëtarët e komisionit
2	▫ Neni 20 dhe 22 i Dekretit për Zbatimin e Ligjit për Promovimin e Teknologjisë Ndërtimore	▫ Rregulloret për mekanizmat e përjashtimit automatik, kërkesës/peticionit për përjashtimin, vetë-përjashtimit (abstenimi vullnetar) dhe shkarkimit në lidhje me anëtarët e komisionit
3	▫ Neni 17-2, 17-3 dhe 43 i Ligjit të Promovimit të Industrisë së Lojërave	▫ Rregulloret për mekanizmat e përjashtimit automatik, kërkesës/peticionit për përjashtim, vetë-përjashtimit (abstenimi vullnetar) në lidhje me anëtarët e komisionit, shpалosja e procesverbalit të mbledhjeve, funksioni juridik si zyrtar publik në zbatimin e dispozitave penale
4	▫ Neni 24 i Ligjit të Sigurimit të Kompensimit të Aksidenteve Industriale	▫ Rregulloret për mekanizmat e përjashtimit automatik, kërkesës/peticionit për përjashtim dhe vetë-përjashtimit (abstenimi vullnetar) në lidhje me anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Sigurimit të Kompensimit të Aksidenteve Industriale

<Komente shtesë> Arsyetimi për mungesën e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit^④

Nr.	Arsyetimi për mungesën e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit

<Materiale referuese>^⑤

Nr.	Detajet e materialeve referuese

① Listoni dispozitat e miratuara ose të rishikuara që përcaktojnë mekanizmat për parandalimin e konfliktit të interesit, duke përdorur numrat serikë

② Vendosni nenet e aktit që përcaktojnë mekanizmat për parandalimin e situatave të konfliktit të interesit

③ Përshkruani në detaje llojet dhe përmbajtjen e mekanizmave të dizajnuara për të parandaluar konfliktin e interesit
Shembuj të mekanizmave: rregullore (p.sh. kualifikimi i anëtarëve, mandati dhe riemërimi i anëtarëve, etj.), mekanizma të caktuara (p.sh. mekanizmat që sigurojnë përjashtimin automatik, kërkesën/peticionin për përjashtim, vetë-përjashtimin (abstenimi vullnetar) të zyrtarit publik, dhe rregulloret që ndalojnë punësimin në të njëjtën kohë të zyrtarëve qeveritarë dhe realizimin e fitimeve, etj.

④ Tregoni arsyet për mungesën e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit

⑤ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë, dhe bashkëngjitni çdo dokument veç e veç

Kriteri i “nevojës për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit”: A është e domosdoshme të vendosen ose të rriten mekanizmat e kontrollit të korrupsionit për të parandaluar korrupsionin që mund të lindë gjatë zbatimit të ligjeve apo politikave

① Po ② Jo

Shablloni i vlerësimit me shembuj

<Tabela 4-2> Rastet e korrupsionit dhe mekanizmat e kontrollit të korrupsionit

Nr. ^①	Rastet e korrupsionit ^②	Rregulloret e lidhura ^③	Mekanizmat për Kontrollin e Korrupsionit ^④
	▫ Zbulimi i një raporti vlerësimi të rremë për lëshimin e një kredie shumë të madhe, e cila u dha në këmbim të një ryshfeti	▫ Neni 68 i Ligjit për Blerjen e Tokës, etj. Për Punë Publike dhe Kompensimin	▫ Do të caktohen tre vlerësues për vlerësimin e kompensimit për tokat, etj.
	▫ Rastet e korrupsionit të tilla si vlerësimi i tepruar i kostos dhe nënshkrimi i kontratave të dyfishta me një nënkontraktor, gjatë procesit të realizimit të një kontrate me rimbursim kostosh të kryer në kuadër të projektit të prokurimit të mbrojtjes	▫ Neni 28 i Rregullores për Vlerësimin e Kostove të Prokurimit të Mbrojtjes	▫ Ligji për Sistemin e Menaxhimit të Kostove së Programit për Mbrojtjen e Drejtë është duke u miratuar për të parandaluar ndodhjen e ardhshme të korrupsionit

<Komente shtesë> Arsyetimi për mungesën e mekanizmave të kontrollit të korrupsionit^⑤

Nr.	Arsyetimi për mungesën e mekanizmave të kontrollit të korrupsionit

<Materiale referuese>^⑥

Nr.	Detajet e materialeve referuese

① Listoni çdo dispozitë të miratuar ose të rishikuar që përcakton mekanizmat e kontrollit të korrupsionit (duke përfshirë dispozitat ku kanë ndodhur rastet relevante të korrupsionit)

② Përkthyeri shkurtimisht rastet e korrupsionit të rëndësishme për miratimin e dispozitave të rishikuara

Shënim

Ju lutemi, përfshini edhe rastet e korrupsionit të raportuara dhe të trajtuara, hetimet e një auditimi të brendshëm ose BAI-t, vëzhgimet e Asamblesë Kombëtare dhe njoftimet përkatëse për shtyp, kur përkthyeri rastet e korrupsionit.

③ Tregoni nenet e aktit që janë relevante për rastet e korrupsionit të deklaruara në seksionin e rasteve të korrupsionit

④ Përkthyeri mekanizmat e kontrollit të korrupsionit për të parandaluar rreziqet potenciale të korrupsionit që mund të ndodhin për shkak të miratimit ose ndryshimit të dispozitave

Shembuj të mekanizmave të kontrollit të korrupsionit: Kryerja e hetimeve të përbashkëta (të përbërë nga më shumë se dy persona) për udhëzim, goditje dhe inspektim; që veprojnë me një sistem pjesëmarrjeje civile (anëtarë civilë, këshill, etj.); duke shfrytëzuar komisionet për vlerësim; procesi i vlerësimit dhe shqyrtimit; dhe përmirësimi i një sistemi të verifikimit të mallrave për të parandaluar çdo mashtrim të lidhur me furnizimin e mallrave etj.

Shënim

Even if there are no relevant corruption cases, any mechanisms designed to prevent potential corruption cases shall be described.

- ⑤ Tregoni arsyet për mungesën e mekanizmave të kontrollit të korrupsionit
- ⑥ Listoni çdo material shtesë që mund të shërbejë si referencë dhe bashkëngjisni çdo dokument veç e veç

Shembuj të arsyeve për mungesën e mekanizmave të kontrollit të korrupsionit

- ① Kur projektligjet, ligjet dhe rregulloret që i nënshtrohen VRRK-së nuk përmbajnë faktorë që shkaktojnë korrupsion (p.sh. dhënia e trajtimit preferencial, rregulla të paqarta etj.)
- ② Kur faktorët që shkaktojnë korrupsion në kuadër të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve që i nënshtrohen VRRK-së nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me shfaqjen e korrupsionit
 - Shënim** Në raste të tilla, ju lutemi shpjegoni arsyetimin e argumentit të mësipërm dhe ofroni materiale dëshmuese.
- ③ Kur konsiderohet se ndodhja e korrupsionit është më e rëndësishme për etikën dhe praktikën e personit përgjegjës, në vend të mungesës së ligjeve ose mungesës së mekanizmave të kontrollit të korrupsionit
 - Shënim** Në raste të tilla, ju lutemi shpjegoni arsyetimin e argumentit të mësipërm dhe ofroni materiale dëshmuese.
- ④ Kur institucioni në fjalë planifikon të specifikojë mekanizmat e kontrollit të korrupsionit duke i përcaktuar në statutet e varura ose rregullat administrative për të hequr faktorët që shkaktojnë korrupsionin në kuadër të projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve që i nënshtrohen VRRK-së
 - Shënim** Në raste të tilla, ju lutemi shënoni përmbajtjen kyçe të statuteve të varura të hartuara ose rregullave administrative dhe bashkëngjitni dokumentin veçmas.

Shtojca 2. Materialet për vlerësimin bazë të VRRK-së për rregullore komunale

※ Numri i referencës	Aplikimi bazë për Vlerësimin e Ndikimit të Korrupsionit			
Titulli i Rregullores Komunale				
Lloji	Urdhëresë	Rregull	Rregull arsimor	
Kategoria	Hyrje në fuqi	Plotësim-ndryshim	Rregullore aktuale	
Titujt e ligjeve relevante	(titujt e ligjeve të delegimit, ligjet e zbatimit të ligjit të subjektit të vlerësimit, etj.)			
Qeverisja lokale	Divizioni hartues	Divizioni (Seksioni ose Ekipi)		
		Personi i ngarkuar: Rangu / Emri / Numri i telefonit		
Periudha kohore legjislative (e planifikuar)	Konsultimi me agjenci relevante	Homologu (Divizioni)		
		Periudha	Nga deri (ditë)	
	Para-shpallja	Nga deri (ditë)		
Mbledhja e opinioneve	1. A janë shqyrtuar materialet e subjektit nga një divizion i çështjeve ligjore ose një divizion i auditimit 2. A është mbajtur një dëgjësë ose seminar publik, etj.			
Bashkëngjitur	1. propozimi legjislativ (duke përfshirë tabelën e krahasimit para dhe pas dispozitave) 2. Shpjegimi i hyrjes në fuqi ose plotësim/ndryshimit të rregulloreve ※ Nëse bëhet kërkesë që vlerësimin ta bëjë ACRC-ja, arsyeja për këtë kërkesë duhet të jetë e bashkëngjitur			
Hartues	Divizioni	Rangu	Emri	Numri i telefonit

※ Numri i referencës vendoset nga divizioni i vlerësimit

Shtojca 3. Materialet për vlerësimin e detajuar të VRRK-së për rregullore komunale

Titulli i ligjit

Dispozita subjekt i vlerësimit

--

Kriteret

Statusi aktual

Problemet

Rezultati

Shtojca 4. Shabllonet për njoftimin e rezultateve për rregulloret komunale

Titulli i ligjit			
Vlerësues	(Divizioni)	(Rangu)	(Emri)
Divizioni hartues		Data e njoftimit	
Dispozita relevante	Rezultati i vlerësimit	Masat që duhen marrë	
<ul style="list-style-type: none"> ▫ Nëse rezultati i vlerësimit sugjeron se ka hapësirë për përmirësim, duhet të shpjegohet dispozita në fjalë 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Shpjegohen shkurtimisht problemet dhe masat për përmirësim 	<p>(Shembull 1) Divizioni vlerësimit e plotëson-ndryshon në mënyrë direkte dispozitën në fjalë</p> <p>(Shembull 2) Divizioni vlerësimit njofton divizionin e hartimit për rezultatet dhe kërkon plotësim/ndryshimin</p>	

Shtojca 5. Materialet për vlerësimin bazë të VRRK-së për rregullat dhe aktet nënligjore

※ Numri i referencës			
Titulli i Rregullores Komunale			
Lloji	Urdhëresë	Rregull	Rregull arsimor
Kategoria	Hyrje në fuqi	Plotësim-ndryshim	Rregullore aktuale
Titujt e ligjeve relevante	(titujt e ligjeve të delegimit, ligjet e zbatimit të ligjit të subjektit të vlerësimit, etj.)		
Qeverisja lokale	Divizioni hartues	Divizioni (Seksioni ose Ekipi)	
		Personi i ngarkuar: Rangu / Emri / Numri i telefonit	
Periodha kohore legjislative (e planifikuar)	Konsultimi me agjenci relevante	Homologu (Divizioni)	
		Periodha	Nga deri (ditë)
	Para-shpallja	Nga deri (ditë)	
Mbledhja e opinioneve	<ol style="list-style-type: none"> 1. A janë shqyrtuar materialet e subjektit nga një divizion i çështjeve ligjore ose një divizion i auditimit 2. A është mbajtur një dëgjese ose seminar publik, etj. 		
Bashkëngjitur	<ol style="list-style-type: none"> 1. propozimi legjislativ (duke përfshirë tabelën e krahasimit para dhe pas dispozitave) 2. Shpjegimi i hyrjes në fuqi ose plotësim/ndryshimit të rregulloreve <p>※ Nëse bëhet kërkesë që vlerësimin ta bëjë ACRC-ja, arsyeja për këtë kërkesë duhet të jetë e bashkëngjitur</p>		

Hartues	Divizioni	Rangu	Emri	Numri i telefonit

※ Numri i referencës vendoset nga divizioni i vlerësimit

Shtojca 6. Materialet për vlerësimin e detajuar të VRRK-së për rregullat dhe aktet nënligjore

Titulli i ligjit

Dispozita subjekt i vlerësimit

--

Kriteret

Statusi aktual

Problemet

Rezultati

Shtojca 7. Shabllonet për njoftimin e rezultateve për rregullat dhe aktet nënligjore

Titulli i ligjit			
Vlerësues	(Divizioni)	(Rangu)	(Emri)
Divizioni hartues		Data e njoftimit	
Dispozita relevante	Rezultati i vlerësimit	Masat që duhen marrë	
<ul style="list-style-type: none"> ▫ Nëse rezultati i vlerësimit sugjeron se ka hapësirë për përmirësim, duhet të shpjegohet dispozita në fjalë 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ Shpjegohen shkurtimisht problemet dhe masat për përmirësim 	<p>(Shembull 1) Divizioni vlerësimit e plotëson-ndryshon në mënyrë direkte dispozitën në fjalë</p> <p>(Shembull 2) Divizioni vlerësimit njofton divizionin e hartimit për rezultatet dhe kërkon plotësim/ndryshimin</p>	

Shtojca 8. Kërkesa për këshillim për VRRK-në

Numri serik	Kërkesa për Këshillim për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit
-------------	---

Marrësi: Organizata

Emri i këshilltarit

Komisioni për Anti-Korrupsion dhe të Drejta Civile me këtë rast kërkon këshilla nga personi i mësipërm për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit në pajtim me Nenin 31 të Dekretit për Zbatimin e Ligjit Kundër Korrupsionit dhe Themelimin dhe Menaxhimin e Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile dhe Nenin 23 të Udhëzimeve Operacionale për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit.

Data:

Emri i kërkuarit: O O O i Divizionit të Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit

ACRC (Telefon/Faks: _____)

E-mail:

Objekti i vlerësimit	Titulli i legjislacionit								
	Kategoria	Miratimi			Plotësim-ndryshimi		Ligjet dhe rregulloret aktuale		
	Lloji	Akt ligjor	Dekret i Presidentit	Dekret i Kryeministrit	Urdhëresë e Ministrisë	Rregull administrativ (përfshirë aktet nënligjore, statutet)	Urdhëresë	Rregullore	
	Nr. ref.								
Arsyetime i kërkesës për këshillim									
Këshilla e kërkuar	- të shqyrtohen opinionet për draftin ligjor sipas kritereve të vlerësimit								
Shtojcat	1. Materialet e vlerësimit bazë të dorëzuara nga agjencia përkatëse 2. Raporti paraprak i vlerësimit i përgatitur nga personeli i divizionit të VRRK-së 3. Kopja e projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve përkatëse								
Vërejtje	Ju lutemi përgjigjuni kërkesës për këshillim (data/muaji/viti).								

Shtojca 9. Udhëzimet Operative për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit

Udhëzimet Operative për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit

Kapitulli 1 Dispozita të përgjithshme

Neni 1 (Qëllimi)

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kërkesat e nevojshme për të siguruar efikasitetin në Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit sipas Nenet 28 të Ligjit për kundër-Korrupsion dhe Themelimin dhe Funkcionimin e Komisionit Kundër Korrupsionit dhe për të Drejtat Civile dhe nenet 30 deri 32 të Dekretit të Zbatimit të të njëjtit akt.

Neni 2 (Përkufizimi)

Vlerësimi i Rrezikut të Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm "vlerësimi") në këtë rregullore i referohet analizës dhe shqyrtimit të faktorëve që shkaktojnë korrupsion në objektet e vlerësimit (në tekstin e mëtejshëm "objektet e vlerësimit") të përcaktuara në nenin 3, dhe paraqitjes se secilit prej opinioneve të mëposhtme:

1. Miratimi i projektligjit origjinal: Konstaton se nuk ekziston asnjë faktor që shkakton korrupsion në objektet e vlerësimit të përcaktuara në nenin 3 dhe rrjedhimisht pranon objektet e vlerësimit ashtu siç janë
2. Miratimi i pjesshëm: Rekomandon veprime të tilla si rishikimi, plotësimi ose fshirja e dispozitave tërësore ose të pjesshme të objekteve të vlerësimit, për të hequr ose korrigjuar faktorët që shkaktojnë korrupsion dhe që ekzistojnë në objektet e vlerësimit
3. Tërheqja: Propozon tërheqjen e objekteve të vlerësimit nëse faktorët që shkaktojnë korrupsion janë kaq të përhapur sa që përmirësimi i objekteve të vlerësimit nuk konsiderohet i mundshëm

Neni 3 (Objektet e vlerësimit)

Një vlerësim kryhet për secilën prej projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve në vijim:

1. Miratimi ose ndryshimi i akteve, dekretive presidenciale, dekretive të kryeministrit dhe urdhëresave ministrore (në tekstin e mëtejshëm "projektligjet e miratuara/ndryshuara");
2. Aktet, dekretet presidenciale, dekretet e kryeministrit dhe urdhëresat ministrore, si dhe direktivat, rregulloret, lajmërimet dhe njoftimet (përfshirë miratimin ose ndryshimin e direktivave, rregulloreve, lajmërimeve dhe njoftimeve) të deleguara prej tyre; dhe urdhëresat dhe rregullat (në tekstin e mëtejshëm "akte ligjore dhe statute të varura");
3. Miratimi ose ndryshimi i urdhëresave dhe rregullave për të cilat kryetari i qeverisjes lokale ka kërkuar vlerësim (në tekstin e mëtejshëm: "rregulloret komunale të miratuara/ndryshuara"); dhe
4. Rregulloret e brendshme të organizatave të shërbimeve publike, siç janë rregulloret dhe aktet e themelimit (duke përfshirë ato që duhet të miratohen ose ndryshohen), për të cilat kreu i organizatës ka kërkuar vlerësim (në tekstin e mëtejshëm "rregulla të brendshme/aktet nënligjore të organizatave shërbimit publik")

Neni 4 (Kriteret e Vlerësimit)

Nëse bëhet një vlerësim për objektet e vlerësimit, vendimet do të merren sipas kriterëve të bashkangjitura (në tekstin e mëtejshëm "kriteret e vlerësimit").

Kapitulli 2 Procedurat për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit

Seksioni 1. Kryerja e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit për Projektligjet e Miratuara/të Ndryshuara

Neni 5 (Marrja e projektligjeve dhe aplikimeve themelore)

Kur kreu i një agjencie qendrore administrative kërkon një vlerësim të Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (në tekstin e mëtejshëm "ACRC") duke paraqitur projektligjet e miratuara/ndryshuara dhe materialet bazë të vlerësimit bazë së VRRK-së të paraqitura në Shtojcën 1 (në tekstin e mëtejshëm materialet e vlerësimit bazë), ACRC-ja pranon dokumente me shkrim të vlerësimit të agjencisë përkatëse qendrore administrative (në tekstin e mëtejshëm "agjencia përkatëse"). Gjatë miratimit ose rishikimit të të gjitha dispozitave të projektligjeve, ACRC-ja duhet të verifikojë nëse është bashkangjitur edhe materiali i detajuar i VRRK-së i paraqitur në Shtojcën 2 (në tekstin e mëtejshëm "materialet e detajuara të vlerësimit").

Neni 6 (Caktimi i Agjencive të Veçanta për çdo Vlerësues)

1. Për të rritur efektshmërinë dhe profesionalizmin në vlerësim, çdo vlerësues caktohet për agjenci specifike ku ai/ajo merr përgjegjësinë ekskluzive të kryerjes së vlerësimeve.
2. Pas marrjes së një kërkesë vlerësimi me shkrim, zyrtarët përgjegjës për pranimin e dokumenteve të dorëzuara i kalojnë dokumentet tek vlerësuesi i caktuar.
3. Vlerësuesi i cili ka marrë dokumentet mund t'i ofrojë qasje paraprake në dokumente drejtorit të divizionit të VRRK-së.

Neni 7 (Marrja e Materialeve Shtesë dhe Përgatitja e Raportit të Vlerësimit)

1. Kur dorëzohet një kërkesë vlerësimi me shkrim, vlerësuesi shqyrton dokumentet e paraqitura. Nëse mungojnë dokumentet, ose materialet e vlerësimit bazë/të detajuar nuk janë të përshtatshme, vlerësuesi duhet të kërkojë nga agjencia përkatëse që të dorëzojë materialet e munguara ose të plotësojë dokumentet e paraqitura.
2. Vlerësuesi përcakton faktorët që shkaktojnë korrupsion në kuadër të projektligjeve të miratuara/ndryshuara në bazë të propozimit legjislativ dhe materialeve të vlerësimit bazë/të detajuar të dorëzuara nga agjencia përkatëse, duke shfrytëzuar kriteret e vlerësimit. Vlerësuesi pastaj harton një raport vlerësimi bazë, siç përcaktohet në Shtojcën 3. Gjatë ofrimit të rekomandimeve për përmirësim/opinionëve për tërheqje ose kur duhet të shqyrtohen çështje të tjera të rëndësishme, vlerësuesi harton një raport vlerësimi të detajuar, siç përcaktohet në Shtojcën 4.
3. Gjatë kryerjes së një vlerësimi në përputhje me Paragrafin 2, vlerësuesi mund të analizojë dhe të shqyrtojë në mënyrë të plotë faktorët që shkaktojnë korrupsion në: statute eprore; statute të varura siç janë rregullat administrative dhe urdhëresat; dhe ligje të tjera të lidhura ose të ngjashme që janë relevante për objektin e vlerësimit.

Neni 8 (Periudha e vlerësimit)

Vlerësuesi duhet ta përfundojë vlerësimin para ditës së fundit të para-shpalljes së projektligjeve të miratuara/ndryshuara, dhe menjëherë do ta njoftojë agjencinë përkatëse për rezultatet e vlerësimit. Nëse vlerësuesi nuk mund ta përfundojë vlerësimin për shkak të rrethanave të pashmangshme, siç është dorëzimi i vonuar i materialeve të vlerësimit ose vonesat në procesin e konsultimit me agjencitë përkatëse, periudha e vlerësimit mund të zgjatet deri në 40 ditë nga dita e fundit e shpalljes paraprake të legjislatcionit.

Neni 9 (Kërkesa për këshillim dhe konsultim me agjencitë përkatëse, etj.)

1. Vlerësuesi mund të konsultohet me ekspertë në përputhje me nenin 21 të rregullores në secilin nga rastet e mëposhtme:
 - a. Kur kërkohen njohuri dhe përvojë profesionale dhe teknike
 - b. Kur ballafaqohen me konflikte të rënda të interesit, ose kur ACRC-ja dhe agjencia përkatëse kanë opinione kontradiktore
 - c. Kur këshillimi i jashtëm kërkohet për arsye të tjera, për shembull, kur agjencia në fjalë kërkon një rivlerësim
2. Vlerësuesi duhet të konsultohet me agjencinë përkatëse gjatë ofrimit të rekomandimeve për përmirësimin e projektligjeve, ligjeve dhe rregulloreve. Vlerësuesi mundet, nëse është e nevojshme, të konsultohet me agjencitë përkatëse- siç është Ministria e Legjislacionit të Qeverisë (MOLEG)- për zbatimin efektiv të rekomandimeve.
3. Vlerësuesi mund të mbledhë opinionet e palëve të interesit dhe agjencive përkatëse nëse përmbajtja e vlerësimit bie nën ndonjë nga nënparagrafët e mëposhtëm (në tekstin e mëtejshëm "çështjet e rëndësishme"):
 - a. Çështjet që kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e qytetarëve
 - b. Kur ballafaqohen me konflikte të rënda të interesit, ose kur ACRC-ja dhe agjencia përkatëse kanë opinione kontradiktore
 - c. Çështjet që kanë të bëjnë me shumë agjenci administrative qendrore

Neni 10 (Raporti dhe Njoftimi i Rezultatit të Vlerësimit)

1. Para se të njoftojë agjencinë përkatëse për rekomandimin për përmirësimin ose tërheqjen e projektligjit të miratuar/ndryshuar, vlerësuesi merr miratimin nga kryetari i ACRC-së (më tej "kryesuesi"). Për njoftimin e rekomandimeve të thjeshta ose të përsëritura, vlerësuesi merr miratimin sipas nënparagrafëve të mëposhtëm:
 - a. Për çështjet e përgjithshme: Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë kundër Korrupsionit
 - b. Për çështje të vogla: Drejtori i ngarkuar me këtë çështje
2. Kur rezultatet e vlerësimit (p.sh. miratimi ose tërheqja e pjesshme) gjykohen si çështje të rëndësishme, ai mund t'i nënshtrohet shqyrtimit nga ACRC-ja në përputhje me Paragrafin (1). Në këtë rast, çështja do të shqyrtohet nga këshilltarët ligjorë (të cilët janë përgjegjës për realizimin e iniciativave kundër korrupsionit në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të Dekretit të Presidentit për Organizimin e Komisionit Kundër Korrupsionit dhe për të Drejtat Civile dhe Organizatat e Lidhura) para se të prezantohet në ACRC.
3. Gjatë miratimit të projektligjit të miratuar/ndryshuar, vlerësuesi duhet të marrë miratimin nga drejtori përgjegjës për këtë çështje.
4. Vlerësuesi duhet ta njoftojë rezultatin e vlerësimit tek agjencia përkatëse, sapo të jetë miratuar rezultati i vlerësimit.
5. Vlerësuesi e raporton rezultatin e vlerësimit dhe njofton agjencinë përkatëse duke plotësuar shabllonin e njoftimit të rezultateve (të treguar në Shtojcën 5) me Materialin e Vlerësimit të Detajuar të treguar në Shtojcën 4 (përveç marrëveshjes për objektin e vlerësimit origjinal).
6. Nëse rezultatet e vlerësimit janë aprovimi ose tërheqja e pjesshme dhe janë të lidhura ngushtë me analizën e ndikimit rregullator të kryer në përputhje me nenin 7 të Ligjit kornizë për rregulloret administrative, mund të dërgohet në Komisionin e Reformës Rregullatore dhe të përdoret për shqyrtim rregullator.
7. Nëse rezultatet e vlerësimit janë aprovim ose tërheqje e pjesshme dhe mund të shfrytëzohen si referencë për shqyrtimin e legjislacionit dhe ndryshimin/përmirësimin e ligjeve në përputhje me nenet 21 dhe 24 të Rregullit Operacional për Detyrën Ligjore, mund t'i dërgohen MOLEG-ut dhe përdoren për punët legjislative.

Neni 11 (Procesi i rivlerësimit)

1. Nëse agjencia në fjalë kërkon një rivlerësim të rezultatit të vlerësimit, ACRC-ja kryen një rivlerësim, duke marrë parasysh pikat e theksuara në nënparagrafët e mëposhtëm:
 - a. Qëllimi dhe vlefshmëria e kërkesës së një rivlerësimi
 - b. Ndryshimi në rrethana, të tilla si ndryshimet në mjedisin e jashtëm
 - c. Arsytet e tjera të justifikueshme (p.sh. vështirësitë e konsultimit dhe koordinimit me institucionet relevante), të cilat mund të kërkojnë një rivlerësim
2. Gjatë kryerjes së rivlerësimit të projektligjit të miratuar/ndryshuar, ai do të rivlerësohet nga vlerësues të ndryshëm nga vlerësuesi fillestar, dhe do t'i nënshtrohet proceseve të tilla si grumbullimi i opinioneve të ekspertëve ose diskutimet e përbashkëta ndërmjet divizioneve.
3. Nëse një rezultat i rivlerësimit ripohon rezultatin fillestar të vlerësimit, rezultati do t'i njoftohet agjencisë përkatës pas marrjes së miratimit nga kryesuesi.
4. Nëse një rezultat i rivlerësimit ndryshon nga rezultati fillestar i vlerësimit, rezultati do t'i njoftohet agjencisë përkatës pas marrjes së miratimit nga kryesuesi. Nëse rezultati i vlerësimit fillestar është njoftuar pas shqyrtimit nga ACRC-ja, rezultati i rivlerësimit do të shqyrtohet nga këshilltarët ligjorë dhe do të marrë miratimin nga kryesuesi. Pastaj, rezultati i rivlerësimit do të kalojë në shqyrtim përpara se t'i njoftohet agjencisë përkatëse.

Neni 12 (Vlerësimi i Rreziqeve pas Korrigjimit, duke përfshirë Monitorimin dhe Rishikimin e Statusit të Zbatimit etj.)

1. Drejtori i divizionit të VRRK-së do të monitorojë dhe shqyrtojë zbatimin e rekomandimeve të rezultateve të vlerësimit të agjencive përkatëse çdo gjashtë muaj dhe do t'i raportojë kryesuesit.
2. Drejtori i divizionit të VRRK-së mund të kryejë një inspektim në terren për të monitoruar dhe shqyrtuar si zbatohen rekomandimet, kur shihet e nevojshme.
3. Nëse agjencia në fjalë nuk i zbaton rekomandimet brenda periudhës së dhënë pa arsye të justifikueshme, ACRC-ja mund të ndërmarrë veprimet e nevojshme, siç janë raportimi i situatës në mbledhjet e zëvendësministrave ose të kabinetit për të siguruar zbatimin e rekomandimeve.
4. Nëse pranohet se menaxhimi pasues duhet të ndërpritet për shkak të ndryshimeve në rrethana, mund të përfundojë pas marrjes së miratimit nga drejtori i përgjithshëm i Byrosë kundër korrupsionit. Kur ndërpritet menaxhimi pasues i një çështjeje të rëndësishme, kjo duhet t'i nënshtrohet procesit të shqyrtimit nga ACRC-ja.
5. Kryesuesi mund të përcaktojë artikujt që do të merren në konsideratë në menaxhimin vijues të VRRK-së.

Seksioni 2. Kryerja e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit të akteve ligjore dhe statuteve të varura aktuale

Neni 13 (Krijimi dhe Zbatimi i Planit Afatmesëm-Afatgjatë për kryerjen e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit)

1. ACRC-ja mund të krijojë dhe zbatojë plane afatmesme dhe afatgjata për kryerjen e VRRK-së për aktet aktuale, dekretet presidenciale, dekretet e kryeministrit dhe urdhëresat ministrorë; dhe direktivat, rregulloret, lajmërimet dhe njoftimet e deleguara prej tyre; dhe rregullat dhe rregulloret (në tekstin e mëtejshëm "aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale").
2. Me qëllim të vendosjes së planeve të vlerësimit afatmesëm dhe afatgjatë, drejtori i divizionit të VRRK-së mund të kërkojë nga agjencitë administrative qendrore dhe qeveritë lokale të paraqesin objektet e vlerësimit në lidhje me aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale.
3. Drejtori i Divizionit të VRRK-së merr dhe administron objektet e vlerësimit të paraqitura nga agjencitë administrative qendrore dhe qeveritë lokale.
4. ACRC-ja konsultohet me agjencitë përkatëse në bazë të objekteve të vlerësimit të paraqitura nga secila agjenci dhe përcakton planet e vlerësimit afatmesëm dhe afatgjatë.
5. ACRC-ja konfirmon planet e vlerësimit afatmesëm dhe afatgjatë, pas procesit të shqyrtimit, dhe pastaj njofton agjencitë përkatëse për këto plane. Sipas kalendarit të vlerësimit, ACRC-ja merr nga agjencitë përkatëse materialet e vlerësimit bazë dhe të detajuar në lidhje me aktet ligjore dhe statutet e varura të cilat i nënshtrohen vlerësimit, dhe bën një vlerësim.

Neni 13.2 (Vlerësimi i Rrezikut të Korrupsionit i kryer për Çështjet e Spikatura)

Përveç kryerjes së vlerësimeve bazuar në planet afatmesme dhe afatgjata, ACRC-ja mund të kryejë VRRK-në për aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale kur bien nën ndonjë nga nënparagrafët e mëposhtëm:

1. Kur korrupsioni ose parregullsi të tjera janë njohur si çështje sociale, ose pritet të rritin shqetësimet sociale
2. Kur konsiderohet e nevojshme të kryhet VRRK-ja në fushat strukturore të prirura për korrupsion
3. Kur politika relevante për ligjin në fjalë zbatohet si një politikë kombëtare ose kur shpenzimet e saj buxhetore rriten, duke kërkuar largim urgjent ose reduktimin e faktorëve që shkaktojnë korrupsionin
4. Kur VRRK-ja kryhet për ligje të miratuara/ndryshuara, zbulon faktorët që shkaktojnë korrupsion në ligjet aktuale që lidhen me projektligjet.

Neni 14 (Pranimi i Materialeve të Vlerësimit Bazës/të Detajuar dhe Hartimi i Raporteve të Vlerësimit, etj.)

Nenet 5, 7 dhe 9 të rregullores do të zbatohen gjatë pranimit të materialeve të vlerësimit bazë dhe të detajuar, materialeve plotësuese të vlerësimit, hartimit e raporteve të vlerësimit, dhe gjatë kërkimit të këshillave të jashtme për të kryer VRRK-në për aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale.

Neni 15 (Kërkesa për Materiale Mbështetëse dhe Hululum të Fakteve, etj.)

1. Vlerësuesi mund të kërkojë që organizatat publike përkatëse të paraqesin materialet dhe dokumentet përkatëse (p.sh. udhëzimet teknike, rezultatet e veprimeve disiplinore/auditimet/hetimet dhe statusin e trajtimit të ankesave) kur konsiderohet e nevojshme për kryerjen e VRRK-së në përputhje me nenin 30 Paragrafi (3) i Dekretit për Zbatimin e Ligjit Kundër Korrupsionit dhe Themelimin dhe Menaxhimin e Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (në tekstin e mëtejshëm: Dekreti për Zbatimin).
2. Vlerësuesi mund të bëjë një shqyrtim paraprak, siç është shqyrtimi letrar, për të shqyrtuar materialet dhe dokumentet relevante (p.sh. rezultatet e veprimeve disiplinore/auditimet/hetimet dhe statusin e trajtimit të ankesave), dhe viziton organizatat publike përkatëse për të kryer një hetim në terren. Vlerësuesi mund të kërkojë gjithashtu pjesëmarrjen e palëve të interesit, dëshmitarëve ose zyrtarëve publikë të lidhur, si dhe mund të kërkojë deklarinë e opinioneve të tyre, nëse vlerësohet e nevojshme për kryerjen e një vlerësimi.

Neni 16 (Konsultimi me agjencitë përkatëse dhe mbledhja e opinioneve)

Vlerësuesi harton rekomandime të bazuara në një analizë të statusit aktual të zbatimit të legjislationit, si dhe në rezultatet e vlerësimit të nxjerra nga kriteret e vlerësimit, dhe konsultohet me agjencinë në fjalë në lidhje me rekomandimet. Për adresimin e çështjeve të rëndësishme, mund të organizohen dëgjime publike dhe diskutime për të mbledhur opinione nga agjencitë dhe organizatat përkatëse, palët e interesit dhe ekspertë të tjerë.

Neni 17 (Raportimi i Rekomandimeve të VRRK-së dhe Shqyrtimet)

1. Nëse një rekomandim ka të bëjë me çështje të rëndësishme, vlerësuesi mund të bëjë një raport të përkohshëm për kryesuesin para se të angazhohet në konsultime me agjencinë përkatëse.
2. Pas konsultimit me agjencinë përkatëse, vlerësuesi përgatit një rekomandim që përfshin rezultatet e konsultimit, dhe ia dorëzon dokumentin këshilltarëve ligjorë për shqyrtim. Pastaj, rekomandimi i raportohet kryesuesit dhe i nënshtrohet shqyrtimit nga ACRC-ja. Kur jep rekomandime për aktet ligjore dhe statutet e varura aktuale, së bashku me ligjet e miratuara/ndryshuara në pajtim me nenin 13.2 nënparagrafin 4 të rregullores, zbatohet neni 10 i rregullores së njëjtë.

Neni 18 (Njoftimi i Rekomandimit dhe Kryerja e Rivlerësimit, etj.)

1. Vlerësuesi duhet të raportojë tek kryesuesi për rekomandimet e miratuara nga procesi i diskutimit të ACRC-së, dhe të marrë miratimin e tij/saj. Pastaj, vlerësuesi duhet të japë një rekomandim me shkrim për kreun e agjencisë përkatëse, duke bashkangjitur një kopje të rezolutës.
2. Neni 11 zbatohet për procesin e rivlerësimit.
3. Neni 12 zbatohet për menaxhimin vijues të VRRK-së.

Seksioni 3. Kryerja e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit të Rregulloreve të Miratuara/Ndryshuara Komunale

Neni 19 (Vlerësimi i Rregulloreve të Miratuara/Ndryshuara Komunale)

1. ACRC-ja mund të bëjë vlerësimin e rregulloreve të miratuara/ndryshuara komunale kur kërkohet nga qeveritë lokale.
2. Kur zbatohet një vlerësim i rregulloreve të miratuara/ndryshuara komunale në përputhje me paragrafin (1) të rregullores, do të zbatohen nenet 5, 7 dhe nenet 9-11 të së njëjtës rregullore.

Seksioni 4. Kryerja e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit për rregulla të brendshme/akte nënligjore të organizatave të shërbimeve publike

Neni 20 (Vlerësimi i rregullave të brendshme/akteve nënligjore të organizatave të shërbimeve publike)

1. Kur kreu i organizatës së shërbimit publik kërkon që ACRC-ja të kryejë VRRK-në për rregulla të brendshme/akteve nënligjore, siç janë rregulloret dhe aktet e themelimit, ACRC-ja mund të kryejë një vlerësim pas konsultimit me agjencinë përkatëse.
2. Kur zbatohet një vlerësim i rregullave të brendshme/akteve nënligjore të organizatës së shërbimit publik në zbatim të paragrafit (1) të rregullores, zbatohen nenet 5, 7 dhe 9-11 të së njëjtës rregullore.
3. Kur kryhet një vlerësim i rregullave të brendshme aktuale/akteve nënligjore të një organizate të shërbimit publik në përputhje me paragrafin (1) të rregullores, do të zbatohen nenet 5, 7, 9 dhe 14-17 Paragrafi (2) të së njëjtës rregullore.

Kapitulli 3 Providing Advice on Corruption Risk Assessment

Neni 21 (Organizimi i Grupit Këshillues)

1. Me qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe drejtësisë së procesit të vlerësimit, ACRC-ja mund të organizojë një Grup Këshillues të VRRK-së (në tekstin e mëtejshëm "grupi këshillues") në përputhje me nenin 31 paragrafi (1) të Dekretit të Zbatimit.
2. Grupi këshillues përbëhet nga ekspertë të fushave të ndryshme që janë rekomanduar nga agjencitë dhe organizatat përkatëse ose janë përzgjedhur nga ACRC-ja, të cilët bien nën ndonjë nga nënparagrafët e mëposhtëm:
 - a. Ata që punojnë në universitete, institute hulumtuese, grupe civile apo organizata publike, me ekspertizë në luftën kundër korrupsionit
 - b. Ata që janë avokatë të kualifikuar, avokatë të patentave, kontabilistë publikë, inxhinierë, kontabilistë tatimorë ose agjentë doganorë, me përvojë dhe njohuri për luftën kundër korrupsionit
 - c. Të tjerë që i përkasin një shoqërie akademike ose shoqate akademike dhe që njihen se kanë profesionalizëm dhe përvoja të barasvlershme me kualifikimet e parashtruara në paragrafin (1) ose paragrafin (2) të rregullores

Neni 22 (Kërkesa për këshillim)

1. Nëse ekziston ndonjë nga arsyet e përmendura në nënparagrafët e nenit 9 paragrafi (1) të rregullores, vlerësuesi mund të kërkojë këshilla nga ekspertët e grupit këshillues me ekspertizën përkatëse ose ekspertët e jashtëm që njihen se bien nën cilindo prej nënparagrafëve të nenit 21 paragrafi (2) të rregullores dhe janë listuar në grupin e ekspertëve të jashtëm të ACRC-së (në tekstin e mëtejshëm "ekspertë, etj.").
2. Kur kërkon këshilla për trajtimin e çështjeve të rëndësishme, vlerësuesi mund të kërkojë këshilla nga ekspertë të shumtë.

Neni 23 (Metodat për Marrjen e Këshillës)

1. Vlerësuesi kërkon këshilla duke shfrytëzuar kërkesën për këshilla në shabllonin e VRRK-së, siç tregohet në Shtojcën 6 të rregullores.
2. Vlerësuesi mund të zhvillojë diskutime ose mbledhje konsultimi me ekspertë, etj., kur të shihet e nevojshme. Në rast të trajtimit të çështjeve të rëndësishme, dy ose më shumë ekspertë, etj., do të ftohen në diskutime ose mbledhje konsultimi.
3. Vlerësuesi mund të shfrytëzojë kanale të ndryshme të komunikimit, si telefon, faks, e-mail ose metoda të tjera të komunikimit, për marrjen e këshillave kur është e nevojshme.

Neni 24 (Shpërblimi për Këshillimin)

ACRC-ja ofron shpërblime monetare për ekspertët, etj., të cilët kanë dhënë opinione për VRRK-në në përgjigje të kërkesës së vlerësuesit. Shpërblimet paguhen brenda buxhetit të vendosur nga ACRC-ja.

Neni 25 (Udhëzimet e Detajuara Operacionale)

Çështje të tjera të detajuara të nevojshme për funksionimin e grupit këshillues, të cilat nuk janë të përcaktuara në këtë rregullore, mund të vendosen nga kryesuesi pas shqyrtimit nga ACRC-ja.

Kapitulli 4 Management of Documents, Materials, and Capabilities

Neni 26 (Menaxhimi i Dokumenteve)

1. Vlerësuesi cakton numrat e dokumenteve (të cilat klasifikohen sipas datës së dorëzimit dhe numrave serikë) sipas rendit të dorëzimit.
2. Vlerësuesi regjistron në Sistemin e Menaxhimit të VRRK-së një seri dokumentesh dhe materialesh që lidhen me vlerësimin, të prodhuar ndërmjet datës së paraqitjes dhe datës së përfundimit të vlerësimit, dhe do t'i menaxhojë duke shfrytëzuar sistemin.

Neni 27 (Grumbullimi dhe Menaxhimi i Materialeve që Lidhen me Korrupsionin)

Drejtori i divizionit të VRRK-së mund të mbledhë dhe menaxhojë materialet që lidhen me korrupsionin (p.sh. rezultatet e vlerësimit të integritetit, statistikën mbi zyrtarët e korruptuar publikë, dhe shqyrtimin e rasteve të raportuara në ACRC, etj.) për t'i shfrytëzuar për vlerësim.

Neni 28 (Themelimi i Sistemit të Menaxhimit të Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit)

Drejtori i Divizionit të VRRK-së mund të krijojë dhe të operojë Sistemin e Menaxhimit të VRRK-së për regjistrimin sistematik dhe menaxhimin e materialeve të paraqitura, siç janë materialet e vlerësimit, këshillat nga ekspertët etj., dhe rezultatet e vlerësimit.

Neni 28.2 (Menaxhimi i Kapaciteteve të Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit)

1. ACRC-ja do të bëjë përpjekje për të përmirësuar teknikat e vlerësimit dhe për të rritur ekspertizën e vlerësuesve.
2. ACRC-ja mund të krijojë dhe zbatojë masa për të përmirësuar aftësitë e vlerësimit të agjencive administrative qendrore, qeverive lokale dhe organizatave të shërbimeve publike, dhe të inkurajojë agjencitë në të gjitha nivelet që të identifikojnë dhe të zhdukin në mënyrë autonome faktorët që shkaktojnë korrupsion.

Neni 29 (Periudha e Rivlerësimit)

Në përputhje me Direktivën Presidenciale nr. 334- Rregullorja për Nxjerrjen dhe Menaxhimin e Direktivave dhe Rregulloreve, veprimet si shfuqizimi ose ndryshimi i kësaj rregulloreje do të ndërmerren deri më 1 janar 2018, duke marrë në konsideratë ligjet ose ndryshimet në rrethanat pas nxjerrjes së kësaj rregulloreje

■ Referencat

Komisioni Korean për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile. 2011. "Udhëzimet Operative për Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit"

Komisioni Korean për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile. 2012. "Politika kundër Korrupsionit e Koresë dhe Përpjekjet për të Rritur Integritetin".

Komisioni Korean për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile. 2015. "Udhëzime për Vlerësimin e Ndikimit të Korrupsionit 2016".

Komisioni Korean për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile. 2017. "Doracak për Vlerësimin e Ndikimit të Korrupsionit".

Komisioni Korean për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile. 2018. "Raporti Vjetor 2017".

Choi, Jinwook, Park, Joonghoon, dhe Lee, Ahjung. 2017. Nr. 2 i Serisë së Mendimeve për Zgjidhjet e Zhvillimit: Politikat dhe institucionet kundër korrupsionit në Kore dhe Singapor. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Qendra e Politikave në Seul për Partneritetet e Zhvillimit Global, Seul.

■ Vegza të jashtme

Më shumë për Komisionin për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat Civile (ACRC): <http://www.acrc.go.kr/en/index.do>

Më shumë për Bordin e Auditimit dhe Inspektimit (BAI):

Më shumë për Zyrën e Prokurorit Suprem (SPO): <http://www.spo.go.kr/eng/about/departments.jsp>

Partneriteti për Zgjidhje Zhvillimore

Qendra e Politikave e UNDP-së në Seul për Partneritetet e Zhvillimit Global

Për më shumë se 40 vjet (1963-2009), UNDP-ja ka mbështetur qytetarët dhe Qeverinë e Koresë, duke realizuar 270 projekte në 20 fusha që pasqyrojnë rrugën e zhvillimit të Koresë. UNDP-ja e ka mbyllur Zyrën e saj të Vendit në vitin 2009, kurse Koreja u bë pjesë e Komisionit të Asistencës për Zhvillim (DAC) të OECD-së, duke konfirmuar statusin e saj si kontribuuese e rëndësishme e ndihmës për zhvillim. Në këtë kontekst, Qendra e Politikave e UNDP-së në Seul (USPC) u themelua në vitin 2011, me qëllim të ndërmjetësimit të partneriteteve të reja mes Koresë dhe botës në zhvillim përmes rrjeteve të UNDP-së. USPC-ja bashkë-financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Koresë dhe UNDP-ja.

Si një nga Qendrat Globale të Politikave të UNDP-së, USPC-ja ka për detyrë: përfaqësimin e UNDP-së në Kore; bashkëpunimin me Korenë për çështjet ndërkombëtare; dhe ndarjen e përvojës së zhvillimit të Koresë me vendet e tjera.

Çfarë është "Partneriteti për Zgjidhje Zhvillimore" (DSP)?

DSP është një pjesë kyçe e programit të USPC-së për të ndarë përvojën e zhvillimit të Koresë dhe mjetet inovative të politikave, përmes rrjetit të gjerë të UNDP-së. DSP-ja përqipet të ndihmojë vendet që të zbatojnë dhe të përshtatin mjetet e politikës së Koresë për të arritur prioritetet e tyre për zhvillim të qëndrueshëm.

Për shkak të përvojës së Koresë me tranzicionin nga një vend i mbajtur me ndihma pas Luftës së Koresë në një vend donator, Koreja ka përvoja dhe njohuri të pasura dhe praktike që i ndan me vendet në zhvillim. Sidoqoftë, kërkohen punë e gjera dhe partneritete konkrete për ta kthyer frymëzimin në zbatim në terren. Kërkohen përpjekje të përbashkëta për të kapur, ndarë dhe aplikuar në mënyra konkrete risitë e politikave. Kalimi përtej "humbjes në përkthim" kërkon shumë punë në prapaskenë. Ky nuk është thjesht një përkthim gjuhësor. Për të shpjeguar, ndërlikuar dhe ndarë në mënyra kuptimplote, kërkohet bashkëpunim sistematik dhe i qëndrueshëm mes personave realë në nivelin e punës.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
Civile
Qendra e Politikave në Seul

Korea University 4F, International Studies Hall
145, Anam-Ro, Seongbuk-Gu,
Seul, Republika e Koresë

E-mail: info.kr@undp.org
Uebsajti: www.undp.org/uspc

Komisionit për Anti-Korrupsion dhe të Drejtat

Kompleksi Qeveritar-Sejong
20, Dorum 5-ro, Sejong-si, 30102
Republika e Koresë

E-mail: acrc@korea.kr
Uebsajti: www.acrc.go.kr